Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 3 (198) MARS 2023. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market
PESHKOPI MAQELLARË
Plot oferta dhe surpriza...

VENDLINDJA

Dushaj – katundi i kullave, bujarisë dhe natyrës piktoreske

Nga **ADRIATIK BALLA** — Faqe 12

AKTUALITET

Arrestohen kryetari dhe disa drejtues të Bashkisë Bulqizë

Nga **SAMI CURRI** — Faqe 7

BOTIME

Dom Nikollë Kaçorri për Dibrën dhe dibranët

Nga **NAIM ZOTO** — Faqe 16

LIBRI I RI

Në gjurmë të këngës dibrane: këngë e balada, epikë historike e lirika

Nga **MIRDASH SHEHU** — Faqe 15

PETICIONI / A do ta ri-inaugurojë Kryeministri Rama Rrugën e pambaruar të Arbërit në prag të zgjedhjeve lokale?!

Grupi i lobimit: Dibra vazhdon të jetë e njerkës

Kur e nisëm atëherë peticionin synonim dy qëllime: *E para,* depolitizimin e çështjes së Rrugës së Arbrit, heqjen e saj nga agjendat politike dhe vendosjen e saj si një agjendë kombëtare. Në parim, Partia Spocialiste dhe Partia Demokratike bënë sikur ranë dakord me këto kërkesa, por asnjëra palë nuk i mbajti premtimet.

E dyta, ishte rritja e presionit ndaj vendimmarrësve për të ndërtuar një rrugë me cilësi dhe standarde dhe premtimi ndaj publikut ishte se nuk do ta zbehim kurrë zërin dhe presionin tonë për arritjen e këtij qëllimi.

Grupi i Lobimit ka vënë re në terren punime të ngadalësuara dhe pa cilësi dhe mungesa përsa i përket sigurisë. Aksidentet e fundit kanë treguar se ndërtuesit, apo nënkontraktorët, nuk u kanë kushtuar rëndësi dhe kjo, më shumë se shkelje e rregullave të ndërtimit, ka të bëjë me frymën e qeverisjes: bëj sikur punon, premto dhe bëj sikur mban premtimet, sepse, si gjithmonë, Dibra është e fundit.

— FAQE 2

PROTESTË

Drini është pasuri e Dibrës, pasuri e Shqipërisë

Më 23 mars 2023, në Nju Jork, përballë zyrave të OKB-së, u mbajt një protestë kundër ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës.

"Dibra është vendi i tretë bujqësor më i përmendur në veri të Shqipërisë. Në qoftë se përmbytet Dibra, mbeten vetëm Lezha dhe Shkodra. Skavica është një vepër krejt e pabazuar në shkencë, por është e ushqyer me dollarë".

"Gjatë qeverisjes time nuk është ndërtuar Skavica, pasi nuk pranova asnjë projekt që shkaktonte përmbytje", tha Berisha në Peshkopi më 1 prill 2023. Duke akuzuar qeverinë se po angazhohet të ndërtojë një projekt të hartuar në kohën e Enver Hoxhës, ai theksoi se "Skavica është një aferë korruptive".

"Grupi i Aktivistëve Ruralë të Dibrës - GARD" ka hapur zyrën në Peshkopi, ku do t'u krijojë mundësinë aktivistëve të shoqërisë civile, banorëve dhe organizata joqeveritare, të mblidhen dhe të diskutojnë, jo vetëm për Skavicën, por edhe për çështje të tjera që shqetësojnë komunitetin

— FAQE 3

TURIZËM

Burimi dhe shpella karstike e Sopanikës



BURIMI dhe SHPELLA KARSTIKE E SOPANIKËS përfaqësojnë një hidromonument dhe një gjeomonument pranë fshatit Çidhën. Burimi karstik me prurje 70 - 100 l/sek, del në kontaktin midis gëlqerorëve dhe terrigjenëve, ndërsa shpella karstike përfaqëson njëkohësisht edhe burimin ujor me të njëjtin emër.

Shpella e Sopanikës përfaqëson njëkohësisht edhe burimin ujorë me të njëjtin emër, ku mund të marrin prej saj ujë një pjesë e mirë e fshatrave të Njësive Administrative të Dibrës së Poshtme. Është një ndër shpellat më të mëdha dhe mjaftë interesante në Dibër, që meriton një vëmendje të veçantë, si nga speleologët ashtu dhe nga organizmat shtetërorë, për tu eksploruar plotësisht dhe për tu shndërruar në një pikë turistike gjigante... Të dhënat e deri tanishme flasin se shpella në fjalë ka një gjatësi të vrojtuar mbi 250 m, dhe mendohet se duhet të lidhet me një shpellë në zonën e Pllajut, duke i kaluar kështu kilometrat. Me vrojtimet e deri tanishme konstatohet prania e madhe e stalaktiteve dhe e stalagmiteve, të cilat së bashku me rrjedhjet e ujërave të shpellës, i japin asaj një pamje mahnitëse. Vende–vende, në shpellë, vërehen edhe liqenj të vegjël karstik, të cilët ia shtojnë edhe më shumë bukuritë. Kjo shpellë është studiuar gjatë viteve 2014-2016 nga speleologë bullgarë. Burimi dhe shpella kanë vlera gjeomorfologjike, hidrogjeologjike, didaktike dhe gjeoturistike.

(Foto: Enela Shehu Markja. Teksti marrë nga libri "Gjeologjia dhe minieralet e Dibrës", V. Hoxha)

NË BRENDËSI:

- **Adem Bunguri**: Rivlerësimi i hipotezës së migracionit "kurgan" sipas evidencës arkeologjike nga Shqipëria dhe Kosova
- "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës" i prof. **Vesel Hoxhës** - një enciklopedi e Dibrës në fushën e gjeologjisë dhe të mineraleve
- **Erblin Iskurti**: Kjo klasë politike ka shkatërruar shpresën për të nesërmen më të mirë
- "Pasha Shqipërinë time zemrake"
- **Bardhyl Muça** e djemtë, një histori suksesi në Bllatë të Dibrës
- **Shoqëria e klikimeve** ose 11 minuta e 42 sekondat e Sodomës
- Botohet libri "Një jetë maleve, kujtime 5" me autor **Bashkim Lleshin**
- **Kalaja e Zhugjërit** dhe Zhugjeri i Historisë
- **Dita e Verës** në krahinën e Grykës së Madhe
- **Selman Karoshi**, njeriu që u afirmua me punë e sakrifica
- **Hysen Puca** modeli i atdhetari në Grykën e Madhe
- Kur hidhet baltë mbi të kaluarën, e sotmja dhe e nesërmja gjenden në udhëkryq
- Ishte një kohë me Ty, **Lutfi Manjani**
- Homazh për qytetarin me vlera humane, **Fitim Islamin**

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 3 (198).
Mars 2023
Gazeta doli nga shtypi, 10 prill 2023.
Gjendet në treg deri në fund muajit prill 2023.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Sami CURRI
Adem BUNGURI
Adriatik BALLA
Naim ZOTO
Hajri SHEHU
Zaim ELEZI
Bajram XHAFA
Gentjan TUFA
Mirdash SHEHU
Mina HYSA
Zabit LLESHI
Dali NOKA
Lavdrim BEQIRI
Kujtim ÇERPJA
Gëzim LOKA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Dibra vazhdon të jetë e njerkës

A do ta ri-inaugurojë Kryeministri Rama Rrugën e pambaruar të Arbërit në prag të zgjedhjeve lokale?!

NJOFTIM PËR MEDIAT NË 10 VJETORIN E PETICIONIT
- Nga **Grupi i Lobimit**

Tiranë, më 18 Mars 2023 - U mbushën 10 vite nga nisja e këtij peticioni, dhe çdo pritshmëri e nismëtarëve i ka kaluar kufijtë. Kur e nisëm atëherë peticionin synonim dy qëllime:

E para, depolitizimin e çështjes së Rrugës së Arbrit, heqjen e saj nga agjendat politike dhe vendosjen e saj si një agjendë kombëtare. Në parim, Partia Spocialiste dhe Partia Demokratike bënë sikur ranë dakord me këto kërkesa, por asnjëra palë nuk i mbajti premtimet.

E dyta, ishte rritja e presionit ndaj vendimmarrësve për të ndërtuar një rrugë me cilësi dhe standarde dhe premtimi ndaj publikut ishte se nuk do ta zbehim kurrë zërin dhe presionin tonë për arritjen e këtij qëllimi.

Grupi i Lobimit vazhdon t’u përmbahet këtyre parimeve ndërsa Kryeministri Edi Rama dhe tre Qeveritë e tij vazhdojnë ta injorojnë krejtësisht qëllimin tonë. Madje kanë dëshmuar një mungesë mjeranë në etikën e komunikimit, duke na akuzuar si “vegla të Saliu” dhe duke u krekosur se do ta ndërtojnë rrugën me standarde të tilla europiane, që do ta kishin zili edhe “peticionistat e Londrës”.

Për sqarim, peticioni filloi përpara zgjedhjeve parlamentare në Mars 2013, pra kur nuk dihej rezultati i tyre. Po kështu, Grupi i Lobimit nuk ka ndonjë anëtar në Londër. Ndërsa Kryeministri Rama, me sa duket, është mësuar të rrethohet nga temenaraxhinj dhe i do dibranët afër të jenë merhumë dhe anonimë, që t’i servirë si ‘përfaqësonjës’ të Dibrës dhe disaporës sipas lojës së tij, meqë nuk ka kurajo të përballet me elitën.

Kanë kaluar dhjetë vite nga nisja e peticionit dhe njerëzit e kanë parë çdo ditë në terren se çfarë është realizuar.

Ne e përshëndetëm nisjen e qarkullimit në rrugë në nëntor 2021. Ndryshimi i vetëm që nga ajo kohë është se, nga pagesat nën dorë për rojet, tani qarkullimi ishte i lirë. Edhe pas dy vitesh, standardet e rrugës janë, siç thonë dibranët, për ibret: rruga ka rrëshqitur në shumë vende, asfalti shpesh është i shqepur dhe sinjalistika e sigurisë nuk gjendet pothuajse gjëkundi.

Grupi i Lobimit ka vënë re në terren punime të ngadalësuara dhe pa cilësi dhe mungesa përsa i përket sigurisë. Aksidentet e fundit kanë treguar se ndërtuesit, apo nënkontraktorët, nuk u kanë kushtuar rëndësi dhe kjo, më shumë se shkelje e rregullave të ndërtimit, ka të bëjë me frymën e qeverisjes: bëj sikur punon, premto dhe bëj sikur mban premtimet, sepse, si gjithmonë, Dibra është e fundit.

Që nga dita e nënshkrimit të kontratës në Mars të vitit 2018, informacione kontradiktore janë dhënë për financimin e saj. Nga 260 milionë euro për afro 80 kilometra rrugë, shifrat kanë shkuar në mbi 400 milionë euro. Një të katërtën e kësaj shumë e ka paguar qeveria deri më tani, por rruga nuk ka përfunduar megjithëse është inaguruar disa herë.

Gjithashtu, terri informativ mbizotëron mbi ecurinë e punimeve në Tunelin e Murrizit. “Edhe 700 metra tunel ka për tu hapur”, thoshte Ministrja e Infrastrukturës në verën e vitit të kaluar, por mediat raportojnë se afro 700 metra është aktualisht pa u hapur akoma!

Dy tunelet e tjera të Kardhiqit dhe Llogarasë nisën pas tunelit të Murrizit, por dy të parët mbaruan para kohe sepse, për Qeverinë, Dibra është akoma e njerkës.



Pamje nga tuneli i Murrizë.

**Kur e nisëm atëherë peticionin synonim dy qëllime:
E para, depolitizimin e çështjes së Rrugës së Arbrit, heqjen e saj nga agjendat politike dhe vendosjen e saj si një agjendë kombëtare. Në parim, Partia Spocialiste dhe Partia Demokratike bënë sikur ranë dakord me këto kërkesa, por asnjëra palë nuk i mbajti premtimet.
E dyta, ishte rritja e presionit ndaj vendimmarrësve për të ndërtuar një rrugë me cilësi dhe standarde dhe premtimi ndaj publikut ishte se nuk do ta zbehim kurrë zërin dhe presionin tonë për arritjen e këtij qëllimi.**



Grupi i Lobimit ka vënë re në terren punime të ngadalësuara dhe pa cilësi dhe mungesa përsa i përket sigurisë. Aksidentet e fundit kanë treguar se ndërtuesit, apo nënkontraktorët, nuk u kanë kushtuar rëndësi dhe kjo, më shumë se shkelje e rregullave të ndërtimit, ka të bëjë me frymën e qeverisjes: bëj sikur punon, premto dhe bëj sikur mban premtimet, sepse, si gjithmonë, Dibra është e fundit.

Nga vëzhgimet e fundit në terren, duke parë çfarë është përfunduar, çfarë është në proces dhe çfarë nuk është filluar akoma, mund të themi pa rezerva se kjo rrugë nuk do të përfundojë, jo vetëm këtë viti, por as vitin e ardhshëm.

Qeveria kujtohet vetëm kur ka zgjedhje të merret me rrugën, gjë të cilën pritet ta bëjë edhe këtë vit, me hapjen e segmentit në Planin e Bardhë, e cila me letrat e Qeverisë ka mbaruar që në vitin 2011.

Në këtë 10-vjetor të peticionit, ajo që vëmë re është se nuk ka asnjë komunikim zyrtar ndërmjet Tiranës dhe Shkupit për vazhdimin e punime në Rrugën e Arbërit në Maqedoninë e Veriut. Dhe për ta ndihmuar këtë fakt, qeveria shqiptare e ka mbyllur Rrugën e Arbërit në një rrethrrotullim në Maqellarë jashtë çdo standardi.

Vitet po ikin dhe Qeveria në Tiranë dhe qeveritarët shqiptarë në Maqedoninë e Veriut duhet ta kuptojnë se nuk ka integrim të rajonit në Europë pa u integruar Dibra e copëtuar. Ndërprerja e këtij komunikimi ose lidhja e tyre dobët është nje nga plagët e hapura të hapsirës shqiptare.

Peticioni për Rrugën e Arbërit, që deri tani ka mbi 22,000 përkrahës, nga të cilët 2,000 në formularë, mund të nënshkruhet online: **http://bitly.ws/BLHN**

kryesore

"Grupi i Aktivistëve Ruralë të Dibrës - GARD" ka hapur zyrën në Peshkopi, ku do t'u krijojë mundësinë aktivistëve të shoqërisë civile, banorëve dhe organizata joqeveritare, të mblidhen dhe të diskutojnë, jo vetëm për Skavicën, por edhe për çështje të tjera që shqetësojnë komunitetin

Drini është pasuri e Dibrës, pasuri e Shqipërisë

Më 23 mars 2023, në New York, përballë zyrave të OKB, mbahet një protestë kundër ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës.

Grupimi "Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës" (Opposition to Skavica Dam) organizoi më 23 mars 2023 në New York, përballë zyrave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), një protestë kundër ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës.

Protestuesit mbanin në duar parulla të shkruara në anglisht, mes të cilave spikasnin "Skavica është korrupsion", "Mbroni Dibrën!", "Mbroni Drinin" etj.

Arif Mata, një nga aktivistët kundër Skavicës, vuri theksin në fjalën e tij në këtë protestë se hidrocentrali i Skavicës "prek mbi 20 mijë familje, duke sjellë zhdukjen e Dibrës, - theksoi Mata.

Mata tha se "nuk luftojmë vetëm për vete, por luftojmë për Shqipërinë". Sipas tij, "Dibra është vendi i tretë bujqësor më i përmendur në veri të Shqipërisë. Në qoftë se përmbytet Dibra, mbeten vetëm Lezha dhe Shkodra. Skavica është një vepër krejt e pabazuar në shkencë, por është e ushqyer me dollarë". Mata akuzoi qeverinë shqiptare dhe kompaninë ndërtuese për një marrëveshje korruptive mes tyre. Ai u bëri thirrje dibranëve dhe shqiptarëve të angazhohen për mbrojtjen e Dibrës.

"Të mbrojmë trojet tona, të mbrojmë Dibrën", theksoi Mata.

Shpëtim Ndreu, një tjetër aktivist në protestë, në një kontekst gjeopolitik, tha mes të tjerash se ka një përpjekje për ta zhdukur Dibrën përmes ndërtimit të hidrocentralit.

Ai, në gjuhën shqipe, iu drejtua me një lutje anëtarëve të OKB që të bëjnë përpjekje për të ndaluar ndërtimin e hidrocentralit.

"Mos na e merrni ujin! Mos na i merrni tokat! Mos na i mbuloni varret! Ruani 35 fshatrat që duan ti zhdukin duke i mbuluar me ujë!" - bëri thirrje Ndreu.

"Drini është pasuri e Dibrës, është pasuri e Shqipërisë. Na ndihmoni të ruajmë Dibrën, të ruajmë ujin e Dibrës, të ruajmë jetët tona, pronat tona", u bëri thirrje Ndreu përfaqësuesve të shteteve në OKB, të cilët ishin mbledhur për një konventë që kishte të bënte me ruajtjen dhe mirëpërdorimin e rezervave të ujit në botë.

Ferzileta Gjika, drejtuese e grupimit "Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës", në një deklaratë të shpërndarë për publikun përmes faqes së saj në Facebook, shkruan se "dhjetëra shqiptaro-amerikanë, protestuan përballë selisë së Kombeve të Bashkuara në Manhattan dhe kërkuan që të ndalohet menjëherë projekti i ndërtimit të Skavicës".

Ajo e vë theksin te emetimet e gazit metan që krijohet nga digat, si një burim kryesor i emetimeve globale të metanit.

"Tubuesit kërkuan që anëtarët e Kombeve të Bashkuara të kërkojnë pranë mekanizmave ndërkombëtarë ndalimin e hidrocentralit të Skavicës dhe për sigurimin e energjisë në vend të konsiderojnë mënyra të tjera që janë më miqësore me mjedisin", shkruan Gjika.



Pamje nga protesta para selisë së OKB. Foto: citizens-channel.com

Gjika vë në dukje në deklaratën e saj se "Qarku i Dibrës, përgjatë Luginës së Drinit të Zi, është pikë e nxehtë e biodiversitetit të vendit, veçanërisht për sa i përket biodiversitetit të ujërave të ëmbla. Malet e larta, sistemet e lumenjve dhe liqeneve në rajonin e Dibrës janë shtëpia e llojeve të shumta të rrezikuara dhe habitateve të rëndësishme me një shkallë të lartë endemizmi".

Protestuesit kanë nënshkruar edhe një notë proteste, e cila u drejtohet përfaqësuesve të shteteve të OKB, të cilët po zhvillonin po atë ditë një konferencë botërore për ujin.

"Ne, nënshkruesit e kësaj deklarate të përbashkët, besojmë se ndërhyrjet e duhura për shpëtimin e lumit Drin dhe ndalimin e projektit të Digës së Skavicës janë të një rëndësie të madhe dhe urgjente, e cila mund të ofrojnë mbrojtje dhe rikuperim për peshqit dhe specie dhe habitate të tjera të rëndësishme, duke ruajtur vlerën unike të biodiversitetit të lumenjtë e rajonit të Dibrës. Mbrojtja dhe restaurimi i lumit Drini i Zi në Shqipëri ofron një mundësi të madhe për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve që jetojnë pranë luginës së Drinit të Zi. Ato ofrojnë ujë të pijshëm, ushqim, ujë për ujitje, mbrojtje nga përmbytjet, rregullimin e klimës, mundësi për të zhvilluar peshkimin, sportet ujore, ekoturizmin dhe mundësi për të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin midis vendeve, shkencëtarëve, institucioneve, bizneseve dhe organizatave joqeveritare", thekson Gjika.

Kundërshtarët e ndërtimit të hidrocentralit vlerësojnë se diga e miratuar nga qeveria shqiptare do të zhvendosë nga trojet e gjyshërve mijëra banorë si dhe do të zhysë nën ujë mbi 30 fshatra, duke shkatërruar mënyrën e jetesës, historinë, kulturën dhe identitetin.

Në lidhje me shqetësimet klimatike që sjell ndërtimi i HEC të Skavicës, aktivistët evidentojnë faktin se "janë vetëm 70 km e fundit të Drinit të Zi, të cilat rrezikohen të zëvendësohen me rezervuarin e Skavicës. Mbyllja e lumenjve eliminon burimet e ushqimit për mbijetesë dhe minon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Qëllimet e përshtatjes klimatike të Marrëveshjes së Parisit do të shërbeheshin më mirë duke mbrojtur lumenjtë me rrjedhje të lirë dhe njerëzit që varen prej tyre".

"Diga e Skavicës bllokon kalimin e peshqve, krijon liqene artificiale që strehojnë specie jo vendase, nxisin lulëzimin e dëmshëm të algave, bllokojnë sedimentet që janë thelbësore për të ruajtur grykëderdhjet ne lumin Drin dhe dëmtojnë cilësinë e ujit në lumenj", thekson Gjika.

Drejtuesja e protestës, Ferzilera Gjika, vë theksin se "përmirësimi i digave ekzistuese për të prodhuar më shumë energji mund të mohojë nevojën për diga të reja. Energjia diellore, era dhe gjeotermale mund të ofrojnë burime energjie me kosto më efektive dhe shoqërore".

Duke iu referuar "Marrëveshjes së Parisit", nënshkruar në dhjetor 2015, e cila synon marrjen e masave të nevojshme që lidhen me reduktimin e emetimeve globale, Gjika thekson në njoftimin për publikun, se projektet e kompensimit të digave minojnë synimet e kësaj marrëveshje.

Protesta e zhvilluar përpara zyrave të OKB ishte protesta e katërt e organizuar jashtë vendit, njëra prej të cilave është mbajtur po në New York, ndërsa dy të tjerat në Londër përballë zyrave të Bechtel më tetor 2022 dhe shkurt 2023.

GARD, grupi i aktivistëve ruralë të Dibrës

Ndikimi që ka në publik ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës, problematikat që sjell si dhe çështjet e tjera mjedisore e sociale që shqetësojnë banorët që janë të detyruar të zhvendosen apo fshatrat dhe banorët që do të jetojnë brigjeve të ujëmbledhësit të hidrocentralit, sjellin nevojën e një riorganizimi të komunitetit, ballafaqimit të pikëpamjeve si dhe nevojës për një organizim më të mirë dhe më të qëndrueshëm të protestave.

Me nismën e Majlinda Hoxhës, një aktiviste kundër ndërtimit të hidrocentralit, është krijuar një Dibër "Grupi i Aktivistëve Ruralë të Dibrës - GARD", e cila ka hapur një zyrë të sajën në qytetin e Peshkopisë.

"Zyra është një mjedis ku aktivistët e shoqërisë civile, banorë dhe organizata, do të mblidhen dhe diskutojnë, jo vetëm për Skavicën, por edhe për çështje të tjera që shqetësojnë komunitetin", thotë Hoxha.

Zyra do të jetë e hapur edhe për organizatat e tjera të shoqërisë civile, të cilat mund ti përdorin mjediset e saj për takimet e tyre.

SKAVICA DHE ZGJEDHJET LOKALE.

Çështja e Skavicës pritet të jetë edhe një temë e nxehtë gjatë këtyre zgjedhjeve vendore. Gjatë prezantimit të kandidatit të grupimit "Bashkë Fitojmë" më 1 prill në Peshkopi, Sali Berisha - ish kryeministër dhe kryetar i PD, deklaroi se "Skavica është varri i Dibrës"

"Të fundosësh 37 fshatra, të zhvendosësh 20 mijë banorë, çfarë mbetet në Dibër?", pyeti Berisha.

Më tej, ai tha se gjatë qeverisjes së tij nuk është ndërtuar Skavica, pasi ai nuk pranoi asnjë projekt që shkaktonte përmbytje. Duke akuzuar qeverinë se po angazhohet të ndërtojë një projekt të hartuar në kohën e Enver Hoxhës, ai theksoi se "Skavica është një aferë korruptive".

Berisha, gjatë fjalës së tij në Pallatin e Kulturës, drejtuar mbështetësve të tij, i kërkoi kompanisë Bechtel të heqë dorë nga HEC i Skavicës, sepse "është një kontratë pa garë".

"Në vendin e tij, në vendin tim dhe në çdo vend, kontratat pa garë janë korruptive", tha Berisha.

Gjithashtu, drejtuesi i opozitës tha se, sipas informacioneve të tij, "Bechtel po u shet aksione kompanive britanike", ndaj ai i bëri thirrje qeverisë britanikë që të mos lejojë kompanitë britanike të blejnë aksionet e Bechtel.

"Dibra nuk mund të varroset. Dibrën e kanë prurë dibranët në shekuj e mijëvjeçar dhe do të ecë në shekuj e mijëvjeçarë e lirë".

BUJAR KAROSHI

"Gjatë qeverisjes time nuk është ndërtuar Skavica, pasi nuk pranova asnjë projekt që shkaktonte përmbytje", tha Berisha në Peshkopi më 1 prill 2023. Duke akuzuar qeverinë se po angazhohet të ndërtojë një projekt të hartuar në kohën e Enver Hoxhës, ai theksoi se "Skavica është një aferë korruptive".

"Dibra është vendi i tretë bujqësor më i përmendur në veri të Shqipërisë. Në qoftë se përmbytet Dibra, mbeten vetëm Lezha dhe Shkodra. Skavica është një vepër krejt e pabazuar në shkencë, por është e ushqyer me dollarë".

"Drini është pasuri e Dibrës, është pasuri e Shqipërisë. Na ndihmoni të ruajmë Dibrën, të ruajmë ujin e Dibrës, të ruajmë jetët tona, pronat tona"



Pamje nga tokat që do të mbulohen nga uji i HEC Skavica, Laçes, Fushë-Alie, Dibër.

Rruga e Arbërit nr. 198

opinion

Kur hidhet baltë mbi të kaluarën, e sotmja dhe e nesërmja gjenden në udhëkryq

Nga **Gëzim LOKA**

Sot, brezat e rinj dhe të moshuar, fëmijët, gratë dhe burrat e këtij vendi përjetojnë një krizë të madhe, që buron nga plagët e këtij sistemi, që e ka në minimum shkallën e reagimit dhe mbështetjes humane dhe në maksimum etjen e shfrenuar për fitime të atyre që janë në krye të kupolës politike e shtetërore.

Shoqëria shqiptare postkomuniste, për fat të keq, është zhytur në një krizë të thellë morale e politike, e cila vjen gjithnjë duke u thelluar dhe duke zvogëluar përmasat e vlerave të traditës, të punës e respektit njerëzor. Ka humbur njerëzillëku, shpirti i garës së ndershme, gadishmëria për të ndihmuar tjetrin, respekti dhe dinjiteti janë kthyer në etje të shfrenuar për të pasur gjithçka, duke shkelur mbi gjithkënd që të del përpara...!

Individualizmi frenetik nuk do që të ia dijë për asgjë, po zbehet gjithnjë e më shumë fryma e dashurisë dhe solidaritetit mes njerëzve, madje dhe mes vetë familjarëve e farefisit, po degradojnë parimet njerëzore dhe thuajse gjithçka vërtitet në derivate kënaqësie të unit, pa llogaritur asgjë tjetër veçse kënaqjen e vetvetes.

Është goditur familja, institucioni i martesës, lindja e fëmijëve etj. dhe shoqëria jonë po vjen dalëngadalë duke u kthyer në një shoqëri të plakur, më keq se shumica e vendeve të Evropës, që e pranojnë këtë plagë të rëndë të sistemit kapitalist.

U shkatërrua jo vetëm baza ekonomike dhe e mjeteve të prodhimit, që i përkisnin sistemit komunist, duke u rrënuar miliarda lekë vlerash materiale, por dhe ato cilësi të mira morale e njerëzore, që ishin krijuar në atë epokë dhe që tani shumëçka duket sikur është kthyer e vazhdon të kthehet me kokë poshtë.

Realiteti "demokratik" tridhjetë e dy vjeçar ka ardhur me shumë pengesa, me probleme të mëdha ekonomike, etike, sociale, shoqërore, me deformimet në karakter dhe në psikologjinë e sjelljes e të veprimit, me humbje të vlerave principiale humane dhe rrënim të shumë virtyteve të traditës shqiptare.

Sot e gjithë klasa jonë politike në të majtë e në të djathtë, bubullon e gjëmon kundër të ashtuquajturës prej saj "Diktatura komuniste", duke sharë e mallkuar atë kohë, jo sikur në atë kohë të kenë jetuar njerëz e të jenë ndërtuar vepra, por sikur të ketë ngrirë gjithçka, që nga puna e dija deri tek mendimi njerëzor.

Shajnë kohën e shkuar komuniste, rendin, rregullin, qetësinë, punën e garantuar për gjithëkënd në atë kohë që kaluam të gjithë dhe i thurin hymne kësaj shthurje të plotë e degradimi moral e shpirëtor, që po përjetojmë sot dhe që nxit ky rend shoqëror, ku njeriu për njeriun vërtet është ujk dhe shumëçka vërtitet në hullinj të gabuar.

Në fakt, megjithë gabimet dhe mëkatet e asaj kohe, nuk është ajo pengestarja në ecurinë e mbrapshtë të vendit tonë. Nuk është ajo shkaktarja që në këtë vend po thellohet hendeku midis të varfërve që nuk kanë asgjë dhe të pasurve që nuk dinë se çfarë kanë, që droga, prostitucioni, trafiqet, krimi i rrugës dhe ai i organizuar bëjnë kërdinë, që arsimi është përtokë dhe shëndetësia e rrënuar, që në zonat e largëta e të thella njerëzit vdesin nga mungesa e shërbimit shëndëtësor për një gjilperë, që analfabetizmi po bëhet një dukuri e zakonshme, sidomos në zonat e thella të vendit, që hakmarrja dhe gjakmarrja mbajnë të ngujuar gra e fëmijë kundër Kanunit dhe çdo norme tjetër të së drejtës zakonore, që lufta e klasave vijon akoma më e egër se në kohën e socializmit, por me një stilt ë ri, me metoda të reja dhe më të sofistikuara etj.

Në kapitalizmin primitiv shqiptar ekonomia ka pesuar rënie drastike, ka rënë punësimi, nuk ekziston më shkollimi normal e sa për edukim as mund të bëhet fjalë!

Politikanët shkatërruan gjithçka. Rinia mori rrugët, më saktë e detyruan të marrë rrugët e kurbetit, duke kaluar dete e male për të gjetur punë, për të ushqyer familjet e tyre. Pasi vetë kualifikimi i tyre mori fund, në Shqipërinë dhe demokracinë e këtij sistemi, që kujdeset vetëm elitat politike dhe klasën e pasur, e cila është pasuruar duke vjedhur dhe jo në rrugë e me mjete të ndershme!

Politikanët e të gjitha krahëve u kujdesën vetëm për pasurimin e tyre dhe të oligarkisë rreth tyre, duke i shkatërruar kësaj rine bazën e punës e të jetës, e cila ishte ndërtuar që në vitet '60, përcaktuese kjo për të jetuar me dinjitet në vendin etyre.

Asnjë fëmijë nuk lind hajdut, kriminel, vrasës dhe as filozof; këta bëhen gjatë jetës, ashtu siç përgatiten, thënë ndryshe shkruhet e zeza mbi të bardhë, pra lypset edukimi familjar, edukimi shkollor, edukimi shoqëror, përkujdesja e shtetit dhe institucioneve humane, të cilat ose mungojnë ose janë shumë të zbehta në këtë vend, ku mungon llogaridhënia dhe kaosi mbretëron në çdo institucion e për rrjedhoje mësimi dhe edukimi i fëmijëve dhe i të rinjve janë në kuotën thuajse zero...!

Ulja e nivelit arsimor, duke bërë që një pjesë të jetë analfabete, pa shkollë, pa punë, pa mjedis të shëndetshëm shoqëror, domosdo që do të krijojë kontigjentet e krimit kundër pronës së qytetarëve dhe jetës së tyre. Krimi bën kërdinë dhe po merr jetë të pafajshme që ndodhen rastësisht, në vendin dhe në kohën e gabuar!

Shumë politikanë dhe pushtetarë, nuk e pranojnë këtë realitet, madje ka nga ata ekstremistë që këto plagë ia faturojnë regjimit komunist, por e vërteta është e thjeshtë dhe e lexon gjithkush që di e ka dëshirë të lexojë të vërtetën e këtij sitsemi në këtë vend, që vërtitet në jermi të plotë ekzistenciale.

Më tej, kjo politikë duhet të reflektojë e të japë llogari, pse nuk përdoren politika të drejta punësimi dhe nuk hapen perspektiva për të ardhmen, pse nuk angazhohen organet shtetërore dhe partiake në bazë për punën dhe propogandimin e ligjeve dhe të rregullave, në mënyrë që t'i ruajnë njerëzit të mos bien në gabime e faje, të mos shkelin në dërrasë të kalbur. Për popullin ju bie ndërmend vetëm kur kërkojnë votën për kolltukun e tyre, këtu merr fund "kujdesi" për të.

Shoqëria ndihet e braktisur nga partitë politike që takohen me "sovranin" vetëm kur duan votat, rinia është në udhëkryq, pa shkollim, pa dije, pa edukim, punëtorët pa punë, bujqit pa toka e prona, gratë të mbyllura brenda katër mureve, fshati i braktisur, fëmijët në shumë fshtara pa shkollë, për shkak të shpopullimit të tyre, qyteti i mbipopulluar dhe pa të ardhme.

Dhe deputetët, politikanët, shefat e partive, krerët e qeverisjeve që pasojnë njëra-tjetrën, në vend që të venë gishtin mbi këto plagë dhe të tregojnë rrugët e kurimit të gjendjes, hedhin baltë mbi të kaluarën, njollosin kohën e shkuar, ku ne të gjithë kemi jetuar, kemi punuar, kemi lindur fëmijë e rritur breza të denjë për këtë tokë e komb, por që këta mohues të gjithçkaje e bëjnë qëllimisht për të mbuluar vjedhjet ditën për diell, duke tërhequr vëmendjen nga e kaluara e afërt.

Nuk është çështje nostalgjie, por për hir të së vërtetës duhet thënë se kështu nuk mund të vazhdohet. Nuk mund të ecet përpara duke hedhur gurë pas. Kush nuk njeh dhe vlerëson të kaluarën e tij, nuk mund të ketë të ardhme. Një komb që pas çdo epoke hedh baltë në rrugën e lënë pas nuk ka ta ardhme.

Në vend që të shohim se çfarë gjërash të mira duhet të marrim nga e kaluara, mallkojmë në kor, të paraprirë nga politikanët tanë, që nuk dinë të bëjnë gjë tjetër veçse të marrin me të dyja duart nga prona publike, nga të mirat tona publike dhe të mbushin kuletat, çeqet bankare, tapitë e pamerituara, që nuk i kanë trashëguar nga askush.

Nuk ka se si të ndodhë ndryshe tek shohim gjithë këtë rënie dhe staniacion të gjithëanshëm, këtë zvetënim të vlerave, këtë vakum moral e shpirtëror të krejt shoqërisë sonë, këtë mungesë dëshire të të rinjve për t'u diturar, këtë skajim ekstrem të difrencës klasore mes të varfërve e të pasurve, etj..., pasi të gjitha këto e kanë burimin tek mohimi i vlerave të së kaluarës. Thënë ndryshe, kur hidhet baltë mbi të kaluarën, e sotmja dhe e nesërmja gjenden në udhëkryqe të trishta...

Shoqëria e klikimeve ose 11 minuta e 42 sekondat e Sodomës

Nga **GENTJAN TUFA**

Udeshën 11 minuta live në emision, për t'i thënë një nëne se vajza e saj, e humbur prej muajsh, ka vdekur. 11 minuta të mbushura me suspansë, tension dhe mister, duke e kthyer ngjarjen nga çdo perspektivë e mundshme kinse po ecet drejt së vërtetës. Një e vërtetë që dihej që në krye të herës.

Në këmbim të këtij informacioni, gjithë ç'kërkon Mefistofeli i emisionit është që të gjithë të bëjnë sehir se çfarë ndodh me një nënë kur mëson live se vajza i ka vdekur.

Një marrveshje mëse e drejtë për shqiptarët kur bëhet fjalë për eksperimente të ngjashme por gjithëpoaq çnjerëzore.

A i keni parë të ashtëquajturat "emisione bamirësie" ku në këmbim të një shtëpie, fatkeqëve të këtij kombi u duhet të ngashërehen në lotë përpara kamerës, të demonstrojnë se si e hanë krodhen e bukës me vaj dhe sheqer; si flenë në të ftohtë, me batanije të leckosura nën çatinë e kasolles që po i zë përfund?!

A i keni parë fakirët e sëmurë që në këmbim të parave të operacionit (që shëndetësia jonë falas nuk e bën dot) e derdhin lotin sa grushti përpara kamerës së Elvis Naçit apo Arbër Hajdarit? Edhe pse e di mirë shqiptari i mençur se bamirësi nuk do të thotë t'i hedhësh kockën një qeni të uritur por të ndash ushqimin me dikë edhe kur je po aq i uritur sa ai.

A e keni parë se si çelësat e shtëpive të rindërtuara të tërmetit me paratë e shqiptarëve, me paratë e një të sëmure me kancer, me paratë e njerëzve nga shtetet fqinje i jep Rama dhe Veliaj po përpara kamerave, po për klikime?!

A i keni parë personazhet që përputhen në emision, që në ekranet e njerëzve perversë shfaqin gjënë më intime pas seksit: flirtimin? Duke vizualizuar shfrenimet më perverse të imagjinatës, duke u bërë të famshëm e kësisoj të pasur kundrejt taksës modeste: TË GJITHË TË MUND TA SHOHIN.

A nuk është mëkuar ky horror me perversionin e atyre që duan të shohin nga vrima e çelësit — tashmë ekran — se çfarë bëjnë njerëzit brenda shtëpisë (së Big Brotherit)?!

Për hir të klikimeve, publikut shqiptar i janë servirur prej dekadash sherre familjare për çështje pronash tek "shihemi në gjyq", "manuale" për rrëmbime, përdhunime dhe vrasje me strategji të detajuara pa kursyer as fëmijët. E kujtoni videon e vajzës nga Librazhdi që u kap në flagrancë duke tradhtuar burrin nga vjehri dhe vjehrra? Pikërisht, këto dhe shumë episode të tjera, ngjarje krejtësisht personale dhe pa pikën e dobisë për shoqërinë.

Nuk do ishte çudi nëse një ditë, do niste një emision si "Kush do bëhet synet?", që do shfaqte live prerjen e lafshës së organit mashkullor të një djaloshi në këmbim të një "çmimi të madh".

Kështu pra, emisionet shqiptare ngjajnë gjithnjë e më tepër me një "dark web" me video makabre, duke konkuruar njëri-tjetrin për nga niveli i perversionit e që përkthehet drejtpërdrejtë në klikime.

Nëna që braktis transmetimin e tronditur pasi mëson live vdekjen e së bijës më kujton ca vargje të Majakovskit:

Mirë,
Është, në teh gijotine,
Të klithësh:
"Pini kakao Van-Guten!"

Duke pasur parasysh një të dënuar me vdekje që bie dakord me kontratë (për një shumë parash që do e merrte familja e tij) të bërtiste në momentin e ekzekutimit: "Pini kakao Van-Guten!".

(Marrë nga faqja në FB e autorit)



A i keni parë të ashtëquajturat "emisione bamirësie" ku në këmbim të një shtëpie, fatkeqëve të këtij kombi u duhet të ngashërehen në lotë përpara kamerës, të demonstrojnë se si e hanë krodhen e bukës me vaj dhe sheqer; si flenë në të ftohtë, me batanije të leckosura nën çatinë e kasolles që po i zë përfund?!

Për hir të klikimeve, publikut shqiptar i janë servirur prej dekadash sherre familjare për çështje pronash tek "shihemi në gjyq", "manuale" për rrëmbime, përdhunime dhe vrasje me strategji të detajuara pa kursyer as fëmijët. E kujtoni videon e vajzës nga Librazhdi që u kap në flagrancë duke tradhtuar burrin nga vjehri dhe vjehrra? Pikërisht, këto dhe shumë episode të tjera, ngjarje krejtësisht personale dhe pa pikën e dobisë për shoqërinë.

Emisionet shqiptare ngjajnë gjithnjë e më tepër me një "dark web" me video makabre, duke konkuruar njëri-tjetrin për nga niveli i perversionit e që përkthehet drejtpërdrejtë në klikime.

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë. Komentet ose opinionet tuaja botohen bazuar mbi lirinë e gjithësecilit, pa qëllim fyerje apo denigrim të individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore dhe politike. Për të botuar opinionin/komentin tuaj mund të na shkruani në <rrugaearberit@gmail.com>

profil



Në foto: Bardhyl Muça.
Foto kryesore: Një grup turistësh përpara hotelit

Bardhyl Muça e djemtë, një histori suksesi në Bllatë të Dibrës

Sukseset e tyre në bujqësi, blektori, hoteleri dhe shërbimet turistike, është një dëshmi se agroturizmi ka të ardhme dhe se ky vend nuk duhet braktisur, pasi ofron plot mundësi për të jetuar

Nga **OSMAN XHILI**

Këtu e 150 vjet të shkuara, Rahman Muça do të zbriste nga malet e Selishtës për një jetë më të mirë. Ndoshta e kishte pikasur që më parë në Bllatë, një tokë të rrafshët e pjellore, diku pranë kufirit të sotëm, me Maqedoninë e Veriut. Këtu shpresonte të fillonte një jetë të re për vete, familjen dhe brezat që do të vinin më pas. I derdhi florinjtë sundimtarit të vendit dhe e shkeli tokën, sipas zakonit. Familja e Rahman Muçës u bë një fis i madh e i njohur, duke lënë pas trashëgimtar të denjë, që punojnë e realizojnë projekte të mëdha.

Dilaver Muça ishte një nga tre djemtë e Rahmanit. Ai kishte trashëguar cilësitë më të mira të malësorit, punën, trimërinë dhe bujarinë. Akoma pa mbushur 18 vjeç u rreshtua në brigadën e 18 sulmuese dhe mori pjesë në shumë beteja. Njëra prej tyre ishte lufta për çlirimin e Tiranës, ku dhe mbeti i plagosur. Dhe pse në atë situatë kritike, ai mori pjesë dhe në luftën për çlirimin e Shkodrës, që shënonte dhe përfundimin e luftës.

Ashtu siç dhe kishte luftuar me heroizëm, me po aq vrull ai dinte dhe të punojë. E filloi në portin e Durrësit, në sektorin e trimozhave, për të ardhur më tej në Bulqizë, më afër vendlindjes. Kishte mall e nostalgji për tokën ku u lind dhe u rrit e nuk donte të largohej prej saj. Për dhjetëra vite u ndesh me malin, për ti thithur materialin e kromit, pa u lodhur dhe pa u ankuar. Shpesh i ndihmonte punëtorët e rinj, duke u treguar të fshehtat e profesionit. Sa herë që gjente njerëz të pastrehë, në netët e acarta të dimrit, ai i merrte, i strehonte, por dhe i ushqente, për t'i përcjellë të nesërmen në destinacion. I thanë të merrte shtëpi në Durrës, i thanë dhe në Bulqizë, por ai nuk pranoi. Sa të dilte në pension do të shkonte tek toka, që babai i tij e kishte blerë me florinj. Madje dhe fëmijëve do t'ua linte amanet, që të mos e braktisnin vatanin.

Bardhul Muça, bashkë me djemtë e tij, Landin, Ervinin dhe Genin janë nga filizat e këtij fisi, brezi i tretë dhe i katërt, pas shpërnguljes nga Selishta.

E kam njohur Bardhulin që nga bankat e shkollës tetvjeçare, kur ai shquhej si një sportist i talentuar në futboll, volejboll e gara vrapi. Ashtu vrapoi ai dhe në jetë, për të mos u ndalur kurrë dhe sot e kësaj dite. Bëri një shkollë për saldator, duke arritur në majat e këtij profesioni, të rëndë, të rrezikshëm, por dhe të bukur.

Metalurgjiku i Elbasanit do të ishte stacioni i parë i punës, por dhe sprova e madhe. Nuk mbeti qosh i kësaj vepre të madhe të kohës, ku ai nuk punoi, nuk saldoi e nuk derdhi djersë. Më tej vazhdoi në Tiranë me brigadën e montimeve, për tu kthyer më pas në Bulqizë. Këtu, jo vetëm punoi, por dhe përfundoi shkollën teknikum minierash, pasi donte, që të zgjeronte maksimalisht njohuritë e tij. Ai ishte saldator, pompist, elektriçist dhe shumë profesione të tjera të kësaj natyre.

Erdhën vitet e demokracisë dhe shumë shqiptarë provuan të punojnë në Perëndim. Bardhuli ishte njëri prej tyre. Nuk shkoi shumë larg, por në Greqinë fqinje. Shumë nevojë kishin për profesionin e tij. Duhej bërë lidhja e konstruksioneve të mëdha metalike në ura, liqene e projekte të tjera. Ai dinte t'i bënte më së miri këto lloj punësh, aq sa specialistët grekë mbetën të habitur. Duart e arta të Bardhulit dini të bënin mrekulli. Ndaj dhe letrat e tij të qëndrimit u bënë për 18 ditë,



Në foto: Osman Xhili me dy fëmijët e Bardhylit: Ervini dhe Geni.

Kur njerëzit po i pakësojnë dita-ditës blegtorinë, kur të rinjtë gjejnë dhera të huaj për të jetuar, këta djem të mrekullueshëm, po bëjnë të kundërtën. Përcjellin mesazhin se ky vend nuk duhet braktisur, se afron plot vlera e mundësi për të jetuar.

kur për të tjerë duheshin dhe vite nganjëherë.

Dhjetë vite zgjati kjo histori në shtetin grek. Një ditë Bardhuli u kthye në Shqipëri. U kthye dhe pse lejen e qëndrimit e kishte pa kufi, dhe pse mund të blinte lehtësisht një banesë për të jetuar. Veç dëshirës së tij ishte dhe amaneti i babait, apo gjyshit të fëmijëve. Kishte fituar mjaft para për të bërë një investim të fuqishëm. Durrësi e tundoi me plazhin dhe detin. Bleu një tokë, mjaft pranë bregut dhe ndërtoi një vilë trekatshe. Por gjyshi Dilaver e kishte dhënë verdiktin e tij, ndaj dhe sot e kësaj dite ajo vilë e bukur është bosh.

Sërish ndërtuan një vilë të re trekatshe, por tashmë në vendlindje, vetëm disa qindra metra larg trojeve të vjetra. Atje kishin dhe shumicën e tokës. Ndërtuan dhe një stallë gjysmë moderne për blegtorinë, që do mbarështonin. Nuk do të ishte një fillim i ri, pasi familja e tyre historikisht kishte pasur katër pesë lopë dhe mbi njëzetë të imta. Blegtoria duhej për të plehëruar tokat e shumta, që po mbilleshin me kultura të ndryshme.

Gjithë ai vrulli i saldatorit u konvertua në bujqësi. Filloi të sistemojë tokat, t'i rrethojë, të bëjë drenazhime në disa vende. Tashmë, nuk ishte më i vetëm. Tre djemtë e tij, Landi, Ervini dhe Geni ishin rritur. Hera herës shkonin në Greqi e Itali e më pas vinin dhe ndihmonin në punët e bujqësisë e blegtorisë. Ervini që 15 vjeç kishte provuar kurbetin. Kishte punuar në bujqësi, por dhe pica provoi të bënte me sukses. Këtë eksperiencë do ta kishte të nevojshme, kur të hapte lokalin e tij, vite më vonë. Po kështu punuan Landi dhe Geni, duke fituar para, profesione, por dhe gjuhën e kulturën e këtij populli, të përmendur që në lashtësi. Ndoshta ishte ai geni familjar, i babait, gjyshit dhe stërgjyshit, që diktonte karakterin punëtor.

Ferma e tyre kishte qenë e përmendur që më parë, por tani, sëbashku ata po e fuqizonin akoma më shumë. Gati çdo vit ata mbjellin mbi 50 dynymë grurë dhe elb, duke marrë rendimente për tu pasur zili. Të tilla janë rendimentet në misër, ku mbillen deri në 15 dynymë. Misri shkon për blegtorinë që mbarështojnë, kurse mbi 15 kuintalë fasule shitet e pëlqehet mjaft nga konsumatorët. Të tjera të ardhura vijnë nga jonxha, që plotëson nevojat e blegtorisë dhe sjell dhe të ardhura ekstra nga shitja e farës.

Perimet janë një vlerë e shtuar e kësaj ferme. Qepa, bamja, patëllxhani, karota, speci e shumë të tjera, mbushin jo vetëm tryezën e kësaj familje të madhe, por dhe tryezat e lokalit, që kanë hapur para dy vitesh. 50 kuintalë qepë u prodhuan vitin e kaluar, në më pak se një dynym vend. Vetëm një kokërr e saj mund të peshonte 750 gramë. Patatet e specat janë nga më të mirat e tregut.

Por, dhe pse këto arritje janë me goxha vlerë, sërish Ervini, i sheh vetëm si një stacion i përkohshëm, për tu transferuar më larg e më lart. Ai synon të ngrejë një stallë moderne me plot 100 krerë lopë e viça. Nuk është një ëndërr e gjithë kjo ide, por një synim i qartë. Nuk ka pasur ndonjë rast në historinë e kësaj familje, që të kenë synuar diçka e të kenë dështuar, për ta lënë më pas në sirtarin e harresës. Sa gjë e bukur realizimi i këtij projekti! Kur njerëzit po i pakësojnë dita-ditës blegtorinë, kur të rinjtë gjejnë dhera të huaj për të jetuar, këta djem të mrekullueshëm, po bëjnë të kundërtën. Përcjellin mesazhin se ky vend nuk duhet braktisur, se afron plot vlera e mundësi për të jetuar.

Thamë që familja Muça hapi lokalin dhe hotelin para dy vitesh, tamam në hyrje të doganës së Bllatës. Pamja e bukur, trëndafilat dhe bimët dekorative, parkingu i bollshëm, e bëjnë kalimtarin të ndalet e të pushojë për pak. Por dhe shërbimi brenda është në sinkron me pamjen e jashtme. Gjithë familja është angazhuar në këtë biznes, për të kënaqur maksimalisht klientët e shumtë që vijnë. Jo vetëm vendas, por dhe turistë të huaj kanë gjetur strehë dhe kanë kënaqësinë të akomodohen këtu, për një apo më shumë ditë. Ervini tregon se para ca ditësh patën disa persona nga Ukrahina, sonte një familje nga Çekia e më pas prenotimi se vjen e bëhet më i vështirë, sa më shumë që i afrohemi stinës së verës.

Para pak netësh familja organizoi një iftar me miq e besimtarë të zonës. Ushqime të bollshme e bio u sevirën me shumë bujari e ne nuk na ngelej gjë tjetër, veçse të lusnim Zotin e Gjithësisë, që t'ia shtojë bujarinë e furnizimin kësaj familje të mrekullueshme.

Rruga e Arbërit nr. 198

edukim





“Pasha Shqipërinë time zemrake”

Në historinë e arsimit dhe të shkollës shqipe nuk ishte parë ndonjëherë një masivitet i tillë me ritme të larta për ngritjen e një sistemi të tërë shkollor, shtrirjen e tij në të gjithë vendin për zhvillimin e arsimit e të kulturës. Edhe bijtë e Luznisë, ambiciozë prej natyre, u përfshinë me entuzizëm në këtë lëvizje masive popullore. Njëri ndër ta ishte edhe Fiqiri Cani.

Nga **Bajram XHAFA**

Shkolla 9 vjeçare e Luznisë nga sot merr emrin “Fiqiri Cani”, birit të zonës tuaj. Edhe pse e re por e rikonstruktuar, këtu midis malesh ajo shndritka nga bukuria. Megjithëse kam kaluar përmes Luznisë me dhjetëra herë kur isha nxënës konviktor në shkollën 7 vjeçare dhe të mesme Pedagogjike të Peshkopisë në vitet 1958-1964, në jetën time është e dyta herë që prek Lishanin e shmangur nga “magistralja” kryesore sikur te deshte të fshihej ndërsa përshkoja në këmbë rruën nga Kovashica ime – via Qafë – Shtushën - Gjurra e Mazhicës - Qafa e Hoteshit - Ura e Telit - Peshkopi për të mbërritur në shkollë dhe në konvikt, shtëpinë tonë të dytë. Herën e parë në vitin 1987 i ftuar në një dasëm dhe sot për emërin e shkollës.

Ndonëse nuk isha planifikuar për të folur, më bënë nderin për një përshëndetje si “shkodran” nga Dibra. Por unë nuk mund t’ia lejoja vetes, jo vetëm për arsye profesionale, të anashkaloj e të hesht për një ngjarje që lidhet me vendin ku jemi, këtu në Luzni, ngjarje që peshon rëndë në historinë tonë kombëtare. Eshtë fjala për Luftën e Dibrës të 1920-ës. Në vitin 1987 nuk dija thuajse asgjë për të. Programet shkollore dhe Historia akademike e Shqipërisë (e v. 1965 e 1984) e injoronin thuajse tërësisht sikur të mos kishte ekzistuar. Kur më 1997 mbrojta doktoraturën me temën “Lufta e Dibrës 1920”, u binda plotësisht se Historisë së Dibrës i ishte bërë komplot me heshtje, siç i bëhet sot komplot me zhurmë e potere me Skavicën.

Historia e vërtetë e Shtetit Shqiptar fillon më 1920-ën. Kongresi i Lushnjës, Lufta e Vlorës kundër okupatorëve italianë, Lufta e Koplikut dhe Lufta e Dibrës kundër okupatorëve serbo-jugosllavë, që të gjitha brenda një viti, - 1920.

Në fillim të gushtit 1920 në Arras, në shtëpinë-kullë trekatëshe të Riza Lushës, sapo ishte vendosur administrata e prefekturës së Drinit (Dibrës) me prefekt Ramiz Dibrën. Që nga mëngjesi deri në mbrëmjen e datës 7 gusht 1920 në Arras u festua fitorja e Luftës së Vlorës e cila i hodhi në det italianët. Çlirimi i Vlorës ishte një nxitje më shumë edhe për dibranët. Përtej Drinit, mu përballë tyre qendronte si mish i huaj gangrenoz ushtria serbo-jugosllave e cila filloi të vringëllojë armët e të nisë planet e luftës. Komanda jugosllave bëri përpunimin me artileri. Që nga Lisi i Trenës përtej Drinit, ku ajo kishte një bateri artilerie, bombardoi me top postën shqiptare të xhandarmërisë në Luzni që e kishte përballë. Pastaj këmbësoria kaloi Drinin dhe hyri në Luzni me synim Rrafshën e Myrkajve në Arape të Epërme por objektivi kryesor i saj ishte posta e xhandarmërisë shqiptare vendosur te Kulla e Manukës, këtu në Arapaj. Ata u ndeshën aty me xhandarët e “Qeverisë së Arrasit”, siç quhej Prefektura e Drinit me komandant të postës nëntoger Jashar Zeneli. Brenda në kullën e rrethuar, komandanti i saj organizoi me xhandarët një mbrojtje heroike në pritje të ndihmës nga Arrasi.[1)]

Kur më vitin 2001 botova librin “Lufta e Dibrës 1920” (CP, Shkodër, 2001), Skenderi

Qendresa në Kullën e Manukës qe preludi i Kryengritjes së Madhe Çlirimtare të Dibrës më 15 gusht 1920 kundër Serbisë imperialiste i militariste. Me një sulm rrufé, brenda një dite, dibranët e vunë para ushtrinë serbe dhe e hodhi atë përtej Dibrës së Madhe.

(alias Dullë Zeneli), i biri i Jashar Zenelit më shprehu përgëzime e komplimente për përshkrimin që i kisha bërë luftës në rrethim te Kulla e Manukës, qendresë të cilën e kishte drejtuar dikur i ati i tij.- E ke ba shumë emocionuese, më tha, si “Oso Kuka në kullë të barotit” te Kalaja e Vraninës. Nuk më kishte shkuar mendja por krahasimi i tij më ngjiti fort. – Kështu e përfytyroja vërtetë atë ngjarje të bazuar mbi ato që kanë lënë dëshmitarët e kohës. Ngjarja është reale i thashë Skënderit dhe unë nuk kam shpikur as kam trilluar asgjë prej vedit.

Pastaj shtova: Gjatë historisë, në luftëra të ndryshme gjithmonë e gjithkund janë bërë heroizma nga luftëtarë të ndryshëm që kanë lënë mbresa të thella por akti i Oso Kukës në histori asht fenomen tipik shqiptar. Duke u përballur me armiq të shumtë dhe gjithmonë të vetëmuar, të sulmuar në pabesi nga të tjerët, shqiptari është vënë përballë rrezikut ekstrem pa alternativë (tjetërnajë): ose – ose, por me opsionin vetëm me një kahe: “me vdekë” e s’ka tjetër; “me bâ dekën si me le”. Në një rast të tillë, për shqiptarin shqetësim ishte që këtë akt sublim ta bënin sa ma të hijshëm, frymëzues e shembullor. Dëshira minimale e tij ka qenë: “të paktën të paguaj veten”.

Në kujtesën e shqiptarëve ishte i gjallë akti heroik deri në legjendë i Oso Kukës me 12 qershor 1861 kur, i rrethuar nga 800 cuba malazezë, me 20 trimat e tij hodhi veten në erë bashkë me disafishin e armiqve duke i vënë flakën fuçive të barutiti brenda Kullës. Dëshira për ta bërë Kullën e Manukës të Luznisë si shembulli Oso Kukës në Kullën e Vraninës 60 vjet më parë nga komandanti i postës ishte afërmendsh. Shqiptarët nacionalistë i kishte kapluar avulli i nxehtë i pavarësisë dhe shtetformimit. Flijimet ishin në llogari të misionit kombëtar. Kishte një entuziazëm atdhetar që sot nuk e marrim me mend.

Mua, shkruesit të këtyre radhëve nuk do të më jepej më ndonjë rast tjetër për ta “promovuar” një histori të tillë, sepse nuk më premtonin as vitet dhe as vendi. Vendi ishte pikërisht aty. “Kullën e Manukës” në Luzni nuk mund ta gjeja më. As kohën.

Qendresa në Kullën e Manukës qe preludi i Kryengritjes së Madhe Çlirimtare të Dibrës më 15 gusht 1920 kundër Serbisë imperialiste i militariste. Me një sulm rrufé, brenda një dite, dibranët e vunë para ushtrinë serbe dhe e hodhi atë përtej Dibrës së Madhe.

Në kohën kur në Luzni zhvilloheshin luftime të ashpra me forcat serbe dhe nga Lisi i Trenës ajo bombardohej me artileri, në Arras u mblodh “Dheu”; pari´e vegjëli (pari´e ehali´[2)]. Një kuvend i madh popullor, epik, prej 700-800 burrash nga mbarë Dibra: - Kuvendi i Arrasit, mbajtur me 13 gusht 1920 tek vendi i quajtur Ferra e Pashës, afër Urës së Lushës. Kuvendi mori vendimin për të filluar kryengritjen me 15 gusht 1920 e për ta shkulur ushtrinë serbe prej Dibrës, ashtu siç u shkulën italianët prej Vlorës. Historia e Shqipërisë vuan tmerrësisht nga tëpathënat, gjysmëtëthënat dhe të mbrapshtëthënat.

Duke diskutuar me mikun tim të vjetër, Baletën, që jeton në katin V te “Myslim Shyri” në “Kullën e barotit”, pa e vrarë shumë mendjen i them se tashmë nuk ka më shqiptarë si në kohën e Oso Kukës. Isha ndikuar nga disa komente të cilat u vlerësoja realiste se në Shqipëri nuk ka më nacionalizëm. – Ka, tha. Është Adem Jashari që u flijua me vetëdije pa u menduar dy herë. U shkri me gjithë vllazën e djem mixhallarësh, shtatëmbëdhjetë vetë, të gjithë të një gjaku, të një kulmi e të një shtëpije. Një “fushë e tërë vorresh” më vete, ku kisha qenë edhe vetë për homazh. - Sa hazerxhevap që je, i thashë për argumentin e gjetur aq shpejtë. Po sa shembuj të tjerë të ngjashëm tregoi Çlirimi i Kosovës. “Pema e papjekur nuk hahet, as fjala e papërtypur nuk nxirret”. thashë me vete. Në fakt nuk bëra keq sepse, po nuk e nguce të urtin, ai nuk mund të hamendësojë se ç’farë mungesash ke në kokë dhe në peshoren e vlerësimeve tuaja për ngjarjet.

Fenomenin shqiptar e shoqëron paradigma e mallkimit shqiptar, e, nëse është kështu, atëherë duhet ta pranojmë si providenciale, që vjen nga Lart. E kësaj nuk mund t’i ikim. Kështu e ka shumë herë historia e popullit shqiptar. Lartësohet qendresa e Greqisë ndaj persianëve, reale apo e sajuar, që më shumë kanë bashkëpunuar se i kanë luftuar ato, por Aleksandri i Madh, që është i racës sonë, me vetëm 35 mijë dibranë e matjanë iu rras brenda dhe e uli në gjunj Persinë; e zhbëri atë dhe ngriti një Perandori. Shkoi pastaj edhe në Pakistan e deri në Pexhab të Indisë. Po bëmat e Pirros (Burrit) së Epirit, të Skënderbeut. Historia ofron shembuj të shumtë të papromovuar. Kur ka lidhë besën burri i Shqipnisë i ka shti dridhmën gjithë Rumelisë. O ju burrat e Shqipërisë time zemrake!

* * *

Të kthehemi tek objekti ynë, Fiqiri Cani për të cilin jemi mbledhur.

Pas vitit 1944 në Shqipërinë tonë (Londineze) u vendos një sistem i ri shoqëror i cili mori përsipër një revolucion të thellë dhe ekstensiv arsimor e social kulturor. Në historinë e arsimit dhe të shkollës shqipe nuk ishte parë ndonjëherë një masivitet i tillë me ritme të larta për ngritjen e një sistemi të tërë shkollor, shtrirjen e tij në të gjithë vendin për zhvillimin e arsimit e të kulturës. Edhe bijtë e Luznisë, ambiciozë prej natyre, u përfshinë me entuzizëm në këtë lëvizje masive popullore. Njëri ndër ta ishte edhe Fiqiri Cani.

Megjithëse shumë nga këto që thashë më lart nuk i lexova, moderatoren e shkathët të veprimtarisë e vura në siklet, se “i rrëmbeva kohën e favortë”. Nuk ishte vendi për trajtime “akademike” dhe mu lut ta “shkurtoja”.

Për emrin dhe veprimtarinë e të protagonistit folën me shumë nderim dhe kompetencë drejtori i shkollës Ilmi Murrja. Pastaj secili nga pozicionet e tyre zyrtare folën kryetari i Bashkisë së Dibrës Rahim Spahiu dhe kryetarja e Këshillit të Qarkut Valentina Haliti (Doda), si drejtues të institucioneve që kishin sponsorizuar restaurimin e shkollës me një shumë të konsiderueshme prej 35 milionë lekësh, drejtoresha e Arsimit Dibër, i dërguari i ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, deputeti i zonës Lavdërim Krashi, i kudogjindshëm në raste të këtij lloji. Në emër të familjes falenderoi me fjalë plot ndiesí e përzemërsi z. Hilmi Cani, vëllai i të ndjerit

Mirënjohja është një detyrë që duhet la(rë), nuk është një e drejtë që mund të kërkohet. Sot u bë gjëja e duhur. Atëherë mua nuk më mbetet tjetër veç ta mbyll me dy maksima për njerëzit që i kushtohen arsimit, dijes, kulturës dhe shkencës:

1. “Midis gjakut të dëshmorit (shehitit) dhe bojës së shkrimit të dijetarit, kjo e fundit më vjen më e rëndë” ka thënë Pejgamberi a.s.

2. Vlera e Mësuesit dhe pesha e Qiellit nuk maten, ka thënë Konfuci. Këta vlerësime vlejnë edhë për Fiqiri Canin, emrin e të cilit tashmë mban shkolla juaj. E gëzofshi për jetë e mot!

Luzni, 29 mars 2023.

1 H. Stërmilli, “Dibra në prag të historisë” edhe tek “Kujtime dhe këngë...”, f. 218; B. Totraku, kujtime të mbledhura.

2 Ehali në arabisht do të thotë “njerëz të zgjedhur”, porse në të folmen e popullit pat marrë kuptimin “popull”, vegjëli, hali.

Njoftim për shoqata dhe organizata joqeveritare

Redaksia e gazetës vendos në dispozicion të shoqatave me fokus Dibrën dhe organizatave joqeveritare hapsira për botimin e veprimtarive apo studimeve të tyre. Redaksia vendos staf që ju ndihmon në shkrimin e kronikave, reportazheve, fotografive dhe teksteve të ndryshme për publikim në media dhe rrjetet sociale etj.

Tarifat e botimit për shoqata dhe OJQ-të janë me kostot e botimit.

Për më shumë informacion telefononi në numrin **0692068603**

ose shkruani emailit: **rrugaearberit@gmail.com**

aktualitet

Në zgjedhjet vendore që do të zhvillohen më 14 maj, për Bashkinë Bulqizë do të jenë në garë: Festime Mjeshtri nga Partia Socialiste dhe Dëfrim Fiku nga koalicioni "Bashkë Fitojmë".

Arrestohen kryetari dhe disa drejtues të Bashkisë Bulqizë, falsifikuan 2.8 milionë euro tender për kanalizimet

Nga SAMI CURRI
bulqizaime.al

Drejtuesit kryesorë të Bashkisë së Bulqizës, përfshirë kryetarin socialist Lefter Alla, ranë në pranga pas një hetimi të Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, nën akuzën se kanë falsifikuar dokumentet e një tenderi me vlerë 322 milionë lekë (afro 2.8 milionë euro) që synonte të rinovonte rrjetin e kanalizimeve në lagjen e vjetër të qytetit minerar.

SPAK bëri të ditur se punonjësit e bashkisë patën favorizuar në tender dy kompani, Egland shpk dhe BE-IS shpk, ndërkohë që punimet në terren dyshohet se janë kryer realisht nga një kompani e tretë, OE 2AF Albania shpk, për të cilën prokurorët thonë se ka lidhje me kryetarin e arrestuar të bashkisë.

"Nga hetimi ka rezultuar se për shtetasin nën hetim L. A. me detyrë Kryetar Bashkie me funksionin e tij si i zgjedhur vendor për të administruar konform ligjit Njësinë vendore Bashkinë Bulqizë evidentohet qartësisht sjellja e tij duke dokumentuar disa fakte penale si shkeljet gjatë procedurës së prokurimin publik me proçedurë të hapur në datë 30.04.2021, operatorëve ekonomikë "Egland Sh.p.k" dhe "BE-IS" Sh.p.k, me objekt "Ndërtimi rrjetit furnizimit dhe rrjetit shpërndarës Ujësjellësi dhe ndërtimi i rrjetit të KUZ , Lagja e vjetër, qyteti Bulqizë, Bashkia Bulqizë", me vlerë të tenderit në shumën 322.439.000 lekë të reja, me afat kohor 10 mujor," bëhet e ditur nga njoftimi i SPAK.

"Ky shtetas nën hetim në bashkëpunim me nënkryetaren e Bashkisë, dhe punonjësit e tjerë, si specialiste e prokurimeve, anëtarët e KVO, kanë bërë të mundur që këtë tender ta fitonte me dokumentacion BOE Egland shpk dhe BE-IS shpk, duke krijuar avantazhe për këtë subjekt gjatë procedurës së prokurimit. Në një kohë që nga hetimi ka dyshime të arsyeshme të bazuara, se punimet janë kryer nga OE 2AF Albania shpk, lidhje shoqërore e kryetarit të Bashkisë," vijon më tej njoftimi.

SPAK ka zhvilluar përgjime gjatë kësaj periudhe dhe ka provuar se Alla ka pasur kontakte dhe komunikime me biznesmenin Aqif Konesha i kompanisë që kryente punimet për kanalizimet. Mësohet se së bashku kanë udhëtuar jashtë vendit me makinë. Ndërsa nënkryetarja e bashkisë Bulqizë, Enkeleda Lleshi, që është mes të arrestuarve për abuzim, kishte dhënë më herët dorëheqje nga detyra pasi nuk donte të bëhej palë në firmosjen e tenderëve, por kanë arritur ta bindin që të kthehej.

Nga hetimet ka dyshime të forta se kryebashkiaku Alla, në bashkëpunim me nënkryetaren e Bashkisë Enkeleda Lleshi, si edhe punonjësit e tjerë kanë favorizuar dy kompanitë 'BOE Egland shpk', dhe 'BE-IS shpk', gjatë procedurës së prokurorimit publik. Ky favorizim i këtyre dy kompanive është bërë me qëllim që më pas punimet për ujësjellësin t'i kryejë kompania 'OE 2AF Albania shpk', e cila është në administrimin e të afërmit të Allës, Aqif Koneshës.

Kryebashkiaku Alla në bashkëpunim me zyrtarët e tjerë kanë miratuar kritere për të favorizuar dy firmat 'BOE Egland shpk' dhe 'BE-IS shpk' që morën pjesë në tender. Pasi i shpallën fituese këto firma, punimet për kanalizimet realizoheshin nga firma 'OE 2AF Albania shpk'. Bëhet fjalë për tenderin "Ndërtimi rrjetit furnizimit dhe rrjetit shpërndarës Ujësjellësi dhe ndërtimi i rrjetit të KUZ, Lagja e vjetër, qyteti Bulqizë, Bashkia Bulqizë", me vlerë rreth 3 mln euro, me afat kohor 10 mujor. Kompanitë që dolën fituese të tenderit kanë si administrator Rasim Dacin, për 'BOE Egland shpk', ndërsa administratori i 'BE-IS shpk', është Kastriot Ibrahimaj.



Në foto: Lefter Alla (i pari majtas), në kohën që ishte kryetari i Bashkisë së Bulqizës, duke inspektuar ndërtimin e një ujësjellësi, gusht 2020. *Foto: Facebook/Bashkia Bulqizë Faqja Zyrtare*

SPAK ka zhvilluar përgjime gjatë kësaj periudhe dhe ka provuar se Alla ka pasur kontakte dhe komunikime me biznesmenin Aqif Konesha i kompanisë që kryente punimet për kanalizimet. Mësohet se së bashku kanë udhëtuar jashtë vendit me makinë. Ndërsa nënkryetarja e bashkisë Bulqizë, Enkeleda Lleshi, që është mes të arrestuarve për abuzim, kishte dhënë më herët dorëheqje nga detyra pasi nuk donte të bëhej palë në firmosjen e tenderëve, por kanë arritur ta bindin që të kthehej.

Ndaj kryebashkiakut Alla dhe nënkryetares Lleshi rëndojnë akuzat për veprat penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" dhe "Shpërdorimi i detyrës". Ndërkohë, ndaj të afërmit të Allës, Aqif Konesha rëndon akuzat për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve". Po për falsifikim dokumentesh akuzohen edhe dy administratorët, Rasim Daci dhe Kastriot Ibrahimaj, ky i fundit është lënë në arrest shtëpie.

Lefter Alla, i cili më parë drejtonte Partinë Socialiste në Bulqizë, mori detyrën e kryetarit të bashkisë në zgjedhjet pa opozitën në qershor të 2019-s. Më parë këtë detyrë e mbante daja i Allës, Melaim Damzi, që ishte zgjedhur si kandidat i koalicionit të majtë, por me propozim nga Lëvizja Socialiste për Integrim.

ARRESTUAR PËR KORRUPSION DHE SHPËRDORIM DETYRE, KËSHILLI I MINISTRAVE SHKARKON ZYRTARISHT LEFTER ALLËN

Pas arrestimit me urdhër të Prokurorisë së Posaçme, Lefter Alla nuk do të jetë më edhe zyrtarisht kryetar i bashkisë së Bulqizës. Me vendim të Këshillit të Ministrave, publikuar këtë të premte datë 24 mars, u vendos shkarkimi i Allës, vendim ky që hyn në fuqi menjëherë. Në mungesë të Kryeministrit Rama, vendimi është firmosur nga zëvendëskryeministri, Belinda Balluku. Kjo e fundit mban njëherësh edhe pozicionin si drejtuese politike e Partisë Socialiste për qarkun Dibër.

"Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1, të Kushtetutës, dhe të shkronjës "a", të nenit 62, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave vendosi: Shkarkimin nga detyra, për shkak të shkeljeve të rënda, të kryetarit të Bashkisë Bulqizë, z. Lefter Alla", thuhet në vendimin e Këshillit të Ministrave.

GËZIM XHAFA, ZGJIDHET USHTRUES I DETYRËS SË KRYETARIT TË BASHKISË BULQIZË

Këshilli Bashkiak i Bulqizës, ka vendosur që ushtruesi i detyrës së kryetarit të bashkisë, deri në përfundimin e mandatit të jetë Gëzim Xhafa. Ky i fundit nuk kishte kundërshtar tjetër brenda këshillit, ku me votim të fshehtë, nga 16 anëtarë të pranishëm arriti të merrte 11 vota pro, katër kundër dhe një votë e pavlefshme.

Xhafa ka mbajtur detyrën e kryetarit të Këshillit Bashkiak Bulqizë dhe ish-kryetar i komunës Fushë-Bulqizë.

Sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore, me përfundimin para kohe të mandatit të kryetarit të bashkisë, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, funksionin e tij e kryen zëvendëskryetari i bashkisë. Referuar po këtij ligji, në rastin kur vendi i kryetarit të bashkisë mbetet vakant gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të tij, këshilli përkatës zgjedh nga radhët e veta një kryetar të ri me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, i cili ushtron funksionet deri në përfundim të mandatit.

Seanca për zgjedhjen e ushtruesit të detyrës së kryetarit të bashkisë Bulqizë, nisi me një kërkesë nga disa këshilltar, të cilët kërkuan largimin e medias nga salla, pa dhënë arsye. Këshilltarët e pranishëm, në shumicë vendosën që mbledhja të vazhdonte me praninë e medias.

Në zgjedhjet vendore që do të zhvillohen më 14 maj, për Bashkinë Bulqizë do të jenë në garë: Festime Mjeshtri nga Partia Socialiste dhe Dëfrim Fiku nga koalicioni "Bashkë Fitojmë".

Avokati i Allës: Arrestim politik, nuk pranoi moskandidimin

Në përfundim të seancës në GJKKO, Hysni Demiraj, avokati i kryebashkiakut të Bulqizës Lefter Alla, ka folur para mediave, duke mbajtur të njëjtin qëndrim se është sulm politik. Sipas Demirajt, gabimi i Allës ishte se nuk pranoi të hiqte dorë nga gara në zgjedhjet e 14 majit, ndërsa me ironi, shuma prej 3 milionë euro të tenderit, i duket diçka e panevojshme për të ndërhyrë. "Është fillimi i procedimit. Prokuroria shqiptare dhe gjykata nuk kanë arrestuar vetëm rojën dhe pastruesen e bashkisë. Ne, juristët, duhet të jemi më të matur. Ai bëri gabim që i kushtoi shumë shtrenjtë se duhet të ishte më i zgjuar e duhet të kishte pranuar atë moskandidim. Ne do ndjekim rrugën ligjore, do ankohemi në panel. Skandali më i madh kur akuzohet për 2 akuza. Nëse një zyrtar mund të ketë kryer shkelje të barazisë së tenderave, s'mund

Lefter Alla para marrjes së detyrave në bashki ka qenë biznesmen i suksesshëm. Ju garantoj që nuk ka ndërhyrë në një tender me 3 milionë euro. Edhe në Bulqizë ka jetë, por ai popull nëse është pa bukë, le të mbesin edhe pa atë kanal, le të mbesin edhe pa ujë. 90% e punimeve janë të kryera. Nuk ka hetuar fare prokuroria se si është problemi në terren.

të akuzohet për shpërdorim detyre. Të akuzosh për 2 vepra penale më duket e padrejtë vetëm të bësh bujë, megjithatë sistemi është treshkallësh. Fillimi sa ka nisur. Ne s'kemi në dorë asnjë provë. Ne kemi pasur 2 netë në dispozicion. Ky është sistemi. S'jemi për të shajtur sistemin, por për të mbrojtur Lefter Allën. Lefter Alla para marrjes së detyrave në bashki ka qenë biznesmen i suksesshëm. Ju garantoj që nuk ka ndërhyrë në një tender me 3 milionë euro. Edhe në Bulqizë ka jetë, por ai popull nëse është pa bukë, le të mbesin edhe pa atë kanal, le të mbesin edhe pa ujë. 90% e punimeve janë të kryera. Nuk ka hetuar fare prokuroria se si është problemi në terren. Megjithatë, të mos paragjykojmë, vijojmë hetimet", tha Demiraj gjatë fjalës së tij para medias.

Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka rikonfirmuar masën "arrest me burg" për zyrtarët e bashkisë, përjashtuar Leonard Daçi, sekretar i përgjithshëm në Bashkinë e Bulqizës që për shkak të kushteve shëndetësore u la në arrest shtëpie. Ish-kryebashkiaku i Bulqizës, Lefter Alla ka ankimuar vendimin për masën 'arrest me burg' në Apelin e GJKKO-së. Gjyqtarja e Apelit të Posaçëm, Saida Dollani do të vendosë nëse do e pranojë kërkesën e të pandehurit apo jo. Ndërkohë, seanca është caktuar që të mbahet të premten e datës 14 prill në orën 09:30.

Kodra ku është vendosur kalaja, kontrollon rrugët që lidhin krahinën e Dardhës me Lurën, Reçin dhe Çidhnën. Në majën e sheshtë të kodrës shkëmbore, duken konturet e murit rrethues të kalasë duke formuar një drejtkëndësh të rregullt, me përmasa 29.5 × 20 metër. Muri është i rrafshuar dhe vetëm në anën lindore ku është zbuluar faqja e brendshme e tij, deri në lartësinë 0.8 metër, ka gjerësinë 1.5 metër.

Kalaja e Zhugjërit *dhe Zhugjeri i Historisë*

Nga Kujtim ÇERPJA



Kushdo që jeton në këtë botë ka një dëshirë, ka një kujtim apo një mall që në moment të caktuara e shfaq në forma të ndryshme dhe e lidh atë me ngjarje e sekuenca jete në periudha kohe të caktuar. Por ndër më të bukurat, më të dashurat dhe më të vlerësuarat mbeten kujtimet e fëmijërisë. Ato kujtime të bukura që janë të lidhura me fillesën e jetës dhe me vendlindjen që bukuria e sajë të shoqëron gjithë jetën ku do që të jesh në çdo skaj të globit. Ato kujtime që jetojnë bashkë me ty, që flenë e zgjohen bashkë me ty, që ecin e rrugëtojnë bashkë me ty.

Eh vendlindja, origjina e gjithë kujt që vjen në këtë botë. Ajo mund të jetë reliev i thyer i thepisur, pllajë e butë me livadhe e gjelbërim, zonë malore me lisa e gurë, e ngrohte ose me klimë të freskët por si do që të jet, si do që ta ketë fal natyra, në mendjen dhe kujtimet tona ajo mbetet e bukur, frymëzuese dhe mallëngjyese. Frymëzuar nga jeta dhe kujtimet e fëmijërisë unë sot po shkruaj kujtime për një fshat malor me shumë halle të kohës, por i mbushur me shumë histori. Për një fshat që rrethohet nga male të larta, nga kodra e bregore që në brendësinë e tyre mbajnë një peshë të madhe të historisë e të mbijetesës së këtyre anëve që nuk u gjunjëzuan e s u përkulën në luftrat shekullore osmano- serbe. E ky fshat është Lashkiza e DARDHËS, me lagjet e saj: (Bakaraq, Kodra e Majce, Zhugjerri e Qani).

- Frymëzuar nga kujtimet e vegjëlisë, bukuritë e natyrës e zhvillimet historike që në kohë të herëshme, ketë radhë po sjell në ketë shkrim fshatin Zhugjërr:

Në ngjitjen nga ana veriore e Lashkizës në lartësinë rreth 1200 metër mbi nivelin e detit tek Guri i shkruar nisën fshati Zhugjerr, për të vazhduar ngjitjen në shpatinën e bukur deri në maje të kujthit, laku i krye shenjtëve dhe zbret në anën tjeter për të ndaluar në bregun e burimit të akullt Kroi i Zhugjërrit e përsëri për tu ngjitur deri në vendin historik të quajtur Kalaja e Zhugjërit.

Kalaja; është kjo kala që mora shkasë të sjell në kujtimet e mia vlerat dhe historinë e fshatit Zhugjër, i cili në memorien historike daton me ngritjen e kësaj kalaje ose edhe më përpara saj. Përballë fshatit ndodhet një kodër shkëmbore e zhveshur dhe pa mbrojtje natyrore ku poshtë saj ndodhen rrënojat e kësaj kalaje. Kodra ku është vendosur kalaja, kontrollon rrugët që lidhin krahinën e Dardhës me Lurën, Reçin dhe Çidhnën. Në majën e sheshtë të kodrës shkëmbore, duken konturet e murit rrethues të kalasë duke formuar një drejtkëndësh të rregullt, me përmasa 29.5 × 20 metër. Muri është i rrafshuar dhe vetëm në anën lindore ku është zbuluar faqja e brendshme e tij, deri në lartësinë 0.8 metër, ka gjerësinë 1.5 metër. Ndërtimi është bërë me gurë mesatarë e të vegjël, të lidhur me gëlqere. Në katër skajet e murit, duken grumbuj gurësh, që duket se janë të kullave mbrojtëse në formë rrethore me diametër 2 metër. Brenda murit rrethues në çdo skaj, duket një banesë me përmasa 4×3.5 metër². Këto banesa duhet të kenë shërbyer për bujtina të ushtarëve që ruanin kalanë.

Me botimin e dokumenteve osmane të shek. XVI-XVII, del se kalaja e Lashkizës (Zhugjërit) u ndërtua në vitin 1565, për të vënë në kontroll shtypjen e

kryengritjeve që shpërthyen në sanxhakun e Ohrit dhe veçanërisht në fshatrat e Lurës, Çidhnës, Reçit e Dardhës. Për këto arsye urdhërohet ndërtimi i kësaj kalaje. (Të dhënat statistikore: Marrë nga Dibra në faqen e një ditari arkeologjik autor I.Kaca). (Kalaja e Lashkizës (Zhugjërit), Shpallur monument kulture me datë 08.01.1977, nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës.)

U rritëm me historinë pak të njohura të kësaj kalaje, lozëm me kukafshehtas në mjediset e rrënuara të saj, lozëm kala dibrançe, rrëshqitëm e lozëm me topa bore, pa e ditur se brenda këtyre mureve dhe themeleve ruhej një histori qëndrese e plot pesë shekujve më përpara.

Janë këto themele të kalasë, bashkë me malet e larta për rreth që na bëjnë krenar, me historinë e të parëve tan, që s'u përkulën kurrë përballë pushtuesve osmanë e më vonë atyre serb.

Përballë kalasë në luginën e vogël të fshatit vërshon vrullshëm burimi i kristalt dhe "brisk i ftohtë" (siç thoshin të parët tanë, kur një uji ishte i ftohtë, të priste si brisk), e patjetër që lidhet me historinë shekullore te fshatit sepse quhet: Kroi i Zhugjërit, që burimi i tijë vjen nga shpati masiv me lajthi e quajtur edhe kjo: Lajthia e Zhugjërit. E të tjera emërtesa si: Laku i Kroit, Shpati i Kroit. Kur në mendje të vijnë këto emërtime vendesh dhe objektesh patjetër që logjika të çon se Zhugjëri është një histori faktike e kohërave shumë të hershme.

Zhugjëri kufizohet: në veri dhe veri-lindje me Kunorën e bukur dhe majën e Qelisë, në perëndim me majën e Madhe dhe Qafë-Gëlqeren, në Jug dhe jug-lindje me Karmën dhe Shkaurranin dhe në lindje krijohet një hapësirë që e përball Zhugjerin me gjithë fushë pamjen përpara deri në majën e Korabit. Me sa duket natyra e ka krijuar këtë fushëpamje, strategjikisht për të vrojtuar dhe për tu mbrojtur nga zaptuesit. Thirret fshati Zhugjer sepse ashtu është quajtur prej kohësh që me popullimin e hershëm, kur këtu banonin e jetonin shumë fise, ku edhe sot e kësaj dite ka emërtime të arave, livadheve e shtigjeve të ndryshme. Gojëdhënat e të parëve thonë se, përpara rreth 200 vitesh e kusur, fshati u shpopullua, familjet u larguan pasi moti në periudhën e dimrit ishte shumë i ashpër dhe me reshje dëbore që arrinin deri në 3 m lartësi, e për pasojë u dëmtuan shumë njerëz e blegtori. Banorët ktheheshin vetëm në stinën e verës për verim në stane me blegtorinë. Zgjati shumë vite kjo situatë.

Ndërsa në Lashkizë ishin vendosur dhe banonin katër fise: Çerpja, Hysa, Rasha dhe Topuzi. Në qendër të fshatit ishte vendosur Çerpja me kullat në një plan në krye të asaj pak toke fushë, (kulla e Avdulla Meres, e Ahmet Salis, pak me djathtas kulla e Dalip Rushitit, Xhetan Hakikut dhe Dan Nezirit).

Fisi po rritej, familjet po shtoheshin, kërkesat për prodhim e konsum rriteshin, kështu në fillim të viteve 1900 filluan lëvizjet e para duke u larguar nga Lashkiza për në Zhugjer.

Ishte Ramadan Islami (në moshën vetëm 20 vjeçare) njëri nga djemtë e Islam Adullahut që në verën e vitit 1900 vendosi të ndërtonte një kullë në Zhugjër, e kështu ndodhi.

Në shpadinën e fshatit në një kodër të vogël përballë Korabit ai ngriti kullën tre katshe me rrethim avlli me gur. Pak vite më vonë i bëhen komshi edhe kushërinjtë e tijë Maliq dhe Zeqir Mera, Misim Ahmeti i cili ngriti kullën dy katshe në pikën më strategjike në Maje të Kujthit. E kështu filloi popullimi me Rushit Dalipin, Dull Metën e Halim Hazizin(te gjithë nga fisi Çerpja), duke krijuar një lagje të re mes vëllazërisë.

Pak vite më vonë filluan lëvizjet e para edhe të fisit Hysa. Ata u vendosen në pjesën jugore të Zhugjerit, në një pllajë të sheshtë në tokat e veta, filluan të ndërtohen kullat e para, e Hakik Hysës, Halim Hysës, Selim Hysës e Gani Hysës, Nga që vëndi ishte i rrafshët të parët tanë e quanin Qa dhe për ketë arsye mori edhe emërtimin fshati Qa. Jeta evoluoi u hapën toka bujqësore, u pastruan livadhet, dhe filloi të merrte një zhvillim të mirë blegtoria. Kohërat ishin të vështira, Shqipëria ishte nën pushtimin osman një barrë e rëndë që edhe pse familjet u larguan për më mirë kjo nuk do të thotë se iu shmangën luftës e përballjes me pushtuesin, përkundrazi, terreni dhe pozicioni gjeografik ku ata jetonin i motivonte edhe më shumë për atdhetarizëm.

Zhugjeri është vëndi i burrave që, në të gjitha kohërat ishin bujar, luftëtar, të ditur e punëtor, por edhe të besës dhe trimërisë. Janë këto virtyte që lanë gjurmë të pashlyeshme në memorien e historisë.

"Po të studiosh historinë e Dardhës në të gjitha fazat e zhvillimit shoqëror, rezulton se fisi Çerpja i ka dhënë më shumë të vrarë e të plagosur atdheut si në luftërat anti turke, serbe, italine e pushtuesve të tjerë". (Hysen Ndreu te libri "Dardha në nëntë malet e Dibrës", f.139)

Shumë djemë në moshë të re flijuan jetën me akte heroike. Shembujt janë të shumtë,,, Fillon me Man Islamin nizam në radhët e ushtrisë Turke, u vra në luftën e Perandorisë Osmane kundër Rusisë. Vazhdon me qën-

Janë këto themele të kalasë, bashkë me malet e larta për rreth, që na bëjnë krenarë me historinë e të parëve tanë, që s'u përkulën kurrë përballë pushtuesve osmanë e, më vonë, atyre serb.

dresën e pashembullt të dëshmorëve: Cen Dalipit, Hazis Tahirit e Xhafer Çerpja.

Me qëndresën heroike në luftën e Kaushit 1920 të Ramadan Islamit (i plagosur me gjashtë plagë) dhe një vit më vonë Qershor 1921, ra heroikisht në frontin e luftës në përpjekje më forcat antiShqiptare, (Ramadan Islami ra heroikisht si në luftërat e mitologjisë Homeriane….siç e ka pershkruar Prof. Dr. Bajram Xhafa ne sesionin shkencor me rastin e 100 vjetorit të luftës së Dibranëve anti Serbeve në dt 20.12.2021 në sallën e akademisë së shkencave). Me plagosjen e Misim Ahmetit në vitin 1924 në Peshkopi përkrahë gjeneralit me shajak Elez Isufi. Po a mund të mos përmendet akti burrëror e i guximshëm i Halim Hazizit, në veren e vitit 1947,,, që kaloi një kalvar torturash nga sigurimi i eger shtetëror, por kurrë nuk e tradhtoi besnikërinë ndaj nacionalistëve të dinastisë Ndreu.

Me mendjen e hollë te Xhetan Hakikut që i printe logjikës e fjalës së gjetur, që bënte organizimin dhe informacionin e lëvizjeve në operacionet mbrojtëse të fshatit dhe krahinës etj…

Në harkun kohor prej dhjetë vitesh u ngritën gjashtë kulla, gjashtë kulla Kala që në vitet e luftës 9-vjeçare anti Serbe u dogjën dhe u shkrumbuan disa here, e fundit ishte djegia e kullës së Misim Ahmetit në gusht 1921, e nga qëndresa e dibranëve në tetor 1921 mori fund njëherë e përgjithmonë.

Pas viteve 1921 fshati filloi një jetë tjetër, të rritej në popullsi dhe ekonomi ku në fund të viteve 1990 numëroheshin 30 shtëpi me një popullsi mesatarisht 170 frymë, e bashkë me lagjen e Qanit (Hysën), përbënin rreth 60 shtëpi me një popullsi më shumë se 350 frymë. Gjithmonë në bashkëjetesë e bashkëveprim me vëllezërit e tyre në Lashkizë mbasi thuajse gjysma vazhduan jetën në trojet autoktone në Lashkizë, të gjithë së bashku përbënin një fshat të madh në banesa dhe frymë. U lindën dhe u rritën djem e vajza që me aftësitë e tyre çan në fusha të ndryshme të jetës me plot suksese. Vetëm në vitet 1980-1990 u arsimuan e u diplomuan 16 djem e vajza.

Po sot çfarë të shohim, si ti kujtojmë ato ditë dhe vite në harmoni me njëri tjetrin, në komunikim e bashkëpunim që e zhvilluan e zbukuruan këtë fshat?

Le të jetojnë brenda nesh kujtimet e bukura të fëmijërisë… Sot, në vitin 2023, në fshatin Zhugjer e Qa nuk jeton asnjë frymë njeriu. Të gjithë të larguar. Shtëpi gjysmë të rrënuara dhe shumica të rrënuar plotësisht. Vetmi. Heshtje. Trishtim, mall e dhimbje pa fund kur e përfytyron. E ne, bijtë e tu jemi shpërndarë në të gjithë anët e Shqipërisë, të Europës e Amerikës, për një jetë më të mirë, por mendja dhe zemra janë tek ti, vendlindja jonë e shtrenjtë. Jetojmë me dëshirën dhe shpresën se një ditë do të gjendemi pranë, me të stolisë e me të zbukuruar si një nuse të rrallë. Por, edhe në mos ndodhtë kjo, le të mbeten këto rreshta të hedhur në letër, si një apel në kujtesën tonë, se atje, atje larg kemi lënë të vetme një zonjë të rëndë të mbushur me krenarinë e historinë e qëndresës, me madhështinë e rritjes dhe edukimit të brezave…

cyan magenta yelloë black

speciale

Dita e verës në krahinën e Grykës së Madhe



Nga **LAVDRIM BEQIRI,** *Strikçan*

14 Marsi- Dita e Verës, Festa Unike e Shqiptarëve.

Dita e Verës (Ditëverja) është një festë pagane, unike e shqiptarëve, e lindur para krishtërimit, që festohet vetëm në Shqipëri!

Origjina e Festës i ka gjurmët në Tempullin e Zanës së Malit, të ndërtuar pranë lumit Shkumbin, në Elbasan.

Zana ishte Perëndesha e Gjuetisë së Pyjeve dhe mbarë natyrës dhe dilte vetëm më 14 mars, për Ditëvere, e cila kombinonte me 1 marsin allaturka, që shënonte fillimin e stinës së verës, sepse në atë kohë njiheshin vetëm 2 stinë, 6 muaj verë e 6 muaj dimër!

Kjo është festa më e dashur edhe për fëmijët, të cilët janë paralajmëtarët e parë të pranverës, me zjarret e tyre të ndezura në palcë të dimrit, ku me këngët e tyre garuese mes lagjeve, sikur e trembin atë dhe e detyrojnë të largohet para kohe!

Po kështu simbol fillestar pranveror është dhe vendosja e verores në dorë, kryesisht me ngjyrat simbolike të pranverës, e kuqe dhe e bardhë.

Simbol tjetër është kapja e hekurit në mëngjes, për t'u bërë i fortë si dhe ngrënia e një molle të kuqe. Kujtojmë këtu vargjet e një kënge: "Faqekuq si moll' o moj lule, / vetullat gajtan...!"

Gjellëbërësit e nisnin me byrekun me hithra, ose barishte të tjera pranverore, gatime me mish dhe ëmbëlsira, ku padyshim simbol i festës mbetet ballokumja e Elbasanit, që kohët e fundit, ka filluar të marrë përmasa kombëtare!

Simbol tjetër karakteristik është dhe veza e ngjyrosur, ku gjithsecili mundohet ta bëjë vezën sa më të fortë, që të marrë "Kupën fituese", të kampionatit ditor të vezës më të fortë!

Megjithatë, ajo që i jep më tepër shije ditëveres dhe e bën atë më të bukur, është Lulja e Ditëverës dhe Uji i Ri, që merret 3 ditë rresht, më 12, 13 e 14 Mars, para lindjes së diellit, ku për gjumashët është lajtmotivi: "Ra dielli te mulliri, të lëshofsha gjumin..." dhe përmendej emri i atij që nuk ishte i pranishëm, pra flinte akoma..

SI E FESTOJMË NE DITËVERËN?

Tani po ndaj me Ju ato gjëra që hartova në bashkëpunim me nxënësit e mi, gjë të cilën e bëj për çdo ngjarje kombëtare, një nevojë emergjente kjo, për të ecur me hapin e kohës, jo vetëm nga ana mësimore, por edhe nga ana motivuese, njohëse e edukimit!

Ndezim zjarre kolektive, para se të vijë muaji mars. Gjithësecili jep ndihmesën e tij, duke sjellë dëllinja etj. Kohët e fundit, fatkeqësisht, u vënë zjarrin edhe gomave të makinave, por kjo nuk ka asnjë lidhje me festën. Të helmosh ajrin për ditëvere, nuk ka lidhje me festën. Veroret i vendosim sapo futet muaji mars. Tri ditë para ditëverës, marrim ujë të ri, me të cilin spërkatën njerëzit dhe kafshët e shtëpisë, ku në kovën e vogël të ujit, futen 2-3 gurë të vegjël, pak bar i njomë dhe 1 degë thane e çelur, me të cilën spërkatet sipas formulës:



"Njom', njom' si bari,/ kuq, kuq si thana, / fort', fort' si guri!". Kjo përsëritet tri herë.

Natën e 13 marsit bëjmë gati vezët, kuleçët dhe çantat, për të shkuar të nesërmen në shëtitje, për të mbledhur lulet e ditëverës, të cilat vihen tek dera kryesore e shtëpisë dhe te dera e hajatit (haurit) të bagëtive.



Para disa vitesh, nuk fshihej shtëpia me fshesë 2-3 ditë, për shkak se rrëzohej ara, kështu që një nga fëmijët, mesatarisht të vegjël, shkonte derë më derë tek komshinjtë për të marrë mbeturinat e si shpërblim merrte nga një vezë!

Edhe ky rit shoqërohej me këngë: *"Or... (përmendet një fshat) të këqinj / u lëshofsha klloqtë e zi, / klloqtë e zinj e klloqtë e bardhë, / topa-topa nëpër mëhallë."*

Klloqtë simbolizojnë insektet që janë bartës të sëmundjeve për njerëzit, që vijnë nga mungesa e pastërtisë, e cila mbetet virtyt për kombin.

Megjithatë, si finalizim i gjithë këtyre festimeve, duhej edhe 1 kupë që e merrte Fituesi i Kampionatit ditor: "Veza më e fortë". Aq i rëndësishëm konsiderohej fitorja, sa shpesh përdoreshin edhe hile të vogla, si shtufi në formë veze etj.

Gëzuar Ditëverën! Verë të bukur e të mbarë

VLERËSIME



Zgjedhja e Prof. Adem Bunguri si anëtari më i ri i Akademisë së Shkencave është pritur mirë nga opinioni publik. Disa prej komenteve vlerësuese për profesorin, të shkruara në faqet zyrtare në facebook të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe gazetës Rruga e Arbërit, i përcollëm për lexuesit numrin e kaluar. Dy vlerësimet më poshtë, nga profesor Hajri Shehu dhe piktori Zaim Elezi, të ardhura përmes postës elektronike të gazetës, po i përcjellim për lexuesit më poshtë:

Prof. HAJRI SHEHU:

LART E MË LART I DASHUR ADEMI YNË!

Përshëndesim përzemërsisht akademikun Adem Bunguri.

Kam lexuar me vëmendje të veçantë të gjitha vlerësimet që i janë bërë profesor Adem Bungurit në gazetën prestigjioze "Rruga e Arbrit", në numrin 2, shkurt 2023 nga personalitete të kulturës dhe të shkencës në Dibër. Vlerësimet janë bërë me rastin e zgjedhjes së profesor Ademit anëtar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Vlerësimet janë plotësisht të merituara. Ato janë një sintezë e punës diturore vigane të profesor Ademit. Kjo e thënë është edhe vlerësimi im. Edhe i përzemërt.

Edhe i përzemërt sepse profesor Ademi është njëri nga ish-nxënësit e mi. I shkëlqyer edhe atëherë. Atëherë në bankën e shkollës, tani në Akademi. Dhe gëzohem shumë që ish-nxënësi e ka kaluar ish-mësuesin. Këtë do çdo mësues për nxënësit e tij. Ashtu si prindi. Prindi e do fëmijën mbi veten. Po kështu edhe mësuesi – e do nxënësin mbi vete. Në parantezë: Si Ademi kanë qenë nxënës shembullorë në gjimnazin e Peshkopisë edhe dy vëllezërit e tij – Nexhati (më pas, mjek) dhe Esati (më pas, mësues i gjuhës dhe i letërsisë). Të tre vëllezërit – njëri më i mirë se tjetri. Me një fisnikëri të natyrshme. Të heshtur në fisnikërinë e tyre.

Përkundër dëshirës sime për të folur e shkruar gjatë për profesor Adem Bungurin, do të mjaftohem vetëm me një vlerësim për një libër të tij që është për Dibrën e për dibranët:

Profesor Adem Bunguri është arkeolog i spikatur në fushën e parahistorisë së Shqipërisë e të Kosovës. Dhe punët e mëdha e veprat e mëdha flasin vetë. Një studim i madh i profesor Ademit është edhe "Prehistoria e Dibrës". Është monument për Dibrën. Është libër me format të madh: 450 faqe. Libri është për më të diturit, por edhe për më pak të diturit. Dhe kësisoj, është për të gjithë. Ai duhet të zërë vend në të gjitha bibliotekat e shkollave të të dy Dibrave. Është libri numër një për parahistorinë e Dibrës; por edhe libri numër një për njohjen e vendlindjes. Dhe kësisoj, pjesë e veçantë e mësimit dhe e edukimit të nxënësit. Sepse shkolla dhe çfarë mësohet në shkolla është një ndër themelet e shoqërisë sonë.

Fjala ime e dytë: Lart e më lart i dashur Ademi ynë!

ZAIM ELEZI, piktor:

ADEM BUNGURI, KALORËS I SË VËRTETËS

Adem Bunguri është i lindur për studiues, kalorës i së vërtetës dhe i vendosur pas pasionit.

Që në rininë e hershme i lexoheshin këto cilësi dhe, në heshtje, jam lutur që ai të mund të gjejë fushën ku mund të investohej. Vitet e qëndrimit në Lurë si mësues na larguan fizikisht, por në ato momente të rralla takimesh, ndjeja që Ademi po kërkonte me ngulm mundësi shprehje të aftësive dhe dëshirave të tij. I paepur, ai iu qas kërkimeve në arkeologji, një fushë ku ka shkëlqyer dhe sot me plot gojën, them se titullin e lartë të akademikut, Ademi e rrëmbeu, askush nuk ja dha.

Kapacitetet akademike të tij dukshmërisht na flasin se ai ishte akademik në të gjithë malin me studime të tij. Titulli është thjeshtë një kostum që të mund ta lexojnë edhe ato të zakonshmit që nuk kanë pasur mundësinë të dinë për pafundësinë e dijeve të tij, pasi thjeshtësia e Ademit, nuk të lejon se me kë ke të bësh, urtësia e tij nuk të premton të kuptosh dimensionin e dijetarit dhe studiuesit të madh të tij.

Unë ndjehem krenar që Ademi ka arritur këto maja, i përkëdhelur që ai justifikon më së miri emrin e mirë që ka Dibra për mençuri dhe urtësi. Ademi nuk është i vetëm, ka shumë dibranë të urtë dhe të ditur që janë të heshtur dhe të thjeshtë në madhështinë e aktivitetit të tyre. Dibranët duhet të jenë mbështetës për emra të rëndësishëm dibranësh të sotëm, ashtu si për emrat që kanë bërë historinë e Dibrës. Të përmendin me krenari emrat e tyre në të gjitha forumet ku promovohen vlerat kombëtare, pasi vetëm kështu ne dëshmojmë qytetari dhe civilizim. Duke bërë këtë në vazhdimësi, ne lartësojmë kështu Dibrën dhe veten.

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 198

Evidenca arkeologjike në Shqipëri dhe Kosovë, na shtyn të ndalemi më thellë në këtë çështje, ku gjendet sipas nesh, çelësi për të kuptuar më mirë mekanizmin e shfaqjes së këtij fenomeni gjatë Bronzit të Hershëm, si dhe për të rivlerësuar hipotezën e migracionit "kurgan".

arkeologji

Rivlerësimi i hipotezës së migracionit "kurgan" sipas evidencës arkeologjike nga Shqipëria dhe Kosova



Elementët thelbësor të kulturës kurgane janë: varrimi tumular në varre të tipit "pitgrave", me arkë druri ose të tipit çist, riti i varimit me inhumacion në pozicionin "rombstellungen" ose në shpinë me këmbë të përthyera, shoqërimi i varrit qëndror me varrime rituale bagëtish, kryesisht të kaut ose të kalit dhe përdorimi i okrës ose pigmentit të kuq në varrin qëndror. Inventari i varreve të tipit "kurgan" përmban një ose disa nga objektet e mëposhtme: thikë të gjatë stralli, majë shigjete stralli me fletë trekëndëshe, varëse prej dhëmbë elefanti ose derri të egër, sëpatë guri me kokë të rrumbullakët, topuz guri kryqiform, modelin e karrocës me rrota, spektrin, figurina të kokës së kalit dhe figurina antropomorfe meshkujsh dhe simbole të fallosit.

Nga **Adem BUNGURI**, Akademik

(Vijon nga numri i kaluar

b.Të karakterit lokal

Tiparet kryesore të kulturës së Bronzit të Hershëm në Shqipëri e Kosovë.

Të vendosura në kryqëzimin e rrugëve toksore që lidhin Anatolinë, Egjeun, Ballkanin Qëndror dhe Adriatikun Lindor, Shqipëria dhe Kosova kanë një pozitë të favorshme gjeografike, që ka kushtëzuar përcaktimin e hapësirës së tyre si një zonë kontakti të kulturës indigjene me kulturën egjeo-adriatikase, anatolike dhe ballkano-qëndrore, dhe e ka kthyer këtë hapësirë në një areal mjaft interesant dhe tërheqës studimi.

Në këtë artikull, do të analizojmë tiparet e kulturës së Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, analogjitë kulturore dhe veoritë gjenetike të saj, për të kuptuar më mirë mekanizmin e formimit etno-gjenetik të bartësve të kësaj kulture. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë se të gjitha ndryshimet ekonomike dhe social-kulturore të shfaqura në fillim të Bronzit të Hershëm, janë rrjedhojë e vendosjes së një sistemi të ri ekonomiko-botëror, të bazuar në përdorimin e veglave prej bronzi, në ritjen e rendimentit dhe të fitimit, në ritjen e shkëmbimeve tregtare me fqinjët, në shkëmbimin e mallrave dhe të ideve midis tyre etj. Pikërisht në fillimet e kësaj periudhe, bëhen evidente disa shfaqje të reja kulturore, që e bëjnë periudhën e Bronzit të Hershëm mjaft interesante dhe tërheqëse. Disa nga dukuritë kulturore që duhen përmendur janë:

1. Gjatë Bronzit të Hershëm rritet numri i vendbanimeve të hapura dhe shpellore, kundrejt periudhës pararendëse eneolitike. Në Shqipëri deri tani janë verifikuar me anë gërmimesh sistematike ose hetimore 23 vendbanime të Bronzit të Hershëm, kundrejt 15 të tilla që numërohen gjatë Eneolitit. E njëjta situatë vihet re edhe në Kosovë, ku aktualisht numërohen 13 vendbanime të Bronzit të Hershëm, kundrejt 8 vendbanimeve me depozitime kulturore të Eneolitit

2. Krahas vendbanimeve me horizonte më të hershme banimi, si Maliqi, Treni, Podgoria, Luarasi, Benja, Katundasi, Konispoli, Neziri, Topojani, Dajçi në Shqipëri, apo Vlashnja, Hisari, Deiçi, Gladnica, Gadime e Epërme, Budriga (Gjilan), Zhitkovci, Karagaçi, Pogradja, shpella e Zatriçit dhe Peshterit në Kosovë, shfaqen edhe vendbanime të reja, që e fillojnë jetën pikërisht gjatë Bronzit të Hershëm. Në Shqipëri vendbanime të reja të Bronzit të Hershëm janë: Goroveci dhe Vreshtasi në Korçë, Manasdreni në Dibër, kalaja e Rozafatit, qyteza e Gajtanit, qyteza e Ganjollës dhe qyteza e Belajt në Shkodër, ndërsa në Kosovë, Korisha e Prizrenit dhe Ljushta e Mitrovicës.

3. Në asnjë vendbanim të Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe në Kosovë, nuk janë regjistruar të dhëna, që do të mund të lidheshin me djegje e shkatërrime të dhunshme të vendbanimeve dhe strukturave të vjetra eneolitike[66]. Përkundrazi, ka të dhëna të sigurta për një kontinuitet stratigrafik dhe kulturor dhe vazhdim paqësor të jetës në këto vendbanime[67]. Ky pohim është konfirmuar stratigrafikisht në depozitimet kulturore të vendbanimeve të tilla si Maliqi, Treni dhe Podgoria (Korçë), Benja (Përmet), Katundasi (Berat), Konispoli (Sarandë), Neziri (Mat), Dajçi (Kukës) në Shqipëri dhe Vlashnja (Prizren), Hisari (Suharekë), Deiçi (Klinë), Gladnica (Prishtinë), Gadime e Epërme (Lipjan) dhe Budriga (Gjilan) në Kosovë, në straigrafinë e të cilëve, shtresa e Bronzit të Hershëm mbulon atë eneolitike të vonë. Kjo situatë është konstatuar edhe pellgun e Egjeut dhe në Anatoli, ku gjenden një seri vendbanimesh të Bronzit të Hershëm si Myrina (ishulli Lemnos)[68], Dimini (Volos)[69], Kastraki (Achaea Phthiotis)[70], Lemnos[71], Axia, Nephtina, Kotsinas, Poliokni në Kaspakos, Myrina, Vriokastro[72], Lesbos (Agios Bartholomaios) [73], Liman Tepe (Anatoli)[74], Çukuruçi Höyük të Anatolisë Egjeane (afër Efesit)[75] etj.

4. Shfaqen vendbanimet e fortifikuara me ledhe gurësh e dheu, në ndonjë rast të të përforcuar me palisade (*ramparts*). Përgjithësisht fortifikime të këtij tipi janë stratigrafikisht të lidhura me shtresën e Bronzit të Vonë, siç është provuar tashmë nga gërmimet në vendbanimin shumështresor të Vlashnjës (Prizren), në gradinën e Perçevës (Klinë) etj, por nuk mungojnë indikacionet për ngritjen e tyre edhe gjatë Bronzit të Hershëm, siç mund të ishte shembulli i gradinës së Budrigës (Gjilan)[76]. Në Shqipëri aktualisht, dy janë vendbanimet e fortifikuara që mendohet se i përkasin Bronzit të Hershëm, kalaja e Kukumit[77] në Himarë dhe ajo e Ganjollës[78] në Shkodër. Në Kosovë kësaj periudhe mund t'i përkasin vendbanimet e fortifikuara me ledhe dheu, të përforcuar me palisade, ku rasti më i qartë është Hisari i Nashecit (Prizren)[79]. Në këto vendbanime duket se ka qenë sistemuar aristokracia lokale, që ka futur në zotërim tokat e punueshme dhe burimet e tjera jetësore, me përparësi burimet e xeherorëve të bakrit. Vendbanime të Bronzit të Hershëm, të fortifikuara me gurë janë zbuluar edhe në Anatoli (Liman Tepe)[80] dhe në Greqi, ku ndeshen si fortifikimet me një rrethim (Lerna në Peleponez, Poliokni në Lemnos), ashtu edhe ata me dy rrethime (Kolona në Egine, Kastri në Syros)[81] etj.

5. Shfaqen tumat dhe varrimet tumulare, të konsideruara apriori si monumente të kulturës "kurgane". Por çfarë përfaqësojnë tumat në të vërtetë? A janë ato një fenomen vetëm "kurgan" apo një dukuri e përbotshme dhe universale? Të dhënat arkeologjike mbështesin mundësinë e dytë. Unë besoj se çelësi i shpjegimit të shfaqjes së tumave dhe të gjithë dukurive të tjera gjatë Bronzit të Hershëm, duhet kërkuar në zhvillimet e reja ekonomike dhe sociale që solli përdorimi i bronzit në ekonomi, të cilat Y. Rassamakin i konsideron me të drejtë si shfaqje të një rendi të ri ekomiko-botëror[82]. Që në fazën embrionale të ngritjes së tyre, tumat duket se janë konceptuar si struktura prestigji të ngritura nga aristokracia e re lokale, e cila me ndërtimin e tyre, synonte përjetësimin monumental të kujtimit të të parëve të tyre, duke e ndryshuar përjetësisht landshaftin gjeografik. Sipas A. Harding "*ndërtimi i tumave është një praktikë kulturore e përhapur gjatë Eneolitit dhe Bronzit në Europë*"[83]. Po sipas tij, tumat *"ishin një pjesë e dukshme e landshaftit dhe një kujtues gjithmonë i pranishëm i pranisë së stërgjyshërve që kishin jetuar më parë"*[84].

6. Në Shqipëri nga rreth 170 tuma të studiuara, 24 prej tyre ose 7. 8 % , i përkasin Bronzit të Hershëm, 6 prej të cilave në Shqipërinë Jugore dhe 18 në atë Veriore. Në Shqipërinë Jugore ata janë: tuma I në Pazhok, tuma I në Piskovë, tuma I në Barç, tuma I në Cërrujë, tuma III në Dukat dhe tuma X në Apolloni. Në Shqipërinë e Veriut kësaj periudhe i përkasin tumat I-X të Shkrelit, tumat II, III, VI të Shtojit, tumat I dhe X të Çinamak, tuma IV e Kënetës dhe tumat VII-VIII të Bujanit. Në Kosovë nga rreth 190 tuma të zbuluara dhe 60 të gërmuara[85], kësaj periudhe mund t'i takojnë vetëm varri qëndror i tumës së Rogovës Fushe[86], ai i Banjicës së Pejës[87] dhe ai i tumës së Lubozhdës së Istogut[88].

7. Gjatë Bronzit të Hershëm shfaqen ndryshime të ndjeshme në strukturën dhe morfologjinë kulturore të vendbanimeve dhe tipe të reja të enëve, të cilat si nga forma ashtu edhe nga dekori, nuk kanë asnjë pikë takimi me enët e kulturës "kurgan" të tipit "pit-grave" apoYamna kulturës. Shumica e tyre janë me frymëzime tipologjike nga juglindja, përkatësisht Pelagonia, Thesalia, Maqedonia Egjeane (rrafsha e Dramës), Thrakia Lindore (Ezero) dhe Anatolia (Trojë I-II, Paphlagonia) dhe një pjesë nga verilindja e Ballkanit (grupi Bubanj Hum III). Ndërkaq kultura e Bronzit të Hershëm e Shqipërisë Veriperëndimore është e orientuar kryesisht nga Adriatiku Lindor (kultura Kotorac-Cetina).

a. Analiza kulturore

Nga analiza e kulturës së Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, dhe duke u mbështetur kryesisht në analogjitë e tipeve kryesore të enëve, rezulton se ajo është e orientuar më tepër drejt kulturës së Bronzit të Hershëm të pellgut të Moravës, Pelagonisë, Thesalisë, Maqedonisë Egjeane, Thrakisë dhe Anatolisë. Nga ana tjetër, nuk shënohet asnjë analogji me kulturën "kurgan" të zbuluara në varret e tipit "pitgrave" dhe hapësirat e mbuluara nga Yamna kultura. Një çështje e rëndësishme e lidhur me problemin në shqyrtim, përbëjnë karakteristikat kulturore të fazës Maliq IIIa-b në Shqipëri dhe Hisar IIIa-Vlashnje IVa në Kosovë. Analogjitë e tipeve kryesore të enëve të grupit kulturor Maliq IIIa-b dhe Hisar IIIa-Vlashnje IVa, janë edhe orientuesi më i sigurtë i rrugës së ardhjes së këtyre enëve në Shqipëri dhe Kosovë. Duke ndjekur rrugëpërhapjem e tyre, rezulton se këto analogji të orientojnë më tepër drejt juglindjes, Pelagonisë, Maqedonisë Egjeane dhe Anatolisë, ndërkohë që mungon çdo analogji me enët e kulturës "kurgan". Për të sqaruar më tepër këtë çështje, duhet të krahasohen tipet kryesore të enëve të grupit kulturor të Bronzit të Hershëm Maliq IIIa-b dhe Hisar IIIa-Vlashnje IVa, me grupet e tjera kulturore të Bronzit të Hershëm në Ballkan në njërën anë dhe ato të arealit të kulturës "kurgan" nga ana tjetër.

Tipet më kryesore të enëve të Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë janë:

1. *Enë dyvegjake me vegjë mbi buzë (tab. I, 1-10)* Është një nga tipet karakteristikë për kulturën Maliq IIIa, Hisar IIIa dhe Vlashnje IVa, me përdorim të gjërë edhe në vendbanimet tjera bashkëkohëse. Enë të tilla me variante të ndryshme njihen pothuajse në të gjithë kompleksin ballkano-danubian të Bronzit të Hershëm, e sidomos në krahinat e Ballkanit Qëndror dhe atij Jugor, si dhe në Anatoli. Varianti i enëve dyvegjake me vegjë deri në nivelin e buzëve gjen analogji në grupin Bubanj-Hum III[89], ndërsa ai me vegjë që ngrihen mbi buzë në grupin Armenohori të Pelagonisë[90], në Karagaç II [91]të Mitrovicës, Hisar IIIa[92] të Suharekës, Vlashnje IVa dhe Korishë I të Prizrenit, në Gladnicë III të Prishtinës dhe Gadime të Epërme III të Lipjanit, në Bronzin e Hershëm të Pelagonisë (në vendbanimet e lumit Cerna të Maqedonisë Perëndimore)[93], në Bronzin e Hershëm të Maqedonisë Egjeane (Servia IV) [94], Kastanas (shtresa 26[95], 24 [96], 23 b[97]), në Aksiohori[98], në fazën e Thesalikut të Hershëm III në Thesali (Argissa Magula III)[99], në Bronzin e Hershëm të Anatolisë Egjeane (Trojë I-II[100]) etj.

2. *Enë dyvegjake me vegjë vertikale nën grykë*. Ky tip ene, përveç Maliqit IIIa njihet edhe nga vendzbulimet e tjera të Bronzit të Hershëm të Shqipërisë Jugore me kulturë të tipit Maliq IIIa, si në Tren IIIa[101] dhe në Luaras të Kolonjës. Jashtë terrritorrit të Shqipërisë, vorba tipologjikisht mjaft të afërta me ato me dy vegjë unazore poshtë grykës, ofron materiali i Bronzit të Hershëm të Pelagonisë[102], Maqedonisë Qëndrore[103], Thesalisë[104], në Lesbos (Thermi III-IV)[105], Kastanasit (shtresa 25-24[106], 23a[107], 22b[108] dhe 21-20)[109] dhe në Trojën Ib-IIa në Anatolinë Veriperëndimore[110].

3. *Amfora* me trup të fryrë dhe qafë të zgjeruar në drejtim të buzëve. Analogji direkte, amforat e Maliqit IIIa, shënojnë me ato të shtresës së Bronzit të Hershëm Tren IIIa[111]. Jashtë territorit të Shqipërisë, afërsi tipologjike ofrojnë disa amfora të Bronzit të

studim

Hapësira kolosale e përhapjes së tumave, e bën të vështirë dhe të pamundur lidhjen e këtij fenomeni me një etnitet të caktuar prehistorik, sado i fuqishëm dhe i zhvilluar të ketë qenë ai. Sipas të dhënave arkeologjike, tumat, si monumente varrimi të epokës së bronzit njihen jo vetëm në zonën e kulturës "kurgan", por në një hapësirë gjigande që përfshin tre kontinentet më të mëdha të rruzullit, Azinë, Europën dhe Amerikën Veriore.

Hershëm të Maqedonisë Qëndore [112] dhe të Thesalikut të Hershëm III[113], amforat e klasës E të Thermit[114] etj.

4. *Broka me qafë të gjatë* dhe trup sferik ëmbël bikonik, me një vegjë kryesisht unazore mbi supe, paraqitet në disa variante sipas profilit dhe pozicionit të vegjës. E ndeshur në Maliq IIIb dhe në varrin qëndror të tumës I të Barçit me kontekst të HV III C[115]. Broka të tilla një vegjake qafë gjatë janë gjetur edhe shtresën e Bronzit të Hershëm Tren IIIa[116], ndërsa jashtë territorit të Shqipërisë, forma të ngjashme janë gjetur në ishullin Keos të Egjeut[117], në Trojë I[118], në rrethin e kulturës Glina III-Schnekenberg të Rumanisë[119], në Bronzin e Hershëm të Maqedonisë[120], ndërkohë që ata janë identike me broka të tilla të tumës I të grupit Belotić Bela Crkva[121] të Serbisë Perëndimore, në rajonin e Adriatikut Qëndror dhe prapatokën e tij[122].

5. *Enë me 4 vegjë nën gryk*ë. Tip i rrallë për shtresën Maliq IIIa. Analogjitë më të afërta dhe të natyrshme, i gjejmë në shtresën e Bronzit të Hershëm Vlashnje IVa të Rrafshit të Dukagjinit[123], në grupin fqinjë bashkëkohës të Armenohorit të Pelagonisë[124], në qeramikën e Bronzit të Hershëm të Maqedonisë Perëndimore (lugina e lumit Cerna)[125], madje forma të ngjashme njihen edhe nga faza Istria II e Bronzit të Hershëm dalmatin[126] etj. Forma tipologjikisht të ngjashme ofrojnë dhe disa kultura të tjera të kompleksit ballkano-danubian, që të shpien deri në grupin Vinkovac të Panonisë ose të Morisit të Tisës në veri[127]. Ky tip ene do të vazhdojë të jetë në përdorim pa ndonjë ndryshim të theksuar tipologjik edhe në fazës pasuese Maliq IIIc[128].

6. Filxhanët njëvegjakë *(tab. II, 1-7)*. Me frekuencë më të lartë përdorimi janë filxhanët me trup trungkonik me parete të drejta ose lehtë të rrumbullakuara dhe buzë të drejta apo lehtë të përveshura nga jashtë, filxhanët me trup në formë afërsisht gjysëmsferike apo vezake, filxhanët cilindrikë buzëdalë me parete lehtë të fryra apo ato konikë me buzë të kthyera nga brenda etj. Vetëm një pjesë e këtyre filxhanave përsërisin ose derivojnë tipologjikisht nga ato të tipit Baden të traditës eneolitike vendase, ndërsa të tjerët përfaqësojnë trajta të reja tipike për Maliqin IIIa. Disa nga këto forma janë të njohura dhe nga vendbanimet e tjera të Bronzit të Hershëm të Shqipërisë (Tren IIIa, Katundas V, Nezir IVa)[129] dhe të Kosovës (Karagaç II[130], Hisar IIIa[131], Vlashnje IVa). Shembuj të ngjashëm me filxhanat konikë të Maliqit IIIa, janë gjetur në fazat e mesme dhe të vonë të Bronzit të Hershëm në Aksiohori të Maqedonisë Egjeane[132]. Filxhanat me trup në profil S-je gjejnë analogji të plota në Armenohori të Pelagonisë[133] dhe në Argissa-Magula III të Thesalisë[134]. Filxhanët e thellë me vegjë shiritore mbi buzë, afrojnë tipologjikisht me ato të Thesalikut të Hershëm I të Argissa-Magula III[135], të Eutressis IV dhe Sitagroit IV[136], si dhe me ato të Varvara A_2 të Bosnjës[137] në prapatokën e Adriatikut Qëndror**.**

7. Pjata me buzë të prera pjertazi ose me prerje eliptike *(tab. III, 1-8)*, të ngjashme me pjata të Thesalikut të Hershëm I të Argissa-Magula III dhe Talioti të Thesalisë[138], me pjata të Bronzit të Hershëm të Kjustendilit (Bullgari)[139]. Analogji shënojnë edhe me disa pjata të Trojës I-II (Anatoli)[140], ku paraqiten të zbukuruara në interior me inçizim vijash të shkurtëra dhe ndonjëherë edhe rrathësh të vegjël[141].

8. Kupa me buzë të tërhequra nga brenda, të cilat në Bronzin e Hershëm të Maqedonisë[142] dhe të Thesalisë[143] përbëjnë një nga format më të rëndomta. Shumë prej tyre në Argissa-Magula janë të pajisura nën buzë dhe me kapëse në formë shiriti plastik,




Fig. 6. Tabelë tipologjike e enëve të Bronzit të Hershëm

Shpjegimi i fig. nr. 6:

A: Enë të tipit Kurgan ; nr. 1-4: Sipas Telegin 2002, fig. 3.13,4,9; nr. 5-6: Sipas Telegin 2005, 344, fig. 4, 1, 345, fig. 5. 10.

B: Enë të kulturës Schnurkeramik; nr. 1- 6. Sipas Grömer-Kern 2010, fig. 2 (gr. 723, 3386, 3419, 1055, 3551, 1).

C. Enë të tipit Maliq IIIa: 1-3: Maliq IIIa; 4: Vlashnje IVa; 5: Korishë I; 6: Gajtan I.

D. Enë të grupeve kulturore të rajonit.

nr. 1: Bubanj-Hum III: Sipas Garašanin 1983b,721, tab. XCIX, 9.

nr. 2: Bubanj-Hum II: Sipas Garašanin 1983a, 466, fig. 33-III, 1.

nr. 3: Armenohori (Bakarno Gumno): Sipas Garašanin 1983c, 725, tab. CIX, 2.

nr. 4-5: Kastanas: Sipas Asllanis 1985, pl. 5, 15.

nr. 6: Maqedonia Perëndimore (lumi Cerna): Sipas Wace-Thompson 1912, tab. XV, nr.335.

tipike për Thesalikun e Hershëm II-III [144], element ky i njohur në këtë kohë dhe në kupat analoge të Maqedonisë Qëndrore[145] dhe asaj Perëndimore[146].

9. Kupa me buzë të kthyera në formë të germës "T" të tipit Thesalik i Hershëm II-III *(tab. IV, 1-4)*, që përveç Maliqit IIIa, i gjejmë në Kastanas (shtresa 27)[147] dhe në vendbanime të tjera të Bronzit të Hershëm të Maqedonisë Egjeane, si në Axiochori[148], Hagios Mamas[149] etj, si dhe në Varvara A_3 të Hercegovinës[150]. Përhapja e këtij tipi ene me origjinë jugore në krahinat veriballkanike, është fenomen i rëndësishëm, pasi ndihmon të kuptojmë edhe drejtimin e lëvizjes juglindje-veriperëndim të bartësve të kësaj qeramike gjatë Bronzit të Hershëm.


Faza Maliq IIIa përfaqëson një fazë të vonë e Bronzit të Hershëm thesalo-maqedonas të tipit Protohelladiku II/III (½ II e mijëvjeçarit III para Kr.). Ai ka vënë në dukje se qeramika e Bronzit të Hershëm Maliq IIIa e dekoruar me shirita plastik të gropëzuar, është qeramikë e ardhur bashkë me bartësit e saj, edhe pse nuk është përcaktuar mirë kahu dhe mekanizmi i depërtimit të saj në Shqipëri[151]. Ky lloj dekori, krejt i huaj për kulturën e tipit kurgan, është shumë karakteristikë për Bronzin e Hershëm në Shqipëri, Kosovë, Pelagoni, Thesali, Greqi, Anatoli (Trojë I-II, (Yaziboy-Paphlagoni) etj, konsiderohet të jetë me origjinë Cikladike[152]. Analogjitë e mësipërme, na shtyjnë të besojmë se kjo qeramikë ka ardhur në Bronzin e Hershëm në Shqipëri bashkë me bartësit e saj, si nga kulturat ballkano-danubiane të grupit Baden-Kostolac, Bubanj Hum dhe Pelagonisë (Armenohori), ashtu edhe nga Thesalia, Maqedonia Egjeane dhe Anatolia. Si përfundim mendojmë se jemi më afër të vërtetës kur pohojmë se kultura e Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, përveç komponentit eneolitik autokton dhe atij badeno-kostolac, përmban edhe një komponent tjetër po aq të fortë e të konsoliduar. Është fjala për komponentin thesalo-maqedonas dhe anatolik, rruga e depërtimit të të cilit, mund të ndiqet përmes analogjive kulturore midis Maliqit III a-b apo Hisarit IIIa-Vlashnje IVa me kulturën e Bronzit të Hershëm të Pelagonisë (grupi Armenohori), Maqedonisë Egjeane (Servia VIII-X, Kastanas, Kritsana, Dikili Tash, Rrafshina e Dramës), Thesalisë (Argissa Magula III), Thrakisë (Salhane, Kanligeç pranë Kirklarelit, Haskoy Hoyugu (Edirne), Bullgarisë (Ezero A-B) dhe Anatolisë (Trojë I-II, Paphlagonia). Elementët e shkëputur dhe të rrallë të komponentit "kurgan", duket se janë thjeshtë dhe vetëm influenca kulturore, pa ndikime të dukshme në strukturën social-ekonomike dhe shpirtërore të popullsisë. Në mbështetje të këtij përfundimi do të vinte edhe konstatimi mbi depopullimin e Thrakisë Lindore[153] gjatë Eneolitit të vonë, i shkaktuar nga presioni i turmave që vinin nga Anatolia, i plotësuar edhe nga fakti se "Thrakia Lindore ka shërbyer si një urë kalimi midis Anatolisë dhe Europës Juglindore"[154]. Ky përfundim është përforcuar kohët e fundit me argumente të reja. Kështu M. Özdoğan ka konstatuar praninë e një hiatusi kulturor në Thrakinë Lindore, që përkon me periudhën nga mbarimi i kulturës Aşağı Pinar deri në fillimet e Bronzit të Hershëm [155], hiatus i mbushur nga grupe mobile të ardhura nga pjesa Anatoliane e Detit Marmara[156]. Përhapja në Ballkan e tipit anatolian të vendbanimeve, shihet më qartë se kudo në vendbanimin e fazës së dytë të Bronzit të Hershëm II në Kamligeç (afër Aşağı Pinarit), i kolonizuar direkt nga Anatolia Qëndrore Perëndimore, ose i sunduar prej tyre, pasi imiton stilin e jetës së Anatolisë[157]. Sipas M. Özdoğan prania e vendbanimeve të tipit anatolian në hinterlantin e Thrakisë është e rëndësishme, pasi shënon ose kolonizim direkt nga Anatolia ose sundimin e saj nga një grup elitar që imitonin stilin e jetës anatolase[158]. Ndërkaq, mungon çdo analogji e enëve të Bronzit të Hershëm të Shqipërisë me enët e kulturës kurgane të tipit "pitgrave". Pothuaj të gjitha enët e zbuluara në varret e tipit pitgrave të Yamna kulturës në rajonin e Dnjepropetrovskit në Ukrainë (tipi Orel'-Samara) kanë formë dhe bazë të rrumbullakët, pa vegjë dhe funde të sheshtë rrethor. Disa prej tyre janë të zbukuruara me inçizime dhe me impresime me motiv krëhëri ose zigzakesh zbritëse me motivin e "gjarpërit" [159].(Fig.6).

Nga evidenca arkeologjike në Shqipëri dhe Kosovë, ka disa të dhëna të vlefshme në mbështetje të pikëpamjes sonë mbi karakterin iluziv të dyndjes kurgane nga njera anë dhe mbi vazhdimësinë e traditave eneolitike dhe rrjedhimisht edhe të popullsisë lokale nga ana tjetër. Nga shtresa e Eneolitit të vonë në Shqipëri, kemi vetëm dy thika të gjata stralli (me gjatësi 12-15 cm), të zbuluara në Maliq IIb[160] dhe Kamnik IIb[161], ndërsa nga shtresa Tren IIIa e Bronzit të Hershëm, vetëm një fragment ene të zbukuruar me shtypje gjalmi në breza paralelë (*schnurkeramik*)[162], që u janë atribuar ndikimeve të ardhura nga stepa, por kurrësesi ekspansionit të bartësve të tyre[163].

Edhe në shtresën e Bronzit të Hershëm të qytezës së Gajtanit (Shkodër)[164] janë gjetur disa fragmente enësh të zbukuruar me mbresa gjalmi të rremë (*Falschnurmotiv*)[165], që alternohen me rreshta gropëzash të thelluara, shumë të ngjashme për nga koncepti kompozicional me atë të vendbanimit Otisič-Vlake dhe vendbanimeve të tjera adriatike të kulturës Ljubljana[166], ndërsa në qytezën e Ganjollës është gjetur vetëm një fragment ene e zbukuruar me dekorin *pseudo-schnur*[167], dekor i njohur edhe në disa vendbanime

(Vijon në faqen 20)

vendlindja





Dushaj – katundi i kullave, *bujarisë dhe natyrës piktoreske*

Nga **ADRIATIK BALLA**

Do të shkruajmë sot dy fjalë për një fshat shumë të veçantë në trevën e Dibrës, Dushaj-Bulqizë, një katund i vjetër me shumë histori, bujari, natyrë piktoreske spektakolare, vend kullash e ujëvarash.

Dushaj është fshat në sektorin e sipërm të luginës së Bulqizës, pozicionuar në skajin më VL të këtij sektori. Ky është katundi më i vjetër i krejt pjesës së sipërme të luginës së Bulqizës dhe një prej katundeve më të vjetra të krejt Dibrës, pasi daton (edhe pse jo me dokument) nga antikiteti i vonë. Në lindje kufizohet me kreshtën e malit të Temlës, në veri me kreshtën e Arithit, në perëndim kufizohet nëpërmjet një përroske me fshatin Koçaj, e në jug e jugperëndim me Fushë-Bulqizën.

Brenda këtyre kufinjve, Dushaj kanë një sipërfaqe 20.5 km katrorë, nga të cilat 7.5 km katrorë janë fushorë, luginorë e kodrinorë, pjesa tjetër mal mbi 1000 m lartësi. Territori i këtij fshati nis nga 640 m në jug tek Gurreperkolja e deri në 1988 m në majen e Arithit ne veri. Vetë katundi si vendbanim shtrihet nga 660 m e deri në afro 1000 m, me zgjatje J-V gati 2 km. Shtrihet në të dy krahët e përroit të Dushajve, si dhe në shkallën strukturore që krijon Kodër Danin.

Banorët që e themeluan kete katund i përkisnin qytetit të Valikardhës e vetë qyteti i Valikardhës pranë urës së qytetit, referuar studimit më të fundit të Ramazan Kicës i takon të jetë Albanopolisi antik. Ky qytet u shkatërrua nga dyndjet barbare e sllave dhe banorët që mbijetuan u larguan. Një pjesë u ngjit në male dhe një nga familjet themeloi pikërisht këtë fshat, e gojëdhëna thotë se ai ishte Stefan Dusho. Dokumentet historike që po zbulohen hap pas hapi mbështesin këtë variant, e këtë e ka analizuar më mirë studiuesi Ymer Keta, në "Bulqiza dhe Bulqizakët", 2008.

Dushaj ishte fshat në zotërim të Gropajve, fisnikë arbërorë që u larguan në Itali pas pushtimit turk dhe që shprehet mjaft mirë në dokumetet e kohës dhe po ashtu tek "Kënga e Sprasme e Balës", nga rrëfimet e plakut Bal ose Ballë, që ishte veteran i ushtrisë skënderbejane.

Deri në vitin 1650 popullsia e tij ishte e gjitha e krishterë, pas këtij viti nis islamizimi që mbyllet përfundimisht më 1800, kurse bektashizmi merr formë thuajse të plotë në vitin 1900 e më pas.

Ende dhe sot, ruhen në lagjen Gropë rrënojat e një kishe të vjetër, e ndërtuar rreth shekullit VIII (shih Y.Keta, 2008), që mendohet se ishte objekti fetar kishtar përbashkues për të gjitha lagjet e fshatit.

Katundi Dushaj ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në të gjitha luftërat për liri të Dibrës së Epërme, sidomos gjatë luftës së Drinit më 1844, kryengritjeve të vazhdueshme dhe lëvizjeve kaçake me Sul Hupin në fund shekullin XIX, luftës 9 vjeçare (1912-1921) me serbët, e deri në luftën nacionalclirimtare në L2B. Në luftën kundër serbëve, nga ky fshat regjistrohet dëshmori i parë në të gjithë Bulqizën, Hasan Alla, rënë në janar 1913. Ky fshat, ngriti flamurin e pavarësisë kombëtare në Dardhë të Bokes një ditë para shpalljes së pavarësisë në Vlorë, me protagonistë Shaban Duriçi e Laze Balla.

Deri në vitin 1945, Dushaj ishte fshat që identifikohej me Bulqizën e Vjetër, si pjesë e nënprefekturës së Zerqanit.

Pas luftës Dushaj hap pas hapi ingranohet në pushtetin e kohës në Bulqizë, por si pjesë e rrethit të Dibrës. Pas vitit 1990 ai bëhet pjesë e Komunës Fushë-Bulqizë të Bashkisë Bulqizë, pjesë e të cilës është dhe sot.

Në vjetarin statistikor të Teki Selenicës (1923, 1927), Dushaj është i bashkuar me fshatrat e tjerë të Bulqizës në kuadër të nënprefekturës së Zerqanit, me afro 2500 banorë. Regjistrim më të saktë na jep ai i austriakëve në vitin 1916, botuar dy vjet më vonë, në Vjenë. Sipas këtij regjistrimi, lagjet Lepurakë, Gropë, Dushe e Qire (ne origjinal shkruajtur Ciraj), përbënin fshatin Lepuraku me 115 shtëpi. Regjistrohen 128 familje që kanë në total 679 banorë. Një nga arsyet që fshati quhet Lepuraku është se lagjja Lepurakë në atë periudhë ishte më e zhvilluar, më e përqendruar, më e organizuar, e natyrisht ishte ende e fortë influenca e Sul Hupit dhe e fisit të tij, pa harruar faktin se Lepurakët kishin xhami dhe një teqe në qendër të tyre.

Ky katund, ka pasuri shumë të mëdha natyrore si kullota të cilësisë së lartë (ka patur para 1990 nje baxho), burime uji të shumta, pyje, toka pjellore, pemetari etj, pa harruar faktin se është mjaft i mbrojtur nga pikëpamja natyrore, gjë që ka shërbyer edhe si mundësi për shtimin e vazhdueshëm të popullatës. Një gjë duhet të kemi të qartë: shumica e lagjeve në të gjithë luginën e Bulqizës nga Ura e Qytetit në lindje e deri në qafë të Buallit në perëndim e kanë origjinën në këtë katund, gjë që dëshmohet nga mbiemrat e vjetër të fiseve. Është pikërisht ky tregues që shpjegon homogjenitetin e Bulqizës në pikëpamje të popullsisë e të vendbanimeve, pra Bulqiza, sado që përmendim Vajkal, Dragua, Koçaj, Dushaj e Fushë-Bulqizë (emrat e fshatrave të sotëm), janë e njëjta gjë, pra Bulqiza e Vjetër. Mes tyre s'ka kufinj, s'ka dallime.

Dushaj është një fshat me disa lagje, ku spikasin Dushet sipër, Dushet poshtë (Methasanet), Lepuraka, Gropa, Qire e Kome. Por kjo ndarje administrative e sotme, sic e theksuam me lart, nuk ka qenë e njëjtë me atë të para vitit 1920.

Dushaj është një fshat i copëtuar në aspektin e relievit, e kjo i krijon atij pamje befasuese në aspektin gjeomorfologjik, ku gërshetohen fusha, mali, brigjet, kreshtat, livadhet, kodrinat, faqet e zhveshura, kullotat apo dhe pyjet e pasura. Artieria kryesore lumore është përroi i Dushajve, me ujë të përhershëm, afro 7 km i gjatë, me prurje mesatare vjetore në grykëderdhjen e tij në Zallin e Bulqizës me afro 0.3 m3/s.

Dushajt shquhen në të gjithë Dibrën për potencialin e madh të kullotave në Mal të Bardhë (Arith), për larmishmërinë e bimësisë, numrin e madh dhe llojshmërinë e bimëve medicinale, pyjet e shkozës e të dushkut mjaft të dendur, ahishtet në sipërfaqe të konsiderueshme por mjaft të dëmtuar, klimën e mrekullueshme, tokat e pakta por pjellore, kapacitetin e madh të frutikulturës, shquar për arra, kumbulla, thana, lajthi, mollë e ftonj.

Ndër objektet natyrore e kulturore me







kulturë

Brenda këtyre kufinjve, Dushaj kanë një sipërfaqe 20.5 km katrorë, nga të cilat 7.5 km katrorë janë fushorë, luginorë e kodrinorë, pjesa tjetër mal mbi 1000 m lartësi. Territori i këtij fshati nis nga 640 m në jug tek Gurreperkolja e deri në 1988 m në majen e Arithit ne veri. Vetë katundi si vendbanim shtrihet nga 660 m e deri në afro 1000 m, me zgjatje J-V gati 2 km. Shtrihet në të dy krahët e përroit të Dushajve, si dhe në shkallën strukturore që krijon Kodër Danin.

vlerë përmendim:

Teqeja e Madhe në Kome një nga 7 teqetë më të njohura të Dibrës, druri (qarri) i Male Danit në kodër-Dani, Rrasa e Hoxhës në shpatin perëndimor të Temlës, Kulla e Skënderbeut, një objekt që ndahet me fshatrat Fushë-Bulqizë, Peladhi e Valikardhë, gropat karstike në Hurdhë të Madhe, kreshta e mprehtë spektakolare e Temlës, Guri i Vashës, livadhet alpine dhe lugjet karstike në Mal të Bardhë, Gurrë Meshkja dhe Gurra e Met Ketës me prurje 4.2 l/s dhe 15 l/s respektivisht, Kulla e Sul Hupit, monument kulture i klasifikuar i tillë gjysmëshekulli më parë dhe i futur si pullë postare më 1982 për vlerat arkitektonike të saj, kulla Hupi e sotme e kthyer në bujtinë nga Lulzim Hupi, ujëvara e Dushajve etj.

Në vitin 1992 ky katund kishte afro 1300 banorë. Në vitin 2002 kishte 390 familje. Në kuadër të komunës Fushë-Bulqizë, në vitin 2008 Dushaj kishin 306 familje me 1106 banorë, e sot më pak se 1 mijë banorë, pra gati gjysma e popullsisë është larguar në këta 30 vjet.

Nga ky fshat kanë dalë arsimtarë, burra që kanë ndarë e udhëhequr kuvende, individë sqimatarë në veshje e kulturë, rapsodë popullorë, këngëtarë e valltarë të njohur, mjeshtra të përpunimit të gurit e të ndërtimit të veglave muzikore, fermerë pasionantë dhe sipërmarrës në turizëm.

Ky fshat është vendlindja e një sërë klerikësh të devotshëm të Teqes së Madhe, filluar me Baba Rrahmanin, Sheh Aliun, Zheh Zyberin e vjetër etj.

Nga ky fshat kanë dalë po ashtu agronomë të zotë, gazetarë, studiues të historisë, poetë, ushtarakë të spikatur dhe mjaft personalitete të shërbimit inteligjent shqiptar e të strukturave të sigurisë së shtetit në përgjithësi. Ka gjithashtu juristë, klerikë, inxhinierë etj.

Dushaj, si shumë fshatra të tjera të Bulqizës, ka qenë baza e punëtorisë së minierës së kromit në Bulqizë dhe nga ky fshat kanë lënë jetën në minierë mbi 10 vetë.

Që para luftës së dytë botërore, ky fshat ka pasur tre mulli uji, dy valanica e disa objekte të rëndësishme punësimi, përfshi shfrytëzimin e pyjeve, çka dëshmon se ishte fshat i madh e me pasuri të konsiderueshme.

Problemi më i madh i këtij fshati ka qenë infrastruktura rrugore për shkak të vështirësisë së terrenit, por vitet e fundit ka pasur disa investime domethënëse në këtë drejtim dhe hapa përpara janë bërë.

E ardhmja e këtij katundi do të jetë e bardhë, pasi ka larmishmëri natyrore si ofertë që lidhen me zhvillimin e blegtorisë, bujqësisë me orientim në agroturizëm etj, e pse jo në punimet artizanale.

Një tjetër veçanti e këtij fshati është se në vitet e demokracisë ka qenë pararojë e krejt fshatrave të Dibrës se si mbrohet mjedisi, gjë që ka detyruar edhe qeverinë të ulet me banorët në Kodër Dani për diskutim.

Botohet libri **“Një jetë maleve, kujtime 5”** me autor **Bashkim Lleshi**

“Një jetë Maleve - Kujtime 5”, me autor prof. Bashkim Lleshi, doli nga shtypi në shkurt të këtij viti nën logon e botimeve M&B.

Ky vëllim vjen pas katër vëllimeve të mëparshme me të njëjtin titull, ku përfshihen kujtime dhe ditare nga fëmijëria dhe shkolla (Kujtime 1), puna në Bulqizë dhe e Peshkopi (Kujtime 2) në Institutin e Gjeologjisë dhe Minierave (1978-1984) (Kujtime 3), në Ndërmarrjen Gjeologjike dhe drejtorinë e Albkromit (1984-2008) (Kujtime 4).

Në këtë vëllim përshkruhen kujtimet e autorit gjatë viteve në pension, nga 1 shtatori i vitit 2008 deri më 31 dhjetor 2015, jetë e cila ka vazhduar të jetë në lëvizje, aktive dhe e gjallë, jo vetëm në drejtim të vazhdimit të punës produktive profesionale, por edhe në drejtim të aktivizimit në detyrat shoqërore sidomos me Shoqatën Lidhja e Intelektualëve Dibranë (LID).

Gjatë periudhës së pensionit shtator 2008-dhjetor 2015 prof. dr.Bashkim Lleshi ka vazhduar punën në “Degalbanev” Studio Tiranë për kryerjen e Studimeve Gjeologjike për marrje leje të kërkim zbulimit të mineraleve të dobishme; Studime gjeologo-inxhinierike për sheshe ndërtimi të objekteve të ndryshme; Studime e relacione hidrogjeologjike për puse uji; Relacione Gjeologjike për minerale të ndryshme metalorë e jo metalorë; Vrojtime në zona e objekte të ndryshme: Për mineralin e kromit të Majës së Shinit dhe Fush Lopës (shtator, tetor 2008), Ranorët e Krahësit Tepelenë (shtator 2008); Gjipset e zonës Guri i Bardhë-Shkallnuer (maj 2010), etj., konsulenca e takime për probleme të mineraleve të dobishme, etj. Jam aktivizuar me kontrata pune vjetore me kompaninë turke “KURUM” për nevojat e saj për mineralet e dobishme metalore e jo metalore nga viti 2004 deri në vitin 2014, duke përgatitur studime e relacione: për Mineralin e Titano- magnetiteve të Kashnjetit, Hekur-Nikelin e Nikelin silikat të Lurës e Librazhd Pogradecit, Hekurin pa nikel në zonën e Korabit, Gjipset dhe Anhidritet e Shqipërisë, Rërat bituminoze të Patosit dhe Selenicës, Gjeologjia dhe perspektiva mineral mbajtëse e Kosovës, etj. Gjatë kësaj periudhe, prof. dr. inxh. Bashkim Lleshi ka shkruar e botuar librat profesionalë: “Gjeologjia e Rrugës së Arbërit” (2008) dhe “Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë (jo metalorë) të Shqipërisë” (2010).

Në faqet e këtij libri rëndësi i kushtohet ndjekjes me përparësi të punës për ndërtimin e Rrugës së Arbërit (RA). Duke parë ndryshimet që po pësonte studimi i fizibilitetit të kësaj rruge në projektet e zbatimit, ka shkruar artikuj lidhur me problemet e hasura gjatë ecurisë së ndërtimit të Rrugës së Arbërit, në gazetën “Rruga e Arbërit”, ka marrë pjesë në ekskursion me TV Dibra përgjatë aksit të rrugës (nëntor 2012), ka drejtuar ekskursionin e LID në bashkëpunim me shoqatën Nisma Dibrane, nga Ura e Vashës në Qaf Murrizë- Zall Dajt-Brar, sipas aksit të saj (gusht 2013).

Një vend të rëndësishëm zë aktivizimi i tij në kryesinë e shoqatës LID, marrja pjesë pothuajse në të gjitha aktivitetet e kësaj shoqate dhe përshkrimi i këtyre aktiviteteve, si: Në 100 vjetorin e Kongresit të Dibrës (korrik 2009), festën e mësuesit (mars 2010), aktivitetin kushtuar mësuesit e poetit të shquar dibran Naim Plaku (dhjetor 2010), ndarjen e tij nga jeta dhe përkujtimin e 1 vjetorit (korrik 2014, korrik 2015), ndarjen nga jeta të sekretarit të LID Hasan Leka (mars 2012), aktivitet për ditëlindjen e kryetarit të LID, Mësuesit të Popullit prof. Nuri Abdiu (mars 2013), ndarjen e tij nga jeta (prill 2014), në Panairin e librit dhe 20 vjetorin e “Odës Dibrane” në Peshkopi e Dibër (tetor 2014), në aktivitetet për marrjen e titullit “Qytetar Nderi i Peshkopisë” të: Nuri Abdiu (maj 2015) e Nazmi Koçi (korrik 2015).

Përshkruhen gjithashtu marrja pjesë në aktivitete shoqërore e patriotike si: Inaugurimin e bustit të Skënderbeut në Peshkopi (qershor 2009), dhurimin e Bibliotekës së shkencëtarit dibran Azmi Dibra në Dibër të Madhe (nëntor 2010), në përkujtimin e 65 dhe 70 vjetorit të Brigadës së 18-të dhe çlirimit të Peshkopisë (gusht 2009, 2013), aktivitetin për 100 vjetori i lindjes së Heroit të Popullit Haxhi Lleshi (maj 2013), Inaugurimin e Përmendores kushtuar Betejës së Torviollit në Fushë Çidhën (nëntor 2014), ndarja nga jeta e veteranit të LANÇ, Kalosh Daci (mars 2015) dhe 90 vjetori i hapjes së shkollës shqipe në fshatin Zogje të Dibrës (nëntor 2015).

Marrja pjesë në aktivitete shoqërore, promovime librash, dekorime, takime, ndarje nga jeta e përkujtimore për shokët e shkollës e të punës, etj. si: Aktivitet për Marie Shllaku, Promovimi i librit “Toponimet e Çidhnës” me autorë Haki Përnezha e Ruzhdi Bitri; Takime përkujtimore për inxh. Todo Manço, inxh. Koço Gushi dhe prof.dr. Agim Dobi; Takim për 90 vjetorin e SHGJSH dhe me gjeologët e Bulqizës e Burrelit, darka për mbylljen e vitit 2016 në SHGJSH; Përkujtimore për ndarjen nga jeta në periudhën 2008-2015 të kolegëve dhe bashkëpunëtorëve të vjetër të shkollës e të punës: Adli Baholli, Agim Dobi, Agim Tërshana, Bajram Bruçi, Bujar Pata, Burhan Çiraku, Dashamir Bisha, Elez Xheka, Hasan Hajdari, Minella Shallo, Pali Miska, Polikron Theodhori e Virgjil



Budo.

Gjatë kësaj periudhe Bashkim Lleshi ka botuar librat: “Djemtë e Llesheve të Gjurit” (qershor 2008), “Dezdemona” (2011), “Fisi Lleshi i Zogjeve të Dibrës” (2012), “Haxhi Lleshi në 100 vjetorin e lindjes” (2014). Gjithashtu, ka botuar në gazetën “Rruga e Arbërit” artikuj për origjinën e fisit Gropaj, prejardhjen e fshatit Zogje dhe për Macukullin, fshatin e historisë së vjetër dhe investimeve të reja, si dhe ka vazhduar të hedhë në kompjuter nga ditarët e tij.

Ka vazhduar gjithashtu të grumbulloj materiale për fiset Daci, Markja, Leka, Kaja e Suti, etj. të fshatit Zogje, që ashtu si për fisin Lleshi të botoj librat e fiseve të tjerë të këtij fshati, si dhe ka vazhduar të mbaj ditar të rregullt për të shkruar kujtimet familjare, marrja pjesë në ceremonitë e gëzimit, në fejesa e dasma të familjarëve e të afërmve, marrja pjesë në ceremonitë e hidhërimit, pushimet dhe ekskursionet familjare, etj. të cilat ka menduar që t’i shkruaj më vete për përdorim nga familjarët, të afërmit dhe miqtë e familjes së tij.

BUJAR KAROSHI



Rruga e Arbërit nr. 198

I riu dibran në NATO, Erblin Iskurti rrëfen sakrificat e shkollimit, ka një mesazh për rininë, flet kujt ia dedikon arritjet dhe si e sheh Shqipërinë...

intervistë

Erblin Iskurti: Kjo klasë politike ka shkatërruar shpresën për të nesërmen më të mirë

Nga **MINA HYSA**

Me pasuritë e panumërta nëntokësore e mbi tokësore që Zoti na ka falë, një klasë politike të ndërgjegjshme dhe atdhedashëse do i duheshin vetëm pak vite që ta kthente Shqipërinë në një ndër vendet më të mira për të jetuar. Është e dhimbshme të shohësh që për të tretin vit radhazi rritja natyrale e popullsisë është negative. Më shumë se vjedhjet e pasurive të panumërta gjatë këtyre 30 viteve, ajo që është e pafalshme për klasën politike është shkatërrimi i shpresës për të nesërmen më të mirë.



Në foto: Erblin Iskurti me familjen

Historitë e suksesit të qytetarëve shqiptarë janë lidhur me aftësitë e tyre, duke u përmbushur dukshëm në arsimim dhe punësim, si dhe duke spikatur në fusha të caktuara, në Shqipëri apo diasporë. Shqiptarët e punësuar në institucione të rëndësishme shtetërore në vendet ku punojnë dhe jetojnë në Perëndim, nuk janë më tabu. Intervista e mëposhtme është për me punonjës, qytetar i Shqipërisë, që ndodhet në aparatin e NATO-s .Rrugëtimi i tij për të qenë sot pjesë e kësaj organizate shumë të rëndësishme, është një sakrificë më vete, por ai i ka hedhur hapat një nga një, i sigurt, për të qenë sot një histori suksesi e merituat. Ai quhet Erblin Iskurti.

Rrugëtimin e tij e ka nisur nga vendlindja, Dibra, ndoshta nga aty me rrënjë të forta duke përfunduar arsimin e mesëm në vitin 2006 dhe duke marrë rrugën drejt kryeqytetit për të studiuar për Shkenca Politike në Universitetin e Tiranës, deri në vitin 2009. Më pas, në harkun kohor të një viti, do siguronte vizën dhe do të zhvendosej në Bruksel. Në vitin 2011 do të niste Masterin në Belgjikë dhe 5 vite me vonë do t'i krijohej mundësia të punonte në NATO, organizatën më të madhe për Paqen dhe Sigurinë në Botë.

Erblin Iskurti, pas përfundimit të studimeve, mbrojti tezën me analizimin e procesit të integrimit të Shqipërisë në NATO dhe përfitimet e dyanshme të këtij procesi. Fillimisht do ti hapeshin dyert në këtë organizatë si konsulent i jashtëm dhe tani pjesë e organikës së saj.

Kur dhe ku e ke mbaruar arsimin e mesëm? Çfarë kujtimesh mbartni nga Peshkopia?

Shkollën e mesme e kam mbaruar në vendlindje, në qytetin e Peshkopisë. Ka qenë një gjimnaz me shumë nivel dhe kjo dëshmohet fare lehtë nga arritjet në studime e me vonë në karrierë si brenda edhe jashtë Shqipërisë të shumicës së maturantëve të atij brezi. Në vitin e katërt kam qenë edhe senator i klasës dhe president i shkollës, i zgjedhur pothuajse në mënyre unanime nga senatoret e të gjitha viteve. Mendoj se kemi qenë të privilegjuar që patëm mundësi të kryenim shkollën e mesme në një qytet të vogël si Peshkopia, ku shoqëria kalonte shpesh edhe brez pas brezi nga prindërit te fëmijët, sepse na dha një bazë të shëndoshë dhe shumë të fortë për të ecur përpara. Edhe pas kaq vitesh kemi ruajtur kontaktet dhe mundohemi të organizohemi sa herë të jetë e mundur me shumë nga shokët e shoqet, pavarësisht rrugëve që kemi marrë apo vendeve ku jetojmë.

Studimet e larta i mbarove në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Shkencave Sociale, dega Shkenca Politike. Çfarë kujtoni nga koha e studimeve?

Pasi mora bazën e shëndoshë në vendlindje, studimet e larta i kreva në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Shkencave Sociale, Dega Shkenca Politike. Tani që kthej kokën pas, kuptoj që kam qenë me fat edhe në këtë aspekt. Në gjykimin tim, Fakulteti i Shkencave Sociale mund të ishte ndër më pak të korruptuarit dhe gjithkujt i jepej ajo që meritonte. Mendoj se ky është një problem jashtëzakonisht i madh në shoqërinë tonë, pasi ashtu siç thithim dijen, mbase dhe më lehtë brumosemi edhe me korrupsionin, kur këtë e ndeshim në vendet dhe nga personat që supozohet të na mësojnë se si ta luftojmë atë. Pikërisht kjo gjë ndikoi edhe në rrugëtimin tim të mëvonshëm dhe zgjedhjen që bëra për të përfunduar ciklin tjetër të studimeve jashtë Shqipërisë. Gjatë periudhës së studimeve tentova të angazhohem në politikë me forumet rinore, duke kërkuar të ndërtoj vetë diçka, në vend që të tentoja të futesha në pozicione më komode nëpërmjet njohjeve apo ndereve. Përveç kësaj, arrita të zgjidhem si përfaqësues i Shkencave Politike në senatin e Fakultetit dhe u zgjodha në postin e zv.Presidentit të Fakultetit të Shkencave Sociale, ku përveç Shkencave Politike, kishte përfaqësues të Psikologjisë, Sociologjisë dhe Punëve Sociale.

Më pas u zhvendoset në Bruksel duke kryer Masterin. Përse një vendim i tillë?

Mendoj se kanë qenë dy arsye primare që më bënë të marr vendimin të vazhdoj studimet e mia jashtë Shqipërisë. Së pari e pashë që ishte pothuajse e pamundur që të ecje vetëm në bazë të meritokracisë dhe të ngjiteshe lart e të bëje karrierë. Duke qenë se jam rritur nga dy prindër për të cilët meritokracia ishte e shenjtë dhe kanë sakrifikuar gjithçka, përfshirë karrierën e tyre, vetëm e vetëm të mos shkelnin parimet dhe vlerat që ato besonin, është e kuptueshme që punësimi dhe karriera partiake pa meritokraci nuk ishin një opsion për mua. Së dyti, e pranoj që ishte absolutisht tërheqëse ideja që të përfundoja studimet në marrëdhënie ndërkombëtare në një ndër universitetet më të mira europiane dhe, për më tepër, në kryeqytetin e Europës, ku gjenden edhe selitë qendrore të NATO-s dhe Bashkimit Europian. Sigurisht që rrugëtimi nuk ka qenë shumë i lehtë, por edhe arritjet të shijojnë më shumë pas vështirësive. Gjatë studimeve isha pjesëmarrës që në mbledhjen e dytë të krijimit të organizatës studentore shqiptare në Belgjikë, Vlera. Kjo organizatë studentore mbledh pranë vetes me qindra studentë shqiptarë nga Universitetet e Brukselit (ULB, VUB etj.), ashtu edhe nga rrethet e tjera si Universiteti Leuvenit, Gentit, Anversit, Liegit, Monsit etj. Që nga krijimi e në vazhdim kjo organizatë studentore ka mbajtur kontakte dhe ka kontribuar në çdo aktivitet të organizuar nga Ambasadat e Republikës së Shqipërisë e të Republikës së Kosovës në Belgjikë.

Sot jeni i punësuar në NATO. A mund të na rrëfeni fillimet tuaja aty dhe çfarë funksioni keni aktualisht?

Në mbyllje të studimeve të mia, mbrojta tezën me analizimin e procesit të integrimit të Shqipërisë në NATO dhe përfitimet e dyanshme të këtij procesi. Në momentin që vendosa të vazhdoja studimet në Belgjikë në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Siguria, Paqja dhe Konflikti Ndërkombëtar – e kisha një dëshirë të fshehur të arrija të punoja në organizatën më të fuqishme ndërkombëtare dhe simbolin e mbrojtjes së demokracive perëndimore që nga krijimi i saj, NATO-n. Mundësia u shfaq në 2016, kur mu ofrua të filloja si konsulent i jashtëm në një ndër drejtoritë më të mëdha të Agjencisë së Komunikimit dhe Informacionit, në bazën kryesore ushtarake të NATO-s në SHAPE. Për rreth 2-3 vite punova në mbështetje të drejtpërdrejtë të drejtorit, duke u marrë më së shumti me çështje të menaxhimit të një stafi prej mbi 300 personash. Pas kësaj përvoje, m'u dha mundësia që të kaloja në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel, në ekipin ekzekutiv të menaxhimit të agjencisë dhe të punoj drejtpërsëdrejti për shefin e stafit dhe kreun e agjencisë së mbi 3000 të punësuarve, ushtarakë dhe civile. Aktualisht, jam koordinator i ekipit të oficerëve të ndërlidhjes së agjencisë me gjithë organizmat e tjerë të NATO-s si dhe jam pjesë e skuadrës së këshilltarëve strategjikë për kreun e agjencisë dhe shefin e stafit.

Cili është mesazhi që keni për të rinjtë veçanërisht në Shqipëri?

Të rinjve ju them që të mos pranojnë askënd të ju shkatërrojë të ardhmen dhe të mos bëjnë kurrsesi kompromis me të keqen. Të ëndërrojnë natën dhe ditën të punojnë që të realizojnë ëndrrat e tyre. Nuk duhet të ndalen para vështirësive të shumta që mund të kalojnë rrugës, të bëjnë kompromise të përkohshme, por sigurisht pa shkelur në parimet e tyre, dhe të jenë të fokusuar tek objektivi final. Nuk ka kënaqësi më të madhe kur pas një lodhje e sprovash të ndryshme, arrin atje ku ke synuar.

Kujt ja dedikon arritjen tënde?

Rolin parësor në gjithçka kam arritur dhe do të arrij në të ardhmen e ka familja. Nëse ka diçka që mendoj se duhet të jemi pafund mirënjohës është uria e prindërve shqiptarë për arsimimin e fëmijëve të tyre. Sigurisht, ndikuar edhe nga shumë faktorë, mes të cilëve pamundësia e shkollimit nën regjimin e kaluar, shtysa, mbështetja dhe sakrifica e tyre për shkollimin tonë nuk ka të krahasuar.

Në një farë mënyre unë isha i dënuar të dilja mirë në mësime pasi një pjesë e mirë e mësuesve të mi ishin formuar nga gjyshi im, profesori i matematikës e fizikës, i ndjeri Shefik Iskurti. Kështu që kisha një detyrim moral të isha "nipi i denjë" i profesor Shefikut.

Si e shikoni politikën dhe të ardhmen e Shqipërisë?A e keni opsionin kthimin në Shqipëri?

Për fat të keq politika në Shqipëri ka ardhur duke u degraduar dhe jo në përmirësim. Edhe pas më shumë se 30 vitesh pluralizëm politik, akoma nuk kemi demokraci të konsoliduar. Kemi një demokraci hibride që herë-herë është me afër autokracisë sesa demokracisë. Në gjykimin tim, kemi një klasë politike të papërgjshme, krahasuar edhe me vendet e tjera të rajonit dhe duket sikur nuk e kanë ndjenjën e llogaridhënies. Janë konfliktual dhe aspak të interesuar në interesin publik, por vetëm në atë personal e partiak. Edhe në krahasim me vetveten, po ta shohim statistikisht, kemi një ndër klasat politike me pak të shkolluara të historisë 30-vjeçare post komuniste. Kjo duhet absolutisht të ndryshojë. Me pasuritë e panumërta nëntokësore e mbi tokësore që Zoti na ka falë, një klasë politike të ndërgjegjshme dhe atdhedashëse do i duheshin vetëm pak vite që ta kthente Shqipërinë në një ndër vendet më të mira për të jetuar. Është e dhimbshme të shohësh që për të tretin vit radhazi rritja natyrale e popullsisë është negative. Më shumë se vjedhjet e pasurive të panumërta gjatë këtyre 30 viteve, ajo që është e pafalshme për klasën politike është shkatërrimi i shpresës për të nesërmen më të mirë. Në mendimin tim, pesha kryesore e fajit është e qeverisë, por në humbjen e shpresës në të ardhme sigurisht që një pjesë të vogël faji ka edhe opozita, që nuk është e besueshme se do sjellë atë që i nevojitet një familje për të qenë të sigurt të rrisin fëmijët e tyre në atë vend.

Mendoj që një ndër arsyet kryesore që Partia Demokratike erdhi në pushtet në 2005 ishte hapja e partisë dhe thithja e ideve dhe figurave të reja nga të gjitha fushat. Dhe mendoj që, pikërisht kjo gjë i ka munguar PD-së gjatë viteve të fundit, që kombinuar me keqqeverisjen dhe korrupsionin e Rilindjes, shuan shpresën e qindra mijëra shqiptarëve që kërkuan azil në BE, më shumë edhe se shtetasit nga vendet në konflikt si Afganistani, Iraku etj.

Duke qenë i pasionuar me politikën dhe duke marrë parasysh dashurinë e madhe për vendlindjen, jam gjithmonë me një sy e një vesh atje duke ndjekur të gjitha zhvillimet politike. Në mendje me ka kaluar disa herë mendimi që të kthehem e të kontribuoj në vendin tim, dhe besoj që një ditë do e bëj. Por nuk besoj se është akoma momenti i duhur. Duhet të jem i duruar për mundësinë e duhur, në mënyre që kontributi im dhe përdorimi i eksperiencës së marrë gjatë gjithë këtyre viteve në Belgjike dhe NATO, të ketë një ndikim në Shqipëri. Për fat të keq, nuk e kam parë diçka të tillë deri me sot, por shpresoj që një ditë kjo mundësi do të krijohet.

botime

“Në gjurmë të këngës dibrane”

Nga **MIRDASH SHEHU**

Pas botimit të “Rreth melosit në këngët e vallet dibrane”, botimi i këtij libri me balada, epikë historike e lirika popullore të mbledhura nga Munir Shehu, mendoj se përbën një moment të rëndësishëm për kulturën dhe etnokulturën e Dibrës, por nisur nga ajo se çfarë vetë Dibra përfaqëson në kulturën shqiptare, ky libër është një pasuri me vlerë të veçantë që i shtohet thesarit të kulturës popullore kombëtare.

Ndoshta disi i vonuar në kohë, por besoj se kjo, nuk ndikon në vlerën e tij. Me gjithë lënien pas dore dhe zvetënimin ditë pas dite të interesit shtetëror për këtë fushë, unë shpresoj se një ditë, në një kohë tjetër (sigurisht në ditë “më të mira” për vendin), kur gjërat të marrin vlerën që meritojnë, nga institucionet, do të ketë një rivlerësim të kësaj kulture me vlerë të pamatë kombëtare.

Njihet tashmë që Muniri është një nga mbledhësit më të hershëm e më pasionantë, gjurmues i palodhur në kërkim të historisë, këngëve e valleve, vargjeve e melodive popullore të vendit të tij.

Shumë mbledhës të folklorit të cilët, megjithëse kanë dhënë një kontribut të shquar në këtë fushë, duke mos patur formimin e nevojshëm (mos njohjen e një instrumenti muzikor), kanë sjellë gjithsesi një punë të paplotë: kanë mbledhur vargje, por nuk kanë mbledhur dot melodinë. Shumë syresh, sidomos ato më të hershme, kanë humbur. Mungesa e melodive tek shumë këngë e valle, aq më tepër kur bëhet fjalë për larminë e linjave melodike të folklorit dibran, shumë pak të dokumentuar, mungesa apo varfëria e kësaj pasurie i shtynë edhe më shumë përpjekjet e Munirit, që me shqetësim u përpoq ta mblidhte atë me sa mund e ku të mund. Për të nuk pati kurrë rëndësi nëse ishte sëmurë, nëse ishte kohë me diell apo me shi, ishte larg apo afër, mal apo fushë. Ai do të vraponte drejt burimit sapo të informohej për të.

Njohja e mirë e muzikës, e bën punën e tij më të plotë dhe atë, një etnomuzikolog të formuar si pakkush. Si një bletë e mirë, me durim e përkushtim, lule në lule, ai nuk la as një grimë nektar t’i shkojë dëm duke prodhuar kështu, një mjaltë cilësor, pra, mblodhi edhe vargjet, edhe melodinë.

Në këtë proces grumbullimi e seleksionimi të këtij thesari kulturor, shumë probleme, si p.sh. ato gjuhësore, historike, etj, krijojnë vështirësi të panumërta, të cilat ai i përballoi me sukses në sajë profesionalizmit dhe seriozitetit shkencor.

Ky ishte Muniri.

Pikërisht për këtë arsye, puna e tij veçohet dhe qëndron më lart.

Fillimet e punës së tij në mbledhjen e folklorit, i takojnë viteve 1930-1932, me shkrimet në revistën “Normalisti”, revista e shkollës Normale ku studionte Muniri, kur nuk kishte mbushur ende të njëzetat. Bartësit e vlerave të kulturës popullore me të cilët kontaktoi Muniri që herët, pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, apo dëshmitarë të shumë ngjarjeve të rëndësishme historike të atyre kohërave, apo të tjerë jo pjesëmarrës a dëshmitarë direktë, por shumë pranë tyre për arsye të ndryshme, të njohjeve, farefisnisë, etj., bartës të një trashëgimie të mbledhur tashmë nga Muniri, sigurisht që nuk do të mund të jetonin edhe një kohë tjetër. Me humbjen e tyre, bashkë me ta do të treteshin, do të humbisnin, pasuri me vlera të pa llogaritshme të kulturës dibrane. Të kuptoje dhe të punoje për ta vjelë këtë trashëgimi, për të mos e lënë të humbasë, në atë kohë dhe në atë moshë, padyshim që duhet vlerësuar maksimalisht. Vlera e kësaj pune shumëfishohet kur ndodhesh para faktit se, humbjeve të Dibrës, iu shtua si rezultat i pushtimeve të ndryshme, e sidomos atij serb, përveç jetëve njerëzore e vlerave monetare e pasurore edhe humbja e shkatërrimi i vlerave kulturore e dokumentacionit.

Kështu, Muniri, u bë mbrojtësi dhe ruajtësi i trashëgimisë historike e kulturore, i kujtesës së popullit, i vlerave të cilat po i përpinin dallgët e kohës duke dëshmuar atdhedashuri, ndjeshmëri, vullnet e pasion, lidhjen e ngushtë me vendin e vet dhe ky ndërgjegjësim flet sigurisht për një formim të plotë e të qartë intelektual e patriotik të tij. Prandaj, me të drejtë, mendoj e besoj se duhet kuptuar, duhet njohur e vlerësuar për këto merita.

Megjithëse i shpallur “armik i popullit”, i burgosur që në muajt e parë pas çlirimit, pas daljes nga burgu, në vitin 1952, shumë shpejt, do t’a shohim atë të rendë pas pasionit të tij. Në mungesë kuadrosh, ekspertë dhe specialistë të fushës të Institutit të Folklorit në Tiranë, të cilët dërgoheshin për ekspedita kudo nëpër Shqipëri, në Dibër vinin me kënaqësi sepse e dinin se aty do të gjenin një njeri tek i cili mund të mbështeteshin, specialistin me të cilin mund të diskutonin dhe vlerësonin problemet e fushës profesionalisht. Ky ishte një lehtësim i madh për ta, ashtu siç krijonte vështirësi në mjaft krahina e rrethe të tjerë ku mungonin njerëz si Muniri. Puna në gjurmimin, mbledhjen dhe vlerësimin e thesarit popullor do të tërhiqte vëmendjen e këtij institucioni i cili do ta ftonte dhe do të merrte në konsideratë mendimet e tij në fushën e folklorit, duke u bërë një zë me peshë aty si bashkëpunëtor për shumë kohë e duke dhënë kështu kontributin e tij edhe në rang kombëtar në institucionin më të lartë të kësaj fushe në vend.

Megjithëse puna e tij skrupuloze, shumë e dashur nga populli, nuk linte shteg për të dyshime në vlerën e saj, ajo nuk do të arrinte të hiqte kurrë “dyshimet” mbi “armikun e popullit”, i cili jo vetëm që nuk do të përkrahej, por do të sulmohej e goditej me urrejtje e xhelozi nga edukimi mediokër i mjaft njerëzve partiakë në pushtet, duke i shkaktuar dëme të mëdha, Munirit, familjes dhe vetë vendit.

Për këtë arsye, puna e tij merr ende, edhe një vlerë tjetër të shtuar, pasi ajo është një punë e kryer në mungesë të plotë të lirisë, nën trusni dhe goditje, që gjithashtu, na lejon të njohim modelin e intelektualit, i cili nuk bën kompromis me antivlerën, nuk u nënshtrohet, as me dhunë, veçse bindjeve të tij. E pagoi këtë, bile shtrenjtë. Vazhdon të paguajë edhe sot.

Jo pa qëllim, larg modestisë, i mërzitur nga mosmirënjohja dhe një hipokrizia e neveritshme, në një moment në dukje vlerësimi, me një sarkazëm që atij i shkonte shumë (më lejohet ta them këtë, në bazë të njohjes, si djali i tij), ai u tha: “Unë nuk kërkoj vlerësim tjetër nga ju, vetëm të më vlerësoni shojet e këpucëve që kam grisur duke punuar për mbledhjen e këtij folklori”!

Siç e kam përmendur edhe në parathënien e përkthimit tim të librit të Justin Godart “Shqipëria në vitin 1921”, ai kishte ngritur një bibliotekë mjaft të pasur, shumë libra të të cilës ishin porositur në Paris. Por jo vetëm kaq. Aty gjendeshin vepra në origjinal me vlera të rralla të autorëve më të hershëm shqiptarë, por edhe të huaj që shkruanin për Shqipërinë, p.sh., Barleti origjinal, etj. Kjo bibliotekë do të habiste edhe oficerin gjerman gjatë kontrollit në shtëpinë e tij në Dibër të Madhe. Biblioteka dhe violina, bënë që ky ushtarak gjerman të besonte, i befasuar se shtëpia e Munirit prej të cilës ishte luftuar kundër gjermanëve, nuk ishte një bazë partizane, por shtëpia e një intelektuali i cili vetëm komunist nuk mund të ishte dhe për këtë arsye, në respekt të kësaj kulture, ai nuk e pushkatoi, por i fali jetën. Dhe shfaqen para nesh dy modele. Ja paradoksi i jetës: oficeri fashist gjerman, nga njëra anë, i cili i fal jetën një intelektuali, në nderim të kulturës dhe dijes, megjithëse nga shtëpia e tij ishte qëlluar dhe ishin vrarë gjermanë dhe nga ana tjetër, komunistët, të cilët e arrestuan megjithëse ai sakrifikoi jetën e tij për t’i shpëtuar ata!

Pas arrestimit nga komunistët në 1945, fati i bibliotekës ishte një shqetësim ndoshta edhe më i madh se vetë shqetësimi i arrestimit. Bashkë me librat, në këtë bibliotekë ndodheshin edhe shumë punë të tij si romani i humbur i shkruar rreth viteve 1935, që e rendit në fakt ndër romancierët e parë shqiptarë, përkthime të ndryshme nga italishtja dhe frëngjishtja dhe fletore të tëra me vargje, melodi, histori e folklor i mbledhur në një kohë kur siç e përmenda edhe pak më lart, pak njerëz e kuptonin rëndësinë e tij. Humbën librat, humbi edhe një pasuri folklorike me vlera të padiskutueshme.


Për një periudhë gati 10 vjeçare, Muniri punoi në Mat. Pikërisht për këtë arsye, pjesë të këtij folklori janë përfshirë në libër duke e shtuar dhe zgjeruar akoma më shumë hapësirën gjeografike të punës së tij.

Sigurisht, puna e Munirit shtrihet në shumë fusha, por këtu kemi dhënë shkurtimisht disa mendime për të dhe punën e tij në mbledhjen e folklorit, pikërisht për atë se çfarë përfaqëson pjesërisht edhe ky libër.

Muniri e vlerësonte shumë veprën e Haki Stërmillit “Fyelli i Dibrës”, me vërejtjen se materiali i sjellë aty, vjen vetëm nga një burim, pra, të gjitha këngët janë marrë vetëm nga një këngëtar. Disa këngë nga kjo vepër janë rivendosur edhe në veprën e tij sepse, ose vijnë të plotësuara me vargje të tjera të zbuluara nga Muniri, ose për t’u plotësuar me vijën melodike.

Këngët shoqërohen edhe këtu me një shpjegim, i cili flet shkurtimisht për personazhet dhe kohën kur kanë ndodhur ngjarjet, pra për historinë e këngëve. Muniri ishte një mbështetës i mendimit se edhe këngët e popullit duhet të pranohen e të merren si dokumente historike, prandaj paraqitja e tyre me data, kënaq të dyja palët edhe historinë edhe Munirin.

Ne do të flasim e gjykojmë për Munirin mbi bazën e asaj se çfarë kemi sot në dorë. Pikërisht për këtë arsye, për të patur një gjykim sa më afër të vërtetës, unë u përpoqa me sa mund, të nxjerr në dritë e të bëj të njohur punën e tij, veç dua të theksoj, se kjo që ne kemi sot, është një pjesë shumë e vogël e asaj që duhet të ishte në të vërtetë; p.sh. në shënimet e tij, ai flet për një cikël të tërë baladash me titull “kishte pasë motra nandë vëllazën”, por unë gjeta vetëm një, atë që kam paraqitur në libër. Ku janë të tjerat? Etj, etj. Jo pa qëllim, ndër biseda, me shokë e miq shprehem për punën e tij se qypi i mbushur iku. Iku bashkë me të. Kanë mbetur vetëm ato që ranë nga qypi, thërmijat. Unë, ato kam mbledhur.



MUNIR SHEHU
NË GJURMË TË KËNGËS DIBRANE
- Këngë e balada
- Epikë historike e lirika
Përgatiti për botim: Mirdash Shehu
ISBN: 978-9928-387-33-2
438 faqe / 1500 lekë

Më 31 mars 1990, 33 vite më parë, në moshën 80-vjeçare, u nda nga jeta Munir Shehu, një nga mbledhësit nga mbledhësit më të hershëm e më pasionantë, gjurmues i palodhur në kërkim të historisë, këngëve e valleve, vargjeve e melodive popullore të vendit të tij.
Në këtë përvjetor, Mirdash Shehu - i biri i autorit dhe Botimet M&B sjellin për lexuesit librin më të ri, “Në gjurmë të këngës dibrane”, një përmbledhje me këngë, balada, epikë historike dhe lirika.
Pas botimit të “Rreth melosit në këngët dhe vallet dibrane”, botimi i këtij libri me balada, epikë historike e lirika popullore të mbledhura nga Munir Shehu, përbën një moment të rëndësishëm për kulturën dhe etnokulturën e Dibrës, por nisur nga ajo se çfarë vetë Dibra përfaqëson në kulturën shqiptare, ky libër është një pasuri me vlerë të veçantë që i shtohet thesarit të kulturës popullore kombëtare.
Këngët e botuara në këtë vëllim shoqërohen edhe me një shpjegim, i cili flet shkurtimisht për personazhet dhe kohën kur kanë ndodhur ngjarjet, pra për historinë e këngëve. Autori ishte një mbështetës i mendimit se edhe këngët e popullit duhet të pranohen e të merren si dokumente historike, prandaj paraqitja e tyre me data i shërbente edhe historisë por edhe mbledhësit.
Shumica e këngëve të këtij vëllimi botohen në disa variante, - siç i ka mbledhur autori, si dhe me vijën melodike të shkruar po prej autoit.

BOTIME TË MUNIR SHEHUT:

- “Dibra në shekujt e sundimit osman”
- “Dibra I - në vitet 1840-1860”
- “Shtek më shtek e skutë më skutë”
- “Rrëfime dhe këngë popullore”
- “Gjenealogjia e fisit Shehu të Peshkopisë”
- “Rreth melosit në këngët dhe vallet dibrane”
- “Në gjurmë të këngës dibrane”

BOTOHET MONOGRAFIA PËR DOM NIKOLLË KAÇORRIN

Dom Nikollë Kaçorri për Dibrën dhe dibranët

Nga **HAJREDIN ISUFI**, historian

KONGRESI I DIBRËS

Në përvjetorin e parë të revolucionit të tyre xhonturqit vendosën të bëjnë në Dibër një kongres; gjoja të festohej "bashkimi i shqiptarëve me komitetin "Bashkim e Përparim". Qëllimi i vërtetë i këtij kongresi ishte për të bërë për vete shqiptarët, sepse gjatë verës e vjeshtës së vitit 1908 qe rritur një valë e madhe pakënaqësie ndaj regjimit të ri xhonturk. Valiu i Shkodrës kishte dhënë udhëzime që delegatët për në Kongresin e Dibrës të përzgjidheshin përkrahës të komitetit xhonturk. Ftesat për zgjedhjen e delegatëve për Kongresin e Dibrës u shpërndanë në të gjitha krahinat në emër të Klubit të Dibrës, drejtuesit e të cilit bashkëpunonin me xhonturqit. Klubi i Dibrës e konsideronte veten "Partia shqiptare konstitucionale e Dibrës".


Caktimi i delegatëve në qytetet kryesore të vendit ngjalli debate e konflikte të ashpra midis rretheve patriotike dhe administratës xhonturke. Qëllimi i xhonturqve ishte të zgjidhnin delegatë për në Dibër njerëzit e besueshëm të tyre. Për këtë qëllim tentuan të krijonin në Tiranë një të ashtuquajtur klub shqiptar si ai i Dibrës dhe, nga përbërja e kryesisë së tij, të nxirrnin delegatët për në kongres.

Ndërkohë, populli i Durrësit, nën drejtimin e pleqësisë së qytetit, ishte mbledhur më 15 korrik, përpara bashkisë së qytetit dhe me brohoritje shpalli përfaqësuesit të zgjedhur për në Kongresin e Dibrës. Populli kishte caktuar katër delegatë: Dom Nikollë Kaçorrin, Neki Libohovën, mjekun e Bashkisë, Myftiun e Durrësit dhe Vasil Rusin.

Një ditë më vonë, Komiteti Xhonturk në Durrës, i cili përbëhej kryesisht prej oficerësh, nën drejtimin e mytesarifit Zeki Beu, që ishte emëruar në atë post në qershor të vitit 1909, lajmëroi me tellall popullsinë e qytetit të mblidhej para bashkisë për një mbledhje, ku do të bëheshin disa sqarime. Mytesarifi , që vepronte nën urdhrat e Komitetit Xhonturk, doli përpara popullit dhe deklaroi se i kishte bërë një telegram Sejfulla Pashës, valiut të Shkodrës, se mbledhja për caktimin e delegatëve nuk kishte qenë e rregullt dhe priste përgjigje. Kaq ishte lajmërimi i mytesarifi t dhe populli u shpërnda.

Reagimi i Dom Nikollë Kaçorrit qe i menjëhershëm. Ai dorëzoi mandatin e tij në mënyrë demonstrative. Fill pas Dom Kaçorrit, të njëjtin veprim bëri dhe dr. Neki Libohova, një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Kaçorrit. Ndërkohë nga Shkodra, pas 3-4 ditësh, kishte arritur në Durrës përgjigja e valiut të Shkodrës, që i cilësonte si të padëshiruar si delegatë jo vetëm Kaçorrin dhe dr. Neki Libohovën, por edhe Myrtesim Këlliçin, myftiun e Durrësit. Kështu, nga të katër delegatët e zgjedhur nga populli i Durrësit, në listën e kandidaturës për delegat në Dibër, mbeti vetëm njëri, Vasil Rusi; tre të tjerët duhet të rizgjidheshin edhe një herë. Komiteti Xhonturk në vend të Kaçorrit caktoi Filip Serreqin, ndërsa dr. Neki Libohova mandatin e tij ia dorëzoi Mustë Ali Brahimit, kurse në vend të myftiut u vu në listën e delegatëve avokati Hafiz Ali Podgorica. Kështu delegatët e Durrësit që shkuan në Kongresin e Dibrës ishin: Mustë Ali Brahimi, Filip Serreqi, Vasil Rusi dhe Hafi z Ali Podgorica.

Shtrohet pyetja: Pse u refuzua pjesëmarrja e Kaçorrit dhe e bashkëpunëtorëve të tij në Kongresin e Dibrës, nga drejtuesit kryesorë të sanxhakut të Durrësit dhe vilajetit të Shkodrës? Përgjigjen e kësaj pyetjeje nuk është vështirë për t'iu përgjigjur, po të kemi parasysh disa konflikte të hapura që kishin



plasur mes Komitetit Xhonturk

nga njëra anë dhe parisë së qytetit të Durrësit. Xhonturqit (turqit e rinj) e kishin çjerrë maskën e tyre. Premtimet e deklaruara se do të respektonin liritë dhe të drejtat dita-ditës po zëvendësoheshin me veprime të dhunshme për të nënshtruar popullin ndaj platformës politike të xhonturqve, që synonte të shuante çdo përpjekje të patriotëve në luftë për çështjen kombëtare.

Dom Nikollë Kaçorri ishte një nga patriotët më të ekspozuar dhe i padëshiruar prej Komitetit Xhonturk. Nga një burim konsullor mësojmë se, në dhjetor të vitit 1908, Durrësin e vizitoi Ferid Pasha, anëtari i Klubit të Stambollit. Qëllimi i vizitës së tij në Durrës ishte të kontaktonte me krerët e lëvizjes patriotike durrsake, për t'i dhënë asaj një impuls të ri. Ferid Pasha kontaktin e tij të parë e bëri me Dom Nikollë Kaçorrin. Disa muaj më vonë, në prill të vitit 1909, në selinë e Dom Nikollës arriti një mik tjetër në emër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Dervish Hima.

Të gjitha këto hyrje e dalje të patriotëve më në zë në Durrës dhe kontaktet e tyre me Kaçorrin e bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë kishin rënë në sy të Komitetit Xhonturk që e shihte Kaçorrin me dyshim e mosbesim të madh. Gjithashtu, Komiteti Xhonturk dhe mytesarifi, kishin informacione të plota për famullitarin katolik të Durrësit se para disa kohësh kishte qenë një nga drejtuesit kryesorë të lëvizjes anti-osmane në Kurbin e në rrethinat e tij. Të gjitha këto e bënin famullitarin e Durrësit njeriun më të padëshiruar për të qenë delegat në një kongres që kishte për synim shpalosjen e platformës xhonturke, e cila binte ndesh me vendimet e Kongresit të Manastirit, ku kishte qenë delegat edhe Kaçorri.

Dom Nikollë Kaçorri fillimisht e kishte pranuar mandatin për në Kongresin e Dibrës, me synimin që të luftonte së bashku me patriotët e tjerë, nga tribuna e Kongresit, programin xhonturk. Por megjithëse u hoq arbitrarisht nga Zeki beu, Kaçorri me patriotët e tjerë durrsakë, nisi një lëvizje të fuqishme kombëtare në Durrës. Gjatë kohës që vazhdonin punimet e kongresit në Dibër, një përfaqësi e pleqësisë së Durrësit hartuan një deklaratë për t'ia dorëzuar mytesarifit, ku paralajmërohej Zeki beu se përfaqësuesit e popullsisë durrsake do të krijonin një klub që do të kishte për qëllim të mbronte interesat e qytetarëve durrsakë dhe se ky klub do të ishte krejt i shkëputur, i lirë dhe i pavarur nga Klubi Xhonturk. Kjo kërkesë ultimative e parisë së Durrësit ishte një kundërpërgjigje e

Imzot Nikollë Kaçorri qëndron në themelet e shtetit shqiptar në të gjitha kuptimet e fjalës themel... Jo vetëm se hodhi firmën përkrah Ismail Qemalit dhe ishte ndër pesë personat që valëvitën për herë të parë flamurin e Shqipërisë së pavarur, por u bë edhe zëvendëskryeministri i parë i shtetit të ri shqiptar.
Ai qëndron në themelet e shtetit shqiptar jo vetëm sepse është njëri ndër gurët e mëdhenj të këtij themeli, por sepse më shumë se të gjithë protagonistët e tjerë ka mbetur i fshehur dhe i mbuluar me heshtje nga historia shqiptare si gjatë periudhës komuniste, ashtu edhe gjatë këtyre njëzet vjetëve. Themelet janë të padukshme për vetë funksionin e tyre të mbajtjes së godinës që mbështet mbi të, por, nëse njerëzit që banojnë në atë godinë lejojnë të përjashtohen nga themelet gurë të tillë të mëdhenj, rrezikojnë të banojnë në një godinë të lëkundshme.

RROK MIRDITA
(Nga fjala e mbajtur me rastin e kthimit të eshtrave të Dom Nikollë Kaçorrit në atdhe, shkurt 2011)

menjëhershme ndaj veprimeve të dhunshme që kishte nisur të manifestonte administrata e re e regjimit xhonturk kundër shqiptarëve. Pleqësia durrsake, popullsia dhe klerikët myslimanë, katolikët dhe ortodoksët e Durrësit shihnin te veprimet e mytesarifi t dhe të Komitetit Xhonturk një diktaturë të egër si ajo e kohës së sulltan Hamidit. Myftiu i Durrësit, në shenjë proteste kundër mytesarifit, i dërgoi një letër të gjatë Sheh Ul Islamit në Stamboll.

Pleqësia durrsake, megjithëse kishte vendosur hapjen e klubit shqiptar kundër vullnetit të mytesarifit, për mungesë të mjeteve dhe të një mësuesi të aftë për të dhënë gjuhën shqipe në shkollën shqipe që do të hapej pranë klubit, e la hëpërhë. Ndërkohë, rrethet patriotike durrsake me Kaçorrin në krye bënë një hap tjetër: në gusht të vitit 1909 formuan dy komitete mbrojtëse dhe sigurie për popullsinë. Komiteti i parë, përbëhej prej 22 anëtarësh, nga njerëzit më të përzgjedhur pa dallime fetare. Ai komitet kishte për qëllim, që të kontrollonte të gjitha veprimet e dhunshme të Komitetit Xhonturk e të mytesarifit ndaj popullsisë e të grumbullonte ankesat e popullit.

Komiteti i dytë, përbëhej nga 6 anëtarë, të përzgjedhur nga paria kryesore e Durrësit. Kryetar Nderi i tij ishte caktuar Nikollë Kaçorri, por, në fakt, rolin e kryetarit e luante dr. Neki Libohova. Nënkryetarë ishin Kristaq Rama dhe Pali Terka, ndërsa anëtarë të këtij komiteti ishin Jahja Ballhysa, Ilia Llavda dhe Agustin Serreqi. Detyra e këtij komiteti ishte që ankesat e popullit kundër zyrtarëve osmanë, që i merrte nga Komiteti i parë, t'ia shtronte për zgjidhje mytesarifit dhe nëse nuk merrnin rrugëzgjidhje, i drejtoheshin valiut në Shkodër e deri Portës së Lartë në Stamboll. Krijimi i Komitetit Shqiptar në Durrës që kishte marrë përsipër mbrojtjen e popullsisë nga nëpërkëmbja e xhonturqve, e kishte rritur shumë besimin e banorëve durrsakë te përfaqësuesit e vet. Ai Komitet nuk kishte asgjë të përbashkët me komitetin lokal xhonturk, që e konsideronte veten gjoja

si klubi i shqiptarëve, për shkak se në përbërjen e tij kishte disa elementë që e quanin veten shqiptarë, por që ishin me origjinë të largët sllave dhe s'kishin asgjë të përbashkët me kulturën e ndjenjat kombëtare shqiptare.

DOM NIKOLLË KAÇORRI MES LURIANËVE

Kaçorri nuk i kishte shkëputur për asnjë çast lidhjet me bashkë fshatarët, shokët e fëmijërisë së tij lurianë. Kur doli nga burgu, Nikollë Kaçorri i dërgoi një letër Hasan Koçit, një kaçaku lurian. Me një grup të vogël djemsh lurianë, Hasani kishte ngritur krye kundër sundimit osman. Famullitari i Durrësit kishte jo vetëm njohje të hershme me Hasan Koçin, por, në vitet 1905-1907, në kryengritjen e Kurbinit, një çetë luftëtarësh lurianë përkrahu Dom Nikollën në kryengritjen e Kurbinit. Famullitari i Durrësit i shkruante "kaçakut":

"Fol me luras, o Hasan Kaçi e gjithkush do dëgjojë që ai grusht i vogël trimash të tu të rritet e të bëhet rrebesh kundër turkut, që na ka zaptue vendin...".

Nikollë Kaçorri shkoi në Lurë për të koordinuar lidhjet dhe bashkëveprimet e lurianëve me fqinjët e tyre. Ndalesën e parë në fshatin e Lurës e bëri në shtëpinë e Abaz Isufit; për ta ngushëlluar për humbjen e një të afërmi të tij. Kur mësuan se në shtëpinë e Abaz Isufit kishte ardhur Kaçorri, lurasit shkuan në shtëpinë e bashkëfshatarit për t'i uruar mirëseardhjen Kaçorrit si dhe për t'i shprehur kënaqësinë që kishin ndjerë për lirimin e tij nga burgu. "Oda e madhe e burrave në shtëpinë e Abaz Isufit atë natë, -shkruan në kujtimet e tij Hil Kançi, -u mbush plot me burra të mençur. Në fytyrat e tyre shprehej kënaqësia që ndjenin se kishin mes tyre priftin patriot lurian".

Dom Nikolla e nisi bisedën hollë-hollë, fillimisht me Mustë Osmanin, një burrë i mençur i parisë së Lurës. Biseda shkonte nga shkonte dhe përqendrohej te harmonia që duhet të kishin lurianët mes vetes dhe me fqinjët e tyre. Gjatë bisedës, Kaçorri u ishte drejtuar burrave të pranishëm në odë: "Forca jonë varet sesa të bashkuar dhe të lidhur do të jemi mes vetes dhe me fqinjët tanë dhe sidomos me oroshasit që i kemi fqinjët më të afërt...". Disa nga të pranishmit, me zë të ulët i thoshin njëri-tjetrit që kishin përbri: "Nikollë Kaçorrit duhet t'ia vemë menjen e ta përkrahim, t'ia vemë disa gjem me veti se asht i vnefshëm për Shqipninë".

Dom Nikollë Kaçorri sa njihte shpirtin luftarak, patriotik e liridashës të lurianëve, po aq njihte mosmarrëveshjet që shpërthenin mes tyre dhe fqinjëve oroshas, që herë-herë merrnin forma të ashpra gjakmarrjeje, që shoqëroheshin me jetë njerëzish nga të dyja palët. Kjo e trishtonte shumë priftin me origjinë luriane dhe nuk mund të largohej prej andej, duke lënë pas një plagë të hapur, që sillte përçarje dhe armiqësi mes shqiptarëve malësorë, në një kohë që duhet të ishin më të lidhur se kurrë kundër një armiku të egër. Kaçorri vendosi që me kryepleqësinë e Lurës dhe të fshatrave përreth të organizojë në prill të vitit 1911 një tubim paqëtimi. Për mbajtjen e këtij kuvendi të burrave u caktua vendi i quajtur "Vlladar". Aty ishin ftuar të merrnin pjesë kryepleqësia e fshatrave të Dibrës, krerët e fiseve më me emër të krahinës, klerikë etj.

Prifti patriot Dom Nikollë Kaçorri e mori i pari fjalën në atë tubim. Pasi përshëndeti të pranishmit, bëri një tablo të shkurtër të situatës së rënduar që kalonin krahinat e malësisë nga administrata xhonturke. Ai tregoi se forca të shumta turke kishin ndërmarrë sulme të ashpra kundër fshatrave të Delbinishtit, Malbardhës, Skurajt, Vinjollit. Ekspeditat ndëshkimore të tyre kundër malësorëve



kryengritës, xhonturqit i shoqëronin edhe me një propagandë të gjerë, nëpërmjet së cilës kishin për qëllim që, me anën e klubit të oficerëve, të bënin për vete elementë të lëkundur brenda rretheve patriotike shqiptare. Pasi bëri të qartë situatën e zymtë që kalonte vendi nën sundimin xhonturk, me fjalë zemre Kaçorri iu drejtua burrave të pranishëm:

"...Vëllezërit e mi! Sot është koha të shikojmë në sy njëri-tjetrin dhe me zemër të hapur, me dashuri dhe besë. Mëritë, gjaqet, hasmëritë, t'ia harrojmë njeri-tjetrit, se ne e kemi hasmin brenda dhe ky është hasmi i të gjithëve. Nëse ne luftojmë me njeri-tjetrin, ne i themi të huajit "eja na shtyp e na sundo ti, se ne jemi në luftë me njeri-tjetrin".

Një vend të rëndësishëm në shënimet e tij Hil Kançi u kushton vlerësimit të fjalëve të Dom Nikollës para të pranishmëve. "Fjalët e tij, kujton Hila, merrnin krahë e fluturonin. Ato dukeshin, sikur në shpirtrat e të pranishmëve, mbillnin vetëm dashuri. Ndërmjet të pranishmëve, që ishin aty, kishte edhe nga ata, që u përkisnin familjeve, që ishin në gjakësi të vjetër. Solemnisht, ata, që kishin qenë në gjak, drejtoheshin me përulësi drejt Dom Nikollë Kaçorrit, i puthnin dorën, që tregonte, sipas ligjeve të vendit, se që nga ai çast, hiqnin dorë nga hasmëria e tyre përballë rrezikut kombëtar.

Me dy shoqëruesit e tij Dom Nikollë Kaçorri, nga Lura u nis drejt Oroshit. Në takimet që pati me parinë e fiseve të malësorëve dhe me famullitarin e Oroshit, ashtu si në Lurë, nuk iu drejtua për t'u bërë thirrje në luftë kundër sundimit osman, sepse ata i kishin pushkët të varura në odat e tyre dhe prisnin vetëm një sinjal. Forcën dhe suksesin e malësorëve, Dom Kaçorri nuk e shihte as tek trimëria e tyre, as tek shpirti luftarak që i karakterizonte, por tek uniteti, lënia pasdore e mërive dhe gjakmarrjeve. Kjo ishte ideja e bisedave që bëri prifti katolik i Durrësit me parinë oroshane.

Rrugëtimi i Dom Nikollë Kaçorrit në zonat e thella të malësisë veriore e verilindore qe i suksesshëm. Fillimisht, gazeta londineze "Times", në editorialin e saj, njoftonte se prifti Kaçorri kishte hyrë në lidhje me parinë e Matit, të Dibrës, Mirditës, Kurbinit e zona të tjera për një besëlidhje ndërkrahinore. U vendos që Kuvendi i Besëlidhjes të bëhej në Lurë. Për mbledhjen e kuvendit ndërkrahinor që u mbajt në Lurë dhe vendimet që u morën nuk kemi shumë informacione. Nga një gazetë e kohës mësojmë se në atë kuvend merrnin pjesë edhe bajraktarët e Shalës, të Shoshit etj. Në Kuvendin e Lurës u lidh një besëlidhje ndërkrahinore e zonave të thella të malësisë për të qenë të bashkuar në kryengritjen antiosmane, sapo të jepej sinjali nga drejtuesit e Komitetit të Kryengritjes së Përgjithshme. Lëvizjet e Dom Nikollë Kaçorrit në zonat që përshkruan më sipër nuk ishin as personale e as spontane. Ato bëheshin në kuadrin e organizimit të kryengritjes.

Në këtë kohë, kur Dom Nikollë Kaçorri lëvizte nga Selita në Kthellë e Lurë, nga Oroshi në Mirditë, Kurbin etj., dhe organizonte takime me krerët ndërkrahinorë e tubime, Faslli Toptani kishte shkuar në Mal të Zi që të merrej vesh me kryengritësit. Por sapo shkeli në Mal të Zi, Toptani u ndalua nga qeveria malazeze dhe u urdhërua të largohej menjëherë. Faslli Toptani largohet nga Mali i Zi dhe arriti në Shkodër dhe prej andej, shkoi në Durrës. Qeveritarët xhonturq, sapo Faslli Toptani shkeli në Durrës, shkuan ta arrestonin, por, falë kapitenit të vaporit që ndaloi hyrjen e xhandarëve xhonturq në bordin e vaporit, i shpëtoi arrestimit.

Nga shtypi i kohës mësojmë se në Shqipërinë veriore kishte filluar një lëvizje e fuqishme antiosmane. Në Shkodër punët po trasheshin e ditën e Shën Markut ishin betuar të fillonte një kryengritje. Thuhej se Dibra e Mati bllokuan rrugën e Manastirit. Në radhët e forcave xhonturke u mblodhën e u mobilizuan në Durrës, Tiranë dhe Elbasan, 9 tabore redife.

Malësorët kishin rrëmbyer armët dhe ishin bashkuar me krahinat kryengritëse të malësisë. Porta e Lartë nuk u lëshonte pe shqiptarëve, megjithëse lëvizja antiosmane ishte shtrirë në të gjitha trevat shqiptare. Qeveria turke, për të shuar kryengritjen, ndërmori goditje të ashpra kundër vatrave kryesore kryengritëse në rrethinat e Durrësit. Në maj të vitit 1911, një trupë ushtarake turke prej 80 vetash, hyri në fshatin Delbinisht. Fshati Delbinisht, që në atë kohë kishte rreth 12 shtëpi katolike, u gjend nën presione të egra e të dhunshme të ushtarëve turq. Të gjitha shtëpive të fshatit iu bë një kontroll i imët për armë. Forcat turke prej andej shkuan në fshatin Malbardhë, Skuraj e Vinjoll. Dom Nikollë Kaçorri, sapo mori vesh për sulmet turke në territorin e arqipeshkvisë së tij, u lidh menjëherë me komitetet kryengritëse dhe parinë e atyre zonave, që të boshatiseshin fshatrat e të merrnin rrugën e malit, pasi të siguronin familjet. Atëherë, ekspeditat turke vazhduan mësymjen. Një trupë tjetër, pohon konsulli austro-hungarez, Halla, ishte nisur nga Tirana me urdhër të Turgut Pashës për në drejtim të grykë-derdhjes së Matit e të Ishmit për të kontrolluar bregdetin, që të mos hynin armë për kryengritësit.

Dom Nikollë Kaçorri sa njihte shpirtin luftarak, patriotik e liridashës të lurianëve, po aq njihte mosmarrëveshjet që shpërthenin mes tyre dhe fqinjëve oroshas, që herë-herë merrnin forma të ashpra gjakmarrjeje, që shoqëroheshin me jetë njerëzish nga të dyja palët. Kjo e trishtonte shumë priftin me origjinë luriane dhe nuk mund të largohej prej andej, duke lënë pas një plagë të hapur, që sillte përçarje dhe armiqësi mes shqiptarëve malësorë, në një kohë që duhet të ishin më të lidhur se kurrë kundër një armiku të egër.

Ndërkohë, xhonturqit propagandonin në shtypin e tyre se shqiptarët po të ulnin armët me rastin e udhëtimit, që bënte sulltan Mehmet Reshati në Maqedoni, do t'u bëhej një falje kryengritësve shqiptarë, madje edhe do të dëmshpërbleheshin për të gjitha dëmet, që ishin bërë, nëse ata do të zbrisnin nga malet në shtëpi.

Kryengritësit paralajmëroheshin se, nëse refuzonin kërkesën që u afrohej, do të sulmoheshin nga forcat turke. Madje, do të ndiqeshin këmba-këmbës edhe në territorin e Malit të Zi, derisa të shpartallohej plotësisht kryengritja shqiptare e Shqipërisë së Veriut. Paqja që ofronte qeveria xhonturke ishte shumë larg kërkesave për autonomi. Kjo bëri që propozimet e xhonturqve të hidheshin poshtë nga malësorët kryengritës, të cilët deklaronin se do të luftonin deri në fund për kërkesat e Gërçës, që ishin njohja e kombit shqiptar, bashkimi i vilajeteve me popullsi shqiptare, vendosja e një administrate shqiptare, krijimi i gjykatave, xhandarmërisë e policisë me elemente vendas.

Është me interes të vihet në dukje se në kohën kur qeveria xhonturke përpiqej, duke përdorur të gjitha mjetet e veta propagandistike, që të bindte malësorët, Dom Nikollë Kaçorri në një mbledhje që mbajti në Kurbin me përfaqësues edhe të krahinave përreth, hodhi idenë që t'i dërgohej një peticion Portës së Lartë nga kryepleqtë malësorë, në emër të kryengritësve. Në letër do të kërkohej se nëse ata do të ktheheshin në shtëpitë e tyre, jo vetëm të kishin garancinë e Fuqive të Mëdha, por edhe armët nuk do t'i dorëzonin se u duheshin për mbrojtjen e jetës dhe të nderit të tyre. Në atë tubim, deklaron Sheh Adem Rada, famullitari i Durrësit lëshoi edhe një herë thirrjen që lëvizja çlirimtare të rritej dhe të merrte shtrirje sa më të madhe.

Përgatiti për botim: Naim Zoto
www.botimenaimi.com

(Marrë nga libri i sapobotuar me titull "Dom Nikollë Kaçorri" dhe nëntitull "Nënshkrues i Pavarësisë dhe nënkryetar i Qeverisë Kombëtare të kryesuar nga Ismail Qemali", shkruar nga historiani Hajredin Isufi, botimet "Naimi", Tiranë 2023)

"Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës", një enciklopedi e Dibrës në fushën e gjeologjisë dhe të mineraleve

Nga prof. **HAJRI SHEHU**

Përmbajtja e librit "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës" shpaloset në tre krerë. Ata janë: Gjeologjia e Dibrës / Mineralet e Dibrës / Rreziku gjeologjik i Dibrës. Libri paraprihet nga një *Hyrje* e nga një *Parathënie* dhe mbyllet me *Punime të autorit (si autor i vetëm, si autor i parë dhe si bashkautor)* dhe një jetëshkrim shkencor të autorit, *Curriculum Vitae*. Punimet shkencore janë të shumta. Curriculum Vitae është një faqe. Edhe shumë më shumë se një faqe po të ishte, ajo nuk do ta përfshinte dot tërë veprimtarinë dhe tërë punën e tij në Ndërmarrjen Gjeologjike në Bulqizën e kromit, në Ekspeditën Gjeologjike të Peshkopisë, në ekipin e Korabit, në Sektorin e gjeologjisë, Peshkopi (si përgjegjës), në Degën Rajonale Gjeologjike të Peshkopisë (si drejtor), në Ndërmarrjen Gjeologjike, Bulqizë (si drejtor), në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Tiranë, si anëtar i senatit akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, si punonjës shkencor në Departamentin e gjeologjisë të Institutit të Gjeoshkencave, Tiranë. Në vitin 1987 është dekoruar me "Medalje për punë të shquar në miniera e gjeologji" dhe në vitin 2021 me "Certifikatë mirënjohjeje" nga Universiteti Politeknik dhe Instituti i Gjeoshkencave, me motivacionin: "Për përkushtimin e tij të shënuar dhe kontribute të rëndësishme në studimet shkencore". Me siguri e presin dekorime të tjera.

Libri "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës" i prof. Vesel Hoxhës është mirëfilli një enciklopedi e Dibrës në fushën e gjeologjisë dhe të mineraleve, madhor në format, në paraqitjen shkrimore dhe në ilustrime. Dy fotot në kapakun e parë dhe të dytë e përgatisin lexuesin denjësisht për ato që do të lexojë në libër. Sigurisht, për përgatitjen për shtyp dhe botimin, vërtet luksoz, merita i përket shtëpisë botuese M&B. Redaktore letrare është Miranda Goleci. Recensues janë dy profesorë të mirënjohur – Ibrahim Milushi dhe Ilir Alliu.

Në thënien tonë të parë përmendëm fjalën *sirecension*, pra, jo *recension*, sepse nuk i njohim gjeologjinë dhe mineralogjinë. Por nga libri i prof. Veselit mësuam jo pak për gjeologjinë dhe mineralogjinë e Dibrës. Mësuam sepse prof. Veseli ka shkruar bukur për Dibrën e gjeologjisë dhe të minierave. Dhe profesori barabitet me dijetarin e arkeologjisë – prof. Adem Bungurin. Të dy profesorët merren me studimin e nëntokës. Të dy profesorët zbulojnë pasuritë e mëdha të nëntokës sonë.

Autori përmend në libër një varg gjeologësh, të zotë e të përkushtuar, me të cilët e ka lidhur profesioni e puna. Fjalët, cilësimet e vlerësimet e tij janë homazh për mundin e punën e tyre të pakursyer në atë sektor aq të vështirë, por aq frytdhënës për ekonominë e vendit. Kur kemi qenë nxënës në shkollën pedagogjike, Peshkopi (1956-1960), dinim emrin e drejtorit të minierës së kromit në Bulqizë, Todi Manço. Ai ishte legjendë për ne. Nuk ishte vendës. Po aq ishte edhe inxhinier Bujar Pata. Profesor Bashkim Lleshi, dibrani ynë, ish-konviktori më i ri i atyre viteve, zë vend të veçantë në gjeologjinë e Dibrës.

Libri të shëtit maleve e lëndinave, majave e kepave, rrjedhave e liqeneve, minierave e gërmimeve për miniera. Duket sikur autori të merr për dore e të thotë: Eja se do të të tregoj diçka, që ti nuk e ke parë dhe do të kënaqesh. Kjo e bën librin, jo vetëm të këndshëm, por edhe shumë të pranueshëm e të pranishëm edhe për dikë që ka më pak dije për gjeologjinë dhe mineralogjinë. Shumë interesant e kureshtjendjellës për një joprofesionist është, për shembull, kreu i dytë, *Mineralet e Dibrës sipas rezultateve nga kërkimet dhe punimet gjeologjike ndër vite*. *Kërkimet dhe punimet* pasohen me *perspektivën e kërkimeve*. Dhe lexuesi mëson se në bashkinë e Dibrës ka 128 vendburime, objekte dhe shfaqje mineralizimi metalor dhe 79 vendburime, objekte dhe shfaqje mineralizimi jometalor. Mbaj mend, kur vinin e shkonin në anët tona ekipe gjeologësh, me ato këpucët e rënda, çantat e shpinës e çekiçët e gurit. Baballarët, me atë shpirtin e tyre të pastër atdhetar, pyesnin: A thue gjetën ndonji madem? Ç'ar mademi gjetën? A ban vakí me gjet madem florini? (*Madem* = xeheror, mineral). Sikur të ishin tashti e t'u thoshte inxhinier Veseli këta numra - 128 dhe 79! Mirëpo ata do të donin t'u thoshte edhe vendin ku gjendej aksh madem, se viset i dinin *me pëllam(b)ë*. Edhe këtë do t'ua thoshte inxhinieri: Për çdo vendburim, objekt a shfaqje mineralizimi etj., inxhinieri jep koordinata gjeografike a topografike.



Universiteti Politeknik i Tiranës
Instituti i Gjeoshkencave
Departamenti i gjeologjisë, Vesel Hoxha,
Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës, Botimet M&B,
Tiranë, 2022, 597 f. (format A4), 3500 lekë

Libri të shëtit maleve e lëndinave, majave e kepave, rrjedhave e liqeneve, minierave e gërmimeve për miniera. Duket sikur autori të merr për dore e të thotë: Eja se do të të tregoj diçka, që ti nuk e ke parë dhe do të kënaqesh. Kjo e bën librin, jo vetëm të këndshëm, por edhe shumë të pranueshëm e të pranishëm edhe për dikë që ka më pak dije për gjeologjinë dhe mineralogjinë. Shumë interesant e kureshtjendjellës për një joprofesionist është, për shembull, kreu i dytë, Mineralet e Dibrës sipas rezultateve nga kërkimet dhe punimet gjeologjike ndër vite. Kërkimet dhe punimet pasohen me perspektivën e kërkimeve. Dhe lexuesi mëson se në bashkinë e Dibrës ka 128 vendburime, objekte dhe shfaqje mineralizimi metalor dhe 79 vendburime, objekte dhe shfaqje mineralizimi jometalor. Mbaj mend, kur vinin e shkonin në anët tona ekipe gjeologësh, me ato këpucët e rënda, çantat e shpinës e çekiçët e gurit. Baballarët, me atë shpirtin e tyre të pastër atdhetar, pyesnin: A thue gjetën ndonji madem? Ç'ar mademi gjetën? A ban vakí me gjet madem florini? (Madem = xeheror, mineral). Sikur të ishin tashti e t'u thoshte inxhinier Veseli këta numra - 128 dhe 79! Mirëpo ata do të donin t'u thoshte edhe vendin ku gjendej aksh madem, se viset i dinin me pëllam(b)ë. Edhe këtë do t'ua thoshte inxhinieri: Për çdo vendburim, objekt a shfaqje mineralizimi etj., inxhinieri jep koordinata gjeografike a topografike.

Kreu i dytë (rreth 250 faqe), *Mineralet e Dibrës,* paraprihet nga një sihyrje – krejt shkencore, sigurisht për një gjeolog e studiues gjeologjie. Pastaj vijnë nëntë studime dhe dy pasqyra. Pasqyrat janë një sintezë shkencore me të dhëna të veçanta. Për nga përmbajtja, shtjellimi i lëndës, formulimet shkencore, fraza gjuhësore, terminologjia, argumentet, të dhënat gjeologjike, prerjet gjeologjike, hartat, grafikët e katalogët, *Metalogjenia e Dibrës* (te kreu i dytë i librit) sipas periudhave gjeologjike është një studim shkencor, i denjë për t'u paraqitur në çdo katedër gjeologjie a në çdo institut studimesh gjeologjike të Europës. Metalogjenia, - shpjegon autori, - është shkenca që merret me studimin e rregullsive, shpërndarjen hapësinore dhe kohore të mineralizimeve dhe me lidhjet e tyre gjenetike me fazat e zhvillimit gjeologjik të një treve.

Në kreun e dytë janë të dhënat për mineralizimet e vendburimet minerale, madje, edhe për minerale të rralla në Dibër. Jepen të dhëna edhe për naftë e gaz. Dhe më tej, në një nënkapitull jepen të dhëna të llogaritura për rezerva mineralesh: hekur, krom, bakër etj. Një studim skrupuloz dhe një paraqitje skrupuloze për lexuesin. Të dhënat për vendburimet janë krejt konkrete. Është njëlloj, sikur inxhinier Veseli të të thotë: Eja me mua të të tregoj se ku ka hekur, shfaqje hekuri a shenja hekuri. Shih, p.sh., të thëna të tilla: *(te) Përroi i Vneshtave, Blliçe; Kthesa e rrugës për në Rabdisht*. Është njëlloj sikur të na thotë: Ja ku i keni këtu, poshtë këmbëve tuaja. Më tej është nënzëri: *Minerale me rezerva të llogaritura*. Kjo thënie të mahnit: Atje nën tokë, me përllogaritjet shkencore gjeologjike janë matur dhe peshuar tonët e xeherorëve (mineraleve). Përveç të dhënave për vendin, pozicionin gjeografik, sasinë e rezervave, jepen edhe të dhëna për cilësinë e xeherorit, veçoritë morfologjike etj. Dhe të gjitha këto, jo për 5 a 10 vendburime, objekte a shfaqje mireralizimesh, por për qindra.

Me të njëjtin skrupulozitet jepen në libër të dhënat për lëndët e ndërtimit në Dibër – mermer, gëlqerorë të mermerizuar, kuarcite etj., për mineralet industriale – talk, asbest, grafit etj., për lëndët e para kimike – bojëra dheu, shtuf etj. Po kaq skrupuloz është katalogu i burimeve ujore për shtatë plansheta kryesore të Dibrës: mali i Korabit, Sllova, Maqellara, Peshkopia, Selishta, Fushë-Muhurri, Fushë-Çidhna. Një punë kolosale, kaq sistemore. Dhe atëherë, mund të thuash bindshëm, që profesor Veseli ka qenë po kaq sistematik e skrupuloz në punën kërkimore në terren e në punën kërkimore-shkencore në kabinet.

Tani, një si parantezë: Inxhinieri flet për naftë në Dibër. M'u kujtua ai pylli i vulfeve që ulen e ngrihen ditë e natë në Patos, Marinëz e gjetiu. Pse, a thua mund të ndodhë kjo edhe te Përroi i Gramës? Sa mirë do të ishte! Autori i librit, profesor Vesel Hoxha, përmend edhe kontributin e dy inxhinierëve rusë për kërkimin e naftës në Dibër. Unë mbaj mend që ata dy inxhinierët kanë mbajtur një leksion në shkollën pedagogjike për ato kërkime te Përroi i Gramës, në Dypjakë. Duhet të ketë qenë viti 1958 ose 1957. Në mensën e madhe të shkollës. Kam qenë nxënës. Po ta kisha dëgjuar me vëmendje atë leksion dhe po të kisha lexuar një libër si ky i profesor Veselit, do të kisha kërkuar t'i vijoja studimet e larta për gjeologji.

Gjeologjia hyn te shkencat e tokës. Brenda këtij koncepti, na u duk shumë interesant dhe shumë formues kreu "Rreziku gjeologjik" në Dibër, me rreth 30 çështje e nënçështje. Shih, p.sh., *Rreziqet gjeologjike; Rreziqet gjeologjike natyrore; Tërmetet; Përmbytjet: Rreziqet ortekore; Erozioni; Rrezatimet; Kanionet; Punimet e braktisura; Rrëzimet / Shembjet / Rrëshqitjet; Rezervuarët dhe liqenet; Ujërat e ndotur nëntokësorë; Mbetjet urbane etj*.

Inxhinieri ka përshkruar 54 vendrrëshqitje: me koordinata e fotografime. Ky studim pasohet nga një listë me 27 emërtime rrëshqitjesh, të studiuara me kërkesë të njësive administrative vendore dhe 84 rrëshqitje të vrojtuara në suazën e studimeve në vitet 2004-2005 dhe 2009-2016. Për ortekët (rrungajat, rreshpet) inxhinieri jep një listë me 37 vende në Dibër. Dhe na thotë fare qartë pse ndodhin ortekët, cila është mundësia (probabiliteti) e rënies së tyre dhe indirekt – si të ruhemi.

Inxhinieri, profesor Veseli, shkruan edhe për shfrytëzimin pa kriter të inerteve, edhe për gërryerjen (erozionin) e tokave, edhe për ndërtimin e veprave hidroteknike në sipërfaqe karstike, edhe për hinka tokësore, gropa e gropore, lugje e lugina, edhe për kepa e shkrepa, edhe për shpellat (përshkruan mbi 20 të tilla), edhe për mineralizimet radioaktive, edhe për kanionet (përshkruan 8 të tilla në Dibër), edhe për punimet e braktisura (dhe numëron 60 të tilla), edhe për ujërat e pijshëm (menaxhimin e tyre e mosndotjen e tyre / 41 burime përmend), edhe për disa ujëra nëntokësorë me agresivitet sulfatesh. Në hartën e rrezikut gjeologjik janë edhe 41 liqene dhe 26 ujëmbledhës artificialë. Rreziqet teknogjene, domethënë, ato që vijnë nga veprimtaria njerëzore jepen thukët, por me shumë vëmendje. Autori nuk mjaftohet vetëm me shpjegimet e argumentimet shkencore për rreziqet gjeologjike në Dibër (e si model – edhe gjetiu), por jep edhe një varg hartash për to dhe një shpjegues me shenjime për to. Me këto, autori e ka kryer edhe detyrën për t'i mësuar të tjerët të vetëruhen.

Besojmë, edhe autori i librit, edhe lexuesi ma lejojnë një parantezë të dytë: Për rreziqet nga rrëshqitjet e tokës, autori përmend Përroin e Botës në fshatin Vleshë (njësia administrative – Sllovë) dhe Tallamazin e Shullanit (njësia administrative – Kala e Dodës). E para është në fshatin tim. E dyta – përballë fshatit tim. Në Përrue të Botës (e tregon edhe vetë emërtimi) ka botë, një lloj deltine e përhime në të bardhë. Përdorej për të lyer muret e shtëpive dhe për të bërë çerepë. Në pranverën e vonë, në ditë të caktuara, Përroi i Botës gëlonte nga njerëzit – jo vetëm të fshatit Vleshë, por edhe të fshatrave përreth. Tani nuk shkojnë. Tani

ka gëlqere. Edhe unë kam parë rrëshqitje te ky vend. Rrëshqitja tjetër, që përmendet në libër, është Tallamazi. Tallamazi, - thoshin baballarët tanë, - ka qenë katund aq i madh, me aq shumë shtëpi, sa macja kalonte çati më çati. Ai katund nuk ekziston. Tani duket si një krater, po ta shikosh nga lart.

Kreu i tretë i librit vijon me *Monumentet e natyrës në bashkinë e Dibrës,* me 33 faqe. Me përshkrimet, me fotot me ngjyra e visoret (peizazhet), me thënien lapidare "Historia e tokës nuk është më pak e rëndësishme se historia njerëzore", të josh të nisesh që nesër për t'i parë e për t'i kundruar ato vise, për të ecur aty e për të mbushur mushkëritë me atë ajër të freskët. Janë monumente e parqe natyrore, vërtet të lakmueshme për çdo dashatar të natyrës. Shihni, p.sh., foton e aloktonit të Gramës dhe do të bindeni për këtë. Aloktoni i Gramës, siç thotë autori, është një dukuri e rrallë, me vlera unike rajonale dhe botërore. Aloktoni është depozitim i formuar larg pozicionit të sotëm. Dhe duket sikur është "rimbjellë" aty. Inxhinier Veseli e ka fotografuar. Ai është shumë vëzhgimtar, jo vetëm i kokrrizave të gurëve xeherorë, por edhe i shkëmbinjve dhe i hapësirave të mëdha. Përveçse vëzhgimtar, inxhinieri është i përpiktë në gjithçka që përshkruan. Prandaj jep gjithandej koordinatat hapësinore. Kjo pjesë e librit e meriton të ribotohet si libër më vete. Dhe të tjerët do të njohin edhe Dibrën turistike.

Le të kthehemi te fillimi i librit, te kreu i parë. Po të bënim një si përveçim kapitujsh, do të thoshim: Kreu i parë (stratigrafia, magmatizmi, metamorfizmi, tektonika, neotektonika, evolucioni paleogjeografik etj.) është për shkencëtarët; kreu i dytë – për gjeologët: studimor e udhërrëfyes; kreu i tretë – për të gjithë ne qytetarët. Të tre krerët janë të lidhur fort njëri me tjetrin, siç lidhet pjesa me të tërën.

Libri "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës" është një studim i shquar kërkimor-shkencor. Dijetarët gjeologë dhe profesionistët gjeologë mund të përveçojnë argumentet shkencore, formulat shkencore, shpjegimet e përkufizimet shkencore, grafikët e diagramet, skicat e vizatimet teknike, hartat topografike e hartat gjeologjike, përfundimet shkencore dhe literaturën shumë të pasur shkencore (rreth 180 vepra e studime vetëm për temën « Stratigrafia, magmatizmi, tektonika »; lexuesi i kualifikuar mund ta shohë vetë literaturën shkencore në fund të çdo çështjeje e nënçështjeje). Kurse ne jospecialistët e joprofesionistët mund të përveçojmë shpjegimet shkencore-popullarizuese për zëra e nënzëra të veçantë, fotot ilustruese, vizën e kuqe, të bardhë ose të zezë të stilolapsit të inxhinierit (shih, p.sh., f. 56-59) mbi hartën, vizatimin, skicën a foton shkencore, që na tregon se deri ku shkon aksh dukuri, proces, gjetje nëntokësore etj. Për ne, jospecialistët e joprofesionistët, vija e kuqe mbi një pamje të gjelbër ose vija e zezë mbi gurë e shkëmbinj është thënia më e saktë e më e qartë shkencore. Fotot. Fotot shkojnë një me një me tekstin shkencor. Ato janë me mbushulli, si një album shumë i këndshëm. Po kaq pa kursim janë edhe ilustrimet e tjera (shih, p.sh., f. 334-344), të cilat mund të barabiten me vetë tekstin.

Libri "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës" na gëzon fort, sepse mësojmë ç'pasuri kemi nën këmbët tona. Më shumë se kaq, na mëson si është toka poshtë nesh. Ne nuk na ka shkuar ndonjëherë ndër mend ta dimë si është, p.sh., toka Arras – Draj-Reç. Na e thonë ato vijat rrushkulluese në hartën

BURIMI I UJIT TË FTOHTË NË FSHATIN VLESHË

(Koordinatat: 41° 48′ 13″ Veri, 20° 25′ 51″ Lindje).

Ky burim gjëndet pranë fshatit Vleshë, 800 - 830 m mbi nivelin e detit dhe 800 m në jug të tij. Kur udhëton nga Peshkopia për në Kala të Dodës, 500 m pa vajtur në Vleshë, tek Përroi i Mullirit, në krahun e djathtë rreth 300 m larg ndodhet burimi në fjalë. Ai del prej formacionit gjipsor, kryesisht i lloit gjips - anhidrit me ndërmjetësime lentore dolomitesh dhe materiali organik të përzier me atë argjilor me ngjyrë të murrme në të zezë. Sipas studimit (Hoxha, 2001) ky është një burim tipik i lloit karstik në formacionin evaporitik të gjipseve në Njësinë e Dibrës, që mendohen si pjesë e Zonës tektonike të Krujës. Me prurjet e tij të mëdha, ujin e pastër dhe shumë të ftohtë, burimi krijon mjedis tërheqës me vlera shkencore hidrogjeologjike, didaktike, gjeoturistike dhe mjeksore, në shërimin e disa sëmundjeve, kryesisht atyre reumatizmale (Fig. 24/m).





Fig. 24/m. Nga dy pamje në kohë të ndryshme nga Burimi i Ujit të Ftohtë në Vleshë. Në dy fotot anësore mund të dallohen gjipset, anhidritet si dhe ndërfutjet e dolomiteve bashkë më formacionet e imta argjilo - ranorë me lëndë organike dhe një trashësi e vogël e deluvioneve të shpatit. ku del dhe burimi karstik evaporitik.

Vesel Hoxha, *Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës*, f. 551

formacionore. Ne nuk e kemi ditur sa e vjetër është toka e Dibrës. Na e thotë shkencërisht qartë studimi i prof. Veselit: "Moshat e relievit të Dibrës". Ja edhe një shembull i thjeshtë: Kemi parë gjipse, kemi shkelur mbi gjipse, kemi zbukuruar me gjips çatitë me tjegulla të kuqe, por nuk kemi parë imazhe gjipsi. Një skulptor a piktor do të nxitonte shumë t'i shihte. Libri na mëson e na bën gjeologë edhe ne të tjerëve. Dhe, për ta përmbyllur, për arsye shkurtësie vlerësimin tonë për librin, themi se ai është për të gjithë ne – për më të diturit dhe për më pak të diturit – sigurisht, sipas leximit të secilit.

Pasi të shihte Sarokolin në fotot e librit, një turist do të donte të ishte vetë mu aty te maja e tij. Edhe një speleolog (studiues i shpellave) do të shpejtonte për te shpellat. Hidrogjeologu e hidrotekniku – te rrjedhat ujore, ujërat minerale dhe ujëvarat. E, përpara këtyre, me siguri ata që do të shpejtonin për te Libri dhe te Dibra, do të ishin mineralologu, gjeodezisti e specialisti i gjeologjisë.

Libri është shumë i vlefshëm për kryebashkiakët e Peshkopisë dhe të Bulqizës, për të gjithë drejtuesit e njësive administrative vendore, për ndërtuesit, investitorët e biznesmenët, për të mbarështuar truallin që duan të administrojnë.

Në libër është një kapitull me rreth 130 faqe, "Rreziku gjeologjik i Dibrës". Dhe ai u thotë të gjithëve këtyre e na thotë ne të gjithëve: Kujdes! Këtu – po!; atje – jo! Mbase, ky kapitull, po e përsërisim thënien, mund të ribotohet veçmas si libër, për të qenë në tryezat e punës te mjedisorët (ambientalistët) e dashatarët e tokës, për ta shtuar respektin dhe kujdesin që meriton toka.

Libri është për gjeografët e hartografët. Libri është për studiuesit në fushën e gjeologjisë dhe të minierave. Është për studentët e gjeologjisë e të minierave dhe për studentët e gjeografisë. Libri është për mësuesit e gjeografisë, për t'i shtuar shumë dijet e tyre. Libri është për gjeologë e studiues të huaj. A mund të përkthehet? Sigurisht. Të paktën, pjesë të tij.

Libri është për toponimistët, për ata që merren me toponime. Toponimia është shkenca që merret me emrat e vendeve. Tek ato, sidomos te minitoponimet, rrojnë gjuha, historia e gjuhës, etimologjia e gjuhës, historia e kombit, historia e krahinës, arkeologjia e krahinës, bëmat e krahinës, e folmja e krahinës, fjalë të vjetra a të vjetruara, tiparet topografike, bota bimore e bota shtazore, etnobotanika, etnozoologjia, etnopsikologjia etj. Shpesh, tek emërtimet e vendeve mund të shihet edhe njësia (uniteti) e gjuhës (krahaso., p.sh., *Gramë* në Dibër e *Gramë* në Karaburun; *Mëzeze* në Dibër e *Mëzez* në Tiranë, *Rrenz* në Dibër e *Rrenz* në Shkodër). Për shumë arsye – historike, mjedisore, ndërtimore, demografike etj., emri i një vendi mund të harrohet a edhe të humbasë. Kësisoj, është detyrë e ngutshme mbledhja dhe regjistrimi i toponimeve (emërvendeve) të Dibrës.

Në librin e prof. Veselit, çdo vend jepet me koordinata absolute topografike. Dhe koordinatës nuk mund të mos i paraprijë emri i vendit. Janë me qindra emra vendesh (shih, p.sh.,: Breg, Bufëll, Çelias, Gramë, G(j)urrë-Reç, Fushë-Shtrungëz, Kësulë-Lurë, Krejë-Lurë, Lanë-Lurë, Arras, Kullas, Ujëmirë, Setë, Sopanikë, Gjelagjosh, Kacni, Luzni, Pasqyrë, Rreshke, Ponair, Bokase, Shpellas, Shëllinas, Tejz, Shum(b)at, Dipjakë (= Dypjakë), Vajmëdhej, Vorri i Sejmenit etj.) – një pasuri shumë e vlefshme për toponiminë e Dibrës. Dikush që ka ndezëlli (zell) për të qëmtuar e regjistruar toponimet e Dibrës, mund ta vjelë me ëndje librin e profesor Veselit.

Libri i prof. Veselit kontribuon shumë për terminologjinë e gjeologjisë dhe të minierave. Terminologjia është tërësia e termave të një fushe të shkencës. Termi është fjala për një koncept shkencor. Koncepti paraekziston. Ai prodhon termin. Termi jepet me fjalë a togfjalësh. Mbetet zgjedhja e termit, domethënë, e fjalës a e togfjalëshit. Dhe kriteri themelor për zgjedhjen e një termi është që ai ta japë të saktë konceptin. Besojmë që në pjesën më të madhe, konceptet e gjeologjisë dhe të minierave janë ndërkombëtare, domethënë, të gjithëpranuara. Dhe autori, ish-punonjësi shkencor në Institutin e Gjeoshkencave, njëherësh – pedagog në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, i sjell gjuhëtarit terminologjinë e gjeologjisë. Themi kështu sepse i kemi parë termat e librit edhe në rrafshin konceptor, edhe në rrafshin gjuhësor, strukturor-fjalëformues. Ata janë ndërtuar sipas tipave fjalëformues e gjedheve fjalëformuese të gjuhës shqipe standarde; shih, p.sh., *mineralmbajtës (si naftëmbajtës), magmatizëm, nënzonë, mineralizim, metalor: mineral metalor, mineralogjik, gropore, mbulesor, ujor: burime ujore, hartografim, trajtesë, zjarrdurueshmëri etj*.

Gjeologjia dhe miniera janë edhe fushë dijeje, edhe veprimtari praktike. Kjo do të thotë që për arsye të përdorimit të përditshëm, termat mund të kalojnë në përdorim të përgjithshëm, siç ka ndodhur, p.sh., me terma të fushave të tjera: *hekurbeton, hekzaklorant, automobilizëm etj*. Dhe, kur hyjnë në përdorim të përgjithshëm, termat sjellin dije e qytetërim. Këtej vjen edhe një vlerë tjetër e librit të prof. Veselit. Profesor Veseli e ka bërë shqipen « gjuhë gjeologjike ». Ai i shkruan dhe i përdor drejt fjalët dhe termat. Ai nuk e bën, p.sh., gabimin e shumë vetave që gjips ta shkruajë me g. Besojmë që terma të tillë të librit, si, *hartografim, mineralogjik, mbulesor etj*. do të përfshihen edhe në Fjalorin e Madh të gjuhës shqipe, që pritet të përfundojë nga fundi i vitit 2023.

Fjala e vyer e inxhinier Veselit na vjen në libër edhe si një sintezë te sythi Koment. Është një sintezë gjithë dije e peshë. Shumë e këndshme për lexuesin. Shumë e vlefshme për specialistin.

Libri është i bukur edhe me formatin e pamjen e tij. Ai i zbukuron raftet e bibliotekave tona. Po të paraqitej për konkurrim për librin më të mirë të vitit, me siguri do të zinte vendin e parë në llojin e tij. Është vepër madhore.




Fig. 14. Pjesë nga Harta e Rrezikut Gjeologjik të Bashkisë Dibër, rajoni i Reçit, në shkallë 1:50 000

Rruga e Arbërit nr. 198

Kultura e Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, është formuar nga bashkëjetesa e komponentit indigjen eneolitik të tipit Maliq II dhe atij badeno-kostolacas dhe komponentit migracionar anatolik, të ardhur nga impulset kulturore të fillimit të kësaj periudhe nga juglindja, duke filluar nga Anatolia, në vijën Anatoli-Thraki-Maqedoni Egjeane-Thesali-Pelagoni dhe pjesërisht nga areali Karpato-Danubian i Bronzit të Hershëm. Elementët e rrallë "kurgan" të pranishëm në këtë kulturë, janë thjeshtë dhe vetëm refleks i infiltrimeve dhe influencave kulturore të transmetuara gjatë shkëmbimeve ekonomiko-tregëtare.

Rivlerësimi i hipotezës së migracionit "kurgan" sipas evidencës arkeologjike nga Shqipëria dhe Kosova

(Vijon nga faqja 11)

Hipoteza e migracionit anatolian, rezulton më e argumentuar se hipoteza e kundërt, prandaj parashtrimi i saj, qoftë edhe si një hipotezë pune, ndihmon në sqarimin e procesit gjenetizues të popullsisë ilire. Ky artikull shënon fillimin e një pune të gjatë, që përveç trajtimit të dukurive arkeologjike, kërkon të plotësohet edhe me një seri të plotë datash radiokarbonike të të gjithë kulturave tona të Bronzit të Hershëm, me analizat antropologjike, spektometrike dhe gjenetike të materialit skeletor, me analizat kimike dhe spektromagnetike të veglave të punës dhe armëve prej bronzi, me rivlerësimin e florës dhe të fuanës dhe në përgjithësi të mjedisit bio-ekonomik të kësaj periudhe, që shpresojmë ta sjellin kërkimet e ardhshme.

të rajonit të Dubrovnikut në Dalmaci[168]. Është rasti të shprehemi se numri i kufizuar i fragmenteve të qeramikës së tipit *schnur, pseudo-schnur* apo *corded ware*, të përmendur më lart, i duhen referuar më tepër ndikimeve të kësaj kulture nga Europa Qëndrore, ku është atdheu origjinar i saj[169], se sa prurjeve të Yamna kulturës, ku qeramika e tipit *schnur* nuk është aq karakteristike[170]. Ndërkaq inventari i tipit "kurgan" në varret qëndror të tumave është mjaft i rrallë dhe përfaqësohet nga një majë shigjete stralli (Piskovë) si dhe një thikë stralli (Shkrel, tuma III). Kjo evidencë përmban gjithashtu të dhëna të vlefshme, që ndihmojnë për të kuptuar më mirë në se elementët "kurganë" të ndeshur kryesisht në kulturën tumulare, janë dëshmi e "migracionit" kurgan apo e difuzionit kulturor të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga zona stepike.

1. Në Shqipëri janë zbuluar 24 tuma, 6 në Shqipërinë Jugore dhe 18 në atë Veriore, varret qëndrore të të cilave janë datuar në bronzin e hershëm. Asnjë të dhënë të sigurtë nuk ka deri tani për shfaqjen e tyre gjatë Eneolitit.[171] Ndërkaq në Kosovë aktualisht kësaj periudhe besojmë se i takojnë varri qëndror i tumës së Rogovës (Fushe), ai i Banjicës së Pejës dhe varri qëndror i tumës së Lubozhdës së Istogut**.** Në tumat e Shqipërisë së Jugut përdoret inhumacioni, në varre të tipit me gropë nën taban të tipit pitgrave, pavarësisht nga disa specifika lokale në konceptimin e tyre arkitektonik (Pazhok, Piskovë, Cerrujë, Dukat)[172], ndërsa varri qëndror i tumës I të Barçit, i zbuluar midis murranës së gurëve, nuk është qartë i përcaktuar[173]. Në tumat e Shqipërisë Veriore, kronologjikisht të lidhura me fazën e dytë të Bronzit të Hershëm, përdoret si inhumacioni (tuma VI e Shtojit, tuma X e Çinamakut, tuma IV e Kënetës) ashtu edhe kremacioni (Shkrel)[174]. Ndërkaq, në tumën X të Çinamakut është përfaqësuar varrimi me urnë, shembulli deri tani më i hershëm i këtij tipi varrimi në Shqipëri [175], ndërsa tumat VII-VIII të Bujanit (Tropojë) kanë thjesht karakter përkujtimor (kenotaf)[176]. Edhe në tri tumat e konsideruara si të Bronzit të Hershëm në Kosovë, përdoret inhumacioni, në varre të tipit me gropë nën taban (pitgrave) dhe skelete të vendosura në shpinë me këmbë të përthyera djathtas ose majtas. Elementë të tjerë "kurgan", si shoqërimi i varrit qëndror nga një bukranion kau dhe flijimi i një kafshe tjetër dhe vendosja e tyre brenda varrit (Pazhok), apo jashtë tij (Dukat, Shtoj) dhe në ndonjë rast edhe mbi varrin qëndror (Apolloni-tuma X)[177], përdorimi i okrës në dheun e dyshemesë dhe kafkën e skeletit (Piskovë), janë mjaft të rrallë, dhe aspak karakteristikë për ritualin tumular të kësaj periudhe në Shqipëri. Sipas Gimbutas, kuajt dhe buajt (qetë) ishin shumë të rëndësishëm për popullsinë kurgane, pasi "*kuajt përdoreshin për udhëtime dhe luftra"* dhe *"buajt (qetë) për plugime dhe tërheqje të karrocës"*[178]. Kjo është e vërtetë, ashtu siç është i vërtetë dhe pohimi se kuajt dhe buajt ishin të rëndësishëm jo vetëm për tributë kurgane, por për të gjithë komunitetet agrikulturore dhe pastorale kudo në botën Eneolitike dhe atë të Bronzit të Hershëm. Ndërkaq mungojnë elementë të tjerë të inventarit tipik "kurgan" të përbërë nga thika të gjata stralli, majë shigjete stralli me fletë trekëndëshe, varëse prej dhëmbë elefanti ose derri të egër, sëpatë guri me kokë të rrumbullakët, topuz guri kryqiform, spektri, figurina të kokës së kalit, figurina antropomorfe meshkujsh dhe simboli i phallosit si dhe karroca me rrota, nuk ndeshen në tumat e Shqipërisë. Karakteri sporadik i elementëve "kurgan", i klasifikon ata si të transmetuar nëpërmjet difuzionit kulturor dhe shkëmbimeve ekonomiko-tregëtare me kulturat fqinje, dhe jo si të ardhur me rrugë migratore. Nga ana tjetër, duhet theksuar se ka një diferencë të dukshme në madhësinë dhe monumentalitetin e tumave midis Shqipërisë së Jugut dhe asaj të Veriut. Mendojmë se kjo është refelks i diferencës në zhvillimin ekonomik dhe i potencialit të ndryshëm të aristokracisë ushtarake lokale të të dy rajoneve, ose duhet shpjeguar me një formë më të organizuar shoqërore dhe ushtarake të popullsisë së Shqipërisë së Jugut kundrejt asaj të Shqipërisë së Veriut.

2. Në shtresën Maliq IIIa, janë zbuluar 6 skelete adoleshentësh, 5 prej të cilëve në pozicion fjetje në njërin krahë dhe këmbë të përthyera të traditës eneolitike lokale (*hocker*) dhe vetëm një në pozicionin në shpinë me këmbë të përthyera dhe të rëna djathtas ose majtas të stilit "kurgan"[179] (*rombstellungen*), gjë që flet për ruajtjen e traditës indigjene të kulturës shpirtërore, e rjedhimisht edhe të bartësve të kësaj kulture. Po kështu qeramika e shtresës së Bronzit të Hershëm në vendbanimin shpellor të Benjës, gërsheton elementët karakteristikë eneolitik siç është qeramika fine me lustër të zezë me dekorin pseudobarbotin,tipik për Bronzin e Hershëm, shpesh të kombinuara në të njëjtën enë[180], gjë që flet për bashkëjetesë paqësore të bartësve të kulturës autoktone eneolitike dhe atyre të kulturës migracionare të Bronzit të Hershëm.

3. Të dhënat antropologjike mbi praninë e popullsisë me prejardhje stepike në këtë periudhë janë mjaft të pakta e sporadike. Vetëm dy skelete të varreve qëndrore të tumës së Piskovës (varri nr. 116, tuma I)[181] dhe asaj të Dukatit (varri nr. 53, tuma II)[182], përfaqësojnë tipin antropologjik protoevropoid, me dy përbërës, kromanoid në Piskovë dhe protonordik në Dukat[183], që do të mund të lidheshin me popullsinë kurgane, janë të pamjaftueshëm për të arritur në përfundimin se territori ynë u pushtua nga dyndjet kurgane, fakt i konstatuar më parë nga autori i gërmimeve N. Bodinaku[184]. Gjithashtu, mosha e tyre e pjekur dhe mosshoqërimi i tyre me gra dhe fëmijë me tipare të njëjta antropologjike, na lejon për të supozuar se ata mund të kenë ardhur këtu edhe si tregëtarë kurganë të mbetur dhe të varrosur në vend të huaj. Raste anaolge janë konstatuar edhe në Rrafshinën Hungareze[185], ku gjithashtu kundërshtohet hipoteza kurgane.

4. Një nga kontradiktat serioze të hipotezës së migracionit kurgan është padyshim ajo që lidhet me kronologjinë. Vala III e dyndjes "kurgane" e njohur edhe si migracion i bartësve të kulturës së tipit "pit grave " ose "Kurgan" IV, është datuar në vitet 3100-2900 para Kr.(cal)[186]. Ndërkaq, ndërsa shtresa Maliq IIIa, kur shënohen fillimet Bronzit të Hershëm në Shqipëri, do të duhej avancuar të paktën deri rreth viteve 3000 para Kr.(cal), që do të përputhej me ProtoHelladikun e Hershëm III sipas kronologjisë egjeane. Kjo ngritje e kronologjisë absolute bazohet në datat e reja radiokarbonike të Bronzit të Hershëm të përftuara në Sovjan me kulturë identike me atë Maliq IIIa, sipas të cilave data 2650 para Kr. (cal) shënon kufirin midis Bronzit të Hershëm dhe atij të Mesëm[187]. Ndërkaq, datat radiokarbonike të fituara nga vendbanimi i Bornzit të Hershëm në Vreshtas të pellgut të Korçës, me kulturë identike me atë Maliq IIIa, sillen rreth viteve 3000 para Kr.(cal), gjë që e bën atë të njëkohshme me kulturën "Kurgan" IV të Kaukazit Verior. Në Vreshtas janë realizuar dy datime radiokarbonike në dy nivele të ndryshme të shtresës kulturore të Bronzit të Hershëm, që kanë dhënë datat absolute 3332-2916 para Kr.(cal) dhe 3078-2883 vjet para Kr.(cal)[188]. Nga ana tjetër, rezultatet e fituara nga datimi i mbetjeve skeletore të varrit qëndror të tumës X të Apollonisë me AMS (kocka, dhëmbë molarë dhe premolarë) kanë dhënë një datë të përafërt midis 2852-2505 para Kr. (cal) dhe 2580-2475 para Kr. (cal)[189]. Datimi radiokarbonik i Bronzit të Hershëm në Sovjan dhe në Vreshtas rreth 3000 para Kr.(cal) e vendosin Bronzin e Hershëm të pellgut të Korçës në lidhje kronologjike me Anatolianin e Hershëm IIa (3400-3100 para Kr. (cal)[190], fazën I-II të Bronzit të Hershëm Sitagroi IV (faza e hershme) (3380/3350 para Kr.(cal), Sitagroi IV (faza e vonë) (3010-2680 para Kr.(cal)[191], Eutresis (3300-2900 para Kr.(cal), fazën I-II të Bronzit të Hershëm në Dikili-Tash[192], Ezero XIII (3340-2930 para Kr.(cal)[193], Troy I (2920-2630 para Kr.(cal)[194]etj. Atëherë, matematikisht, a mund të pranohet hipoteza e migracionit kurgan, kur datat e Bronzit të Hershëm në Shqipëri, janë të njëjta me datat e të njëjtës periudhë në stepat veripontike dhe kaukaziane, ku ka qenë djepi i Yamna kulturës?[195]. Gjithashtu, sipas teorisë difusioniste *"wave in advance"* të A. Ammerman- L. Cavalli-Sforza, moduli i shpejtësisë së lëvizjes së një tribuje prehistorike nga pika A në pikën B është 1 km/vit. Pra, për të përshkuar një distancë mbi 2500 km, që ndan Kaukazin Verior nga Shqipëria, do të duheshin mbi 2500 vjet, dhe i bie që kulturat tona të Bronzit të Hershëm do të duhej të datoheshin rreth 2500 vjet më vonë nga kultura e tipit "kurgan"!. Edhe në qoftëse e dhjetëfishojmë modulin e shpejtësisë së lëvizjes me 10km /vit, përsëri ardhja nga stepat e Kaukazit Verior deri në Shqipëri kërkon të paktën kohën prej nga 250 vjetësh, e barabartë me jetën e 10 gjeneratave njerëzore, mirëpo edhe kjo diferencë kronologjike, nga datat e reja radiokarbonike të kulturave të Bronzit të Hershëm më Shqipëri, rezulton e papranueshme.

5. Studimet arkeologjike në Kosovë kanë dëshmuar se mbarimi i kulturës së Vinçës shënohet nga shfaqja e qeramikës badeno-kostolacase dhe bartësve kulturor të grupit Badeno-Kostolac, ndërsa kultura e Bronzit të Hershëm është formuar nga kultura e periudhës së hershme të bronzit maqedonas me origjinë anatolike[196]. Orientimi i qartë i kulturës së Bronzit të Hershëm në Kosovë nga Bronzi i Hershëm pelagonas, ai i Maqedonisë Egjeane dhe Anatolia është mbështetur edhe nga studimet e kohëve të fundit, të kryera në Kosovë[197].

6. Qeramika e Bronzit të Hershëm në Shqipëri (kultura Maliq IIIa-b) dhe Kosovë (Hisar IIIa, Vlashnje IVa, Karagaç II, Glladnicë III, Gadime e Epërme III), si nga format ashtu edhe nga dekori, siç u përmend gjatë analizës kulturore, nuk ka asnjë lidhje me qeramikën tipike kurgane, e cila karakterizohet nga forma kryesisht sferike, mungesa e vegjëve dhe ornamente të thjeshta të inçizuara[198]. Nga ana tjetër, ajo është shumë e ngjashme me qeramikën e grupit Bubanj Hum III, Armenohori, Thesalikut të Hershëm III, Bronzit të Hershëm të Maqedonisë Egjeane, Thrakisë dhe atë të Anatolisë, ku duhet kërkuar edhe origjina e bartësve të saj. Ndërkaq prania a disa elementëve morfologjikë dhe dekorativ të kulturave eneolitike të vona danubiane të tipit Baden, Kocofen e Kostolac, në qeramikën e fazës fillestare të Bronzit të Hershëm në Maliq dhe në Nezir[199], është shprehje e difuzionit kulturor nga këto kultura.

Pas paraqitjes së mësipërme, arrijmë në përfundimin se kultura e Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, është formuar nga bashkëjetesa e komponentit indigjen eneolitik të tipit Maliq II dhe atij badeno-kostolacas dhe komponentit migracionar anatolik, të ardhur nga impulset kulturore të fillimit të kësaj periudhe nga juglindja, duke filluar nga Anatolia, në vijën Anatoli-Thraki-Maqedoni Egjeane-Thesali-Pelagoni dhe pjesërisht nga areali Karpato-Danubian i Bronzit të Hershëm. Elementët e rrallë "kurgan" të pranishëm në këtë kulturë, janë thjeshtë dhe vetëm refleks i infiltrimeve dhe influencave kulturore të transmetuara gjatë shkëmbimeve ekonomiko-tregëtare. Argumentet e mësipërme na shtyjnë të besojmë se hipoteza e migracionit anatolian, rezulton më e argumentuar se hipoteza e kundërt, prandaj parashtrimi i saj, qoftë edhe si një hipotezë pune, ndihmon në sqarimin e proçesit gjenetizues të popullsisë ilire. Ky artikull shënon fillimin e një pune të gjatë, që përveç trajtimit të dukurive arkeologjike, kërkon të plotësohet edhe me një seri të plotë datash radiokarbonike të të gjithë kulturave tona të Bronzit të Hershëm, me analizat antropologjike, spektometrike dhe gjenetike të materialit skeletor, me analizat kimike dhe spektromagnetike të veglave të punës dhe armëve prej bronzi, me rivlerësimin e florës dhe të fuanës dhe në përgjithësi të mjedisit bio-ekonomik të kësaj periudhe, që shpresojmë ta sjellin kërkimet e ardhshme.

Referencat e këtij studimi i gjeni në versionin e botimit online: rrugaearberit.com

kujtesë

Selman Karoshi, njeriu që u afirmua me punë e sakrifica



Në foto: Selman Karoshi me bashkëshorten, Sulltanen.

Nga DALI NOKA

Ashtë kënaqësi të shkruash për njerëz që i kanë dhanë familjes, vendit dhe shoqërisë.

Njeriut që jetoi gjithë jetën e tij si njeri me vlera dhe i përkushtuar, ndërroi jetë duke lënë gjurmë pas. Ky ishte Selman Karoshi!

Shumë vite që është nda nga ne, por ai jeton, në zemrat tona.

Ishte nji model në marrëdhëniet shoqërore. E ushqente shoqërinë me traditat e shkëlqyera që ka krahina e Çidhnës. Veçanërisht me frymën e patriotizmit, traditave e zakoneve të këtij vendi. Njihte dhe e transmetonte historinë e krahinës së Çidhnës, të Dibrës e mbarë vendit, kishte njohuri dhe për historinë e vendeve fqinje.

Selmani duhej të ishte i tillë se vinte nga nji familje e njohur në zonë. Të parët e tij njiheshin për virtytet e besnikërisë dhe besës, urtësisë dhe mikpritjes. Vëllai i tij i madh, Kadriu, ishte një burrë i matur, i urtë dhe Selmani kishte marrë prej tij durimin. Vendlindja e tij, fshati Fushë-Alie, fshati ku ka zhvillue veprimtarinë e tij plaku i nandë maleve të Dibrës, patrioti e luftëtari Salë Demiri, kishte ndikuar shumë në personalitetin e Selmanit. Ai ishte nipi i fisit të njohur Noka. Selmani nuk ishte vetëm nipi i gjithë fshatit Grykë Nokë por edhe më tej. Të gjithëve ju thërriste daja e halla.

Siç dihet se nipat vlerësohen sipas shkallës së njohjes: Nip vetëm i nji dere, nip i gjithë fisit, nip i gjithë fshatit.

Selmani i takonte njohjes së madhe! Që e njeh i gjithë katuni, krahina e më gjerë. Lidhja me masën e gjerë të popullit, e bani që të respektohej nga të gjithë. Ishte nji orator i vërtet, fliste me pasion. Lidhja me popullin e bani që të ketë reputacion. Emri i tij do të përmendej kudo në krahinën e Çidhnës. Shquhej për alegorinë e tij, ai bisedonte këndshëm me të gjitha moshat.

I hapej dera kudo që drejtohej pasi nuk e pengonte asgjë. E meritonte me çiltërsi pritjen, futej kudo edhe pa trokitur. Ishte i respektuar dhe respektohej nga të gjithë. Me dajat e tij mbante lidhje të ngushta por i vlerësonte edhe hallat. Në biseda ishte i qeshur dhe mue humor. Njëherë, ishte për drekë ishte te daja, ku pritet me shumë dashuri. Për të respektuar nipin, halla i kishte gatuar petulla me mjaltë. Sapo halla erdhi, nipi mori një petull në dorë me përmasa sa ishte fterja (tigani). I drejtohet hallës: Hallë e dashur, të dua shumë, të jap një porosi. - Kur të vdesim, unë edhe ti, të jemi në një varr. Me dhimbje halla i thotë: ti je i ri. Ai i thotë: Hallë në një varr, por mos harroni të na merrni fteren që të na bani petulla dhe atje.

Buzëqeshja ishte prezente, motiv i dajës e nipit. Nji ditë në drekë do të trokiste në derën e Mërsimit në fshatin Çidhën, ngjitur me fshatin Grykë-Nokë. Aty e pret me kënaqësi zonja e shtëpisë. Hallë shpejt bukë se kam nji punë të ngutshme. Halla atë që kishte, bukë misri e shëllirë, vjen djali pa e pyetur e i flet nanës: kështu e pret Selmanin? Nana i thotë: - bir i dashur, ai vetë më tha shpejt se kam punë. Selmani, duke qeshur, - si gjithmonë, i thotë: "Hallë, hallë unë nuk ta fsheha fteren".

Halla, duke qeshur, e merr fteren me gjalpë, e shkrin dhe e hedh në pjatën me gjizë dhe ja afroi në sofër. Kjo sepse në atë kohë vetëm një lopë kishim dhe buka e misrit ishte me racion. Pra çiltërsia e ushqen moralin.

Kur takonte njerëzit ai kishte një shprehje dashamirëse, vetëm për të qeshur!

Burrave, ju uronte ju rroftë gruaja, ndërsa grave ju uronte ju rroftë burri. Pasi e vlerësonte pamasë marrëdhënien bashkëshortore dhe familjen.

Ishte shumë arsimdashës. Këtë e përcillte te fëmijët e tij e të tjerët. Ja dy raste të jetuara.

Nji ditë merr në telefon sekretarin e përgjithshëm të partisë së rrethit, dhe i thotë: Djalin e madh dua ta shkolloj, por nuk më kanë dhanë të drejtë studimi! Ai e pyet se ku doni ta regjistroni djalin. Selmani i përgjigjet: Edhe shkollë qensh le të jetë, vetëm djali të mos më ngelet pa shkollë. Pas pak ditësh e njoftuan se djali do vazhdojë studimet në shkollën ushtarake. Ky lajm e gëzoi shumë, dhe na thirri për kafe. Unë në atë kohë ndiqja arsimin profesional pas pune në Peshkopi. Nji ditë dimri, sa dola tek porta e godinës, stepa. Ishte acar. Papritur më prekën dy duar mbi shpinë, më shtynë nga pas, ishte Selmani dhe reagoi: se je i ri, shkolla do ta sigurojë punën, vërtet ashtu ndodhi. Jeta asht luftë, lufta do mendje, u shpreh ai.

U ba i njohur në krahinën e Çidhnës. Me humor e kaloi jetën e tij! Fati e ndoqi pas ai pati njeriun e duhur si bashkeshorte. Sulltana vinte nga një familje e njohur ne Fushë-Alie siç ishtë Përnezha. Ishin me të vërtetë nji çift i lumtur, buzagaz e të përkushtuar për jetën. Rritën dhe edukuan plot 9 fëmijë, 7 djem dhe 2 vajza. Selmani krijoi nji rreth të gjerë shoqëror.

Ishte nga ata burra që ta hijeshonte konakun. Ai komunikonte rrjedhshëm me të gjitha moshat. Fjala e tij kishte peshë, brenda saj qendronte karakteri e sinqeritetit. Fliste si një orator i vërtetë, bisedat i mbyllte me humor, përdorte dhe alegorinë e Dibrës, kjo e bënte që fjala e tij të dëgjohej me kujdes. Ai porosiste: Ligjet e shtetit duhen zbatuar, por kujdes me popullin.

Selmani njihte dhimbje për fatkeqësitë e të tjerëve. Ishte i përkushtuar për të ba ma të mirën e duhur.

Humanizmin e kishte në shpirt. Ja si kishte vepruar në një rast konkret. Në dhjetorin e acartë të vitit 1968, nji udhëtar vinte nga Peshkopia drejt Kalisit të Kukësit. Nga të ftohtit, sapo kalon fshatin Fushë-Alie mbeti i pajetë. Sa mori vesh këtë lajm të hidhëruar, Selmani bashkë me bashkëfshataret e tij, nisen për në vendin e ngjarjes. Deshën ta varrosnin në vend, por Selmani e kundërshtoi duke argumentuar se këtu asht toka ime. Prandaj kjo kufomë e ka vendin tek varrezat e fshatit, pranë prindërve të mi.

Ishte ky burrë që mori përsipër të gjitha shpenzimet e varrimit, duke realizuar të gjitha ritet fetare deri tek Kurbani. Udhëtari u varros me nderime nga gjithë fshati Fushë-Alie. Ai kishte qenë Rexhep Sula nga fshati Bushtricë i Kukësit. Prej asaj kohe dy fëmijët mbajnë marrëdhënie vëllazërore.

Pra u bënë vëllezër *hatikati*, siç dihet se *hatikati* vlerësohet më shumë se gjaku. Selmani asht provuar si njeri i qëndresës para fatkeqësive. Në vitin 1972 do të përballon tragjedinë më të madhe për një prind. Vogëlushi 7-vjeçar bie në lumin Drin dhe nuk del i gjallë. Jo vetëm kaq, por dhe djali 16-vjeçar vdiq në klasën e mësimit nga një infarkt.

ARSIMI DHE DETYRAT QË KA KRYER.

Në vitin 1925 ka mbaruar 2 klasë fillore në shkollën Fuzë, në fshatin Arras. Me ndërhyrjen e dajës së tij, Haxhi Noka, u regjistrua në Internatin e Kastriotit me profesorë të dëgjuar, aty kreu 3 klasë. Në moshën 20 vjeç, pasi kreu shërbimin ushtarak, bani dy vjet shkollë ushtarake jashtë vendit. U kthye me gradën Aspirant. Meqenëse nuk pranoi pjesëmarrjen në luftën italo-greke, u burgos.

Pas largimit të Italisë, thyen burgun dhe bashkë me shokët e burgut, ju bashkuan Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Në vitin 1943, u kuadrua në brigadën 7, me gradën Kapiten i parë, në përpjekje me armikun asht plagosur gjatë betejës. Për merita të veçanta asht dekoruar me "Medaljen e Çlirimit".

Në vitin 1953, me një vendim të posaçëm, bashkë me shumë të tjerë u çmobilizua. Deri në vitin 1958 filloi punën si drejtor i të parës ndërmarrje shtetërore komunale në Peshkopi, ku pati rezultate mjaft të mira. Në vitin 1961 u transferua, sekretar lokalitetit në Fushë Alie, pasi u shkri rrethi. Në vitin 1965 punoi si Kryetar i Këshillit të Bashkuar të Kooperativës Bujqësore Fushë Alie. Në vitin 1968 ka fillue punën në zyrën P.T.T po në Fushë Çidhën. Këtu punoi më shumë përkushtim në shërbim të popullit, derisa doli në pension. Gjithnjë i përkushtuar në punë. Ai manifestonte virtytet më të mira, punoi për veten por edhe për shoqërinë, siç ka thënë edhe shkrimtari i madh Naim Frashëri: "Njeriu që për vete punon, asht si nji pemë që kokrra nuk lëshon"

Selmani ishte një pemë me kokrra. Krenar e mbylli jetën e tij. Krenar la pas fëmijët dhe gjithë të afërmit e tij. I mbylli sytë me 22 mars të vitit 1991 në moshën 74-vjeçare. U përcoll me nderime dhe pjesëmarrje të veçantë.



Hysen Puca *modeli i atdhetari në Grykën e Madhe*

Nga **ZABIT LLESHI**

Në gjysmën e parë të shekullit tetëmbëdhjetë nga Pusi i Thatë i Gjinajt të Hasit të Kukësit të parët e familjes Puca u larguan dhe u vendosën një vëlla në fshatin Gjegje të Kukësit, një në Venisht të Dibrës dhe ma i vogli erdhi në Godvi të Grykës së Madhe. Këtu lindi Hysen Puca më 8 mars 1903.Thirrej shkurt Cen dhe kështu njihej në rrethin e Dibrës, Mat e Martanesh. Babai Destan Puca u shqua në luftën për liri dhe pavarsi kundër perandorisë osmane, austriakëve (1916-198), serbëve (1913-1921), në luftën për demokraci (1922-1924) etj.

Në gjurmët e Destanit vazhduan traditën bijtë dhe nipërit e tij Ceni, Ademi, Mehmeti, Aliu, Ramizi, Rakipi. Në vitin 1922 kjo familje erdhi në Zall-Sopot. Patrioti Destan Puca ndërroi jetë në vitin 1931, pas tij Ceni u bë kryefamiljar. Megjithëse në moshë të re Ceni luftoi për krah babait kundër ushtrisë serbe, në lëvizjen e marsit 1922 si dhe në mbrojtje të revolucionit demokratiko-borgjez të vitit 1924. Ishte antizogist dhe luftoi kundër monarkisë gjatë sundimit të saj. Si çdo familje shqiptare edhe familja Puca e ndjeu peshën e shtypjes dhe shfrytëzimit nga qeveria e Zogut, bashkë me ato pas pushtimit fashist në 1939. Asnjëherë nuk u nënshtruan, përkundrazi luftuan me të gjitha format si protestat, kundërshtimi i pagesave të taksave e detyrimeve që rëndonin mbi kurrizin e fshatarsisë. Për shkak të gjendjes ekonomike, urrejtja ndaj regjimit monarkik rritej çdo ditë e më shumë, sidomos kur një bashkëvendas i Cen Pucës nga Godvia Hysen Ramadan Sula do të pushkatohej si pjesmarrës në kryengritjen e Fierit më 1935 si antifashist dhe kundërshtar i regjimit shtypës e anarkist të Ahmet Zogut.


Bashkë me vëllezërit me punë në bujqësi (Mehmeti dhe Aliu emigruan në Turqi), siguruan një ekonomi të qëndrueshme duke u shëndërruar në një familje të madhe mbi dyzet frymë dhe shumë kurorë. Ajo kishte një rreth të madh miqësor e shoqëror. Aty hynin e dilnin mysafirë, udhëtarë, hallexhinjësh të shumtë nga dy Dibrat, Golloborda, Mati, Luma e Martaneshi.

Një familje "minishtet" që drejtohej me mjeshtëri e zgjuarsi nga Cen Puca sipas një kodi moral, që ruajti për një kohë të gjatë unitetin, harmoninë vëllazërore për shumë breza deri në ditët e sotme.Një shembull i rrallë në Dibër, kjo sidomos pas çlirimit edhe në Shqipërinë e Veriut. Familja Puca kishte dhjetë hektar tokë, mullirin e saj, pasuri të konsiderueshme me pyje. Në vitin 1957 ndërtoi një central elektrik vetëm për familjen etj.

Me shumë vullnetarë nga Gryka e Madhe, veçanërisht nga Peladhia, Ceni u bashkua për të pritur me luftë ushtrinë italiane më 7 prill 1939 në Durrës. Erdhën në Burrel, nuk siguruan armë prandaj morën rrugën e Gurit të Bardhë, për të zbritur në Tiranë.

Në shkallën e Tujanit u takuan me dibranë që largoheshin drejt Dibrës sepse Italia kishte hyrë në kryeqytet. Të zhgënjyer u kthyen në fshat. Lajmi se dy dibranë kishin rënë heroikisht më 7 prill 1939 kishte marrë dhenë. Ramadan Velia nga Homeshi dhe Isak Metalia nga Strikçani ishin dëshmorët e parë antifashist. Ky akt heroik frymëzoi Cen Pucën me shumë vullnetarë antifashist në Grykën e madhe.

Më 1940 fshatarësia në Grykën e Madhe nuk pranoi të paguante taksat, kryesisht të dhjetat, nuk pranuan të visheshin milicë, që të shërbenin në milicinë fashiste. Kundërshtuan me forcë mobilizimin e ushtarëve për në frontin e luftës italo-greke. Midis puntorëve, kryesisht nga Gryka e Madhe që punonin në



Në foto: ***Hysen Puca***

rrugën Zerqan-Klos shpërthyen revolta ndaj sipërmarrësve italianë.

Përpjekjet e pushtuesve për ç'armatosjen edhe për shkak të rezistencës së popullsisë dështuan. Kjo situatë po shkonte drejt pikës së vlimit, nxorri militantët antifashsit në Grykën e Madhe e midis tyre shquhej Cen Puca. Shumë shpejt do të angazhoheshin në luftë kundër fashizmit, jo vetëm me propogandë por me veprime konkrete.

Haxhi Lleshi del ilegal në mars të vitit 1941 dhe përgaditet të presë me luftë Italinë fashiste më 6 prill, e cila sulmoi Jugosllavinë. Në Miresh dhe Bllatë forcat italiane përballen me forcat e Haxhi dhe Aqif Lleshit. Kjo bëri bujë të madhe në Dibër. Situata ishte shpërthyese. Cen Puca priste momentin. Haxhi Lleshi me familjen Puca kishin një miqësi të vjetër lidhur prej të parëve Halit Lleshi dhe Destan Puca dhe e kalitur në luftë. Në maj të vitit 1942, pas kthimit nga Peza(takoi Enver Hoxhën dhe Myslim Pezën), erdhi në familjen Puca. Gjeti vullnetin dhe gadishmërinë për të mbështetur pa rezerva luftën antifashiste. Këtu takoi Lym Zenelin, Hajdar Shehun, Hysen e Mustafa Cakallin, Elmaz Tonçin, Dullë Gjinin,Hamit Danin të cilët premtuan të bashkëpunonin me vullnetarët antifashistë dhe ashtu bënë deri në fund të luftës.

Shtëpia e Cenit kishte një pozicion shumë strategjik, siguronte lidhjet me fshatrat, afër malit,rrugës automobilistike, Peshkopi-Tiranë për strehim dhe vrojtim të lëvizjeve të ushtrive armike në çdo kohë. Ceni ka treguar trimëri qysh në aksionin e parë të çetës partizane të Dibrës tek gurët e Skënderbeut në Bulqizë më 26 qershor 1942, udhëhequr nga komandanti i çetës Haxhi Lleshi bashkë me atë tëMinierës së Bulqizës (16 shtator) udhëhequr nga Nazmi Rushiti. Me katër shokë Nazmi Rushiti nga shtëpia e Pucajve(aty u hartua plani për vrasjen e kapitenit fashist Stavri Jaho), doli për të realizuar atentatin më 27 shtator 1942. Vetë Ceni i kërkoi Nazmiut ta shoqëronte, por ai nuk pranoi me arsyetimin se mund të ketë pasoja si familje e madhe prej ushtrisë fashiste. Kjo familje priti çetën partizane të Dibrës, Grykës së Madhe, partizanë të shumë formacioneve të ushtrisë nacional-çlirimtare, italianë të dezertuar apo të zënë rob etj, midis tyre Haxhi Lleshin, Baba Fajën, Qazim Prishtinën, Zoi Themelin,Ahmet Jegenin,Sulë Bahollin, Spiro Velkon etj.

"Cen Puca më priti me zemër të hapur e me një bujari të jashtëzakonshme. Më caktuan partizanë të Grykës së Madhe nga 15 qershori i vitit 1943"-shkruan Kristo Frashëri në kujtimet e tij për luftën Nacional-çlirimtare. Aty vinin korier të çetave partizane, drejtues të luftës, të deleguar të partisë komuniste që lëviznin nga një krahinë në tjetrën. Strehoheshin të sëmurët dhe partizanë të plagosur, shpërndahej municion luftarak etj. E gjithë familje jetonte dhe ishte për ditë në kushte lufte. Cenit me antarët e tjerë të familjes do ti duhej të organizonte këto shërbime dhe ia dolën faqebardhë. Ai u kalit si i thonë fjalës në kudhrën e luftës, pa u shkëputur nga fronti i saj siç ishin ato ndaj depove të drithit në Smollik, në Ostren të Vogël, kundër postës së financës me 5 dhe 7 prill 1943. Atë ditë u prenë linjën telegrafike Dibra e Madhe-Zerqan-Peshkopi-Burrel-tek Ura e Çerenecit. Veprimet luftarake do të pasonin çlirimin e Zerqanit (3 gusht 1943), beteja e Sofraçanit më 23 gusht 1943, bashkë me atë të çlirimit të Peshkopisë, të Dibrës së Madhe. Në shumë beteja luftëtarët e Grykës së Madhe kanë qenë garant për fitoren me heroizmin e vetëmohimin, që kanë treguar ndaj pushtuesve italo-gjermanë, sidomos në mbrojtjen e Dibrës së Madhe prej ushtrisë gjermane ku u shquan Doktor Harito, Jashar Kola, Cen Puca, Myslim Shehu etj. Në një prej këtyre luftimeve vëllai, Ramiz Puca u plagos në Llazariopole të Maqedonisë.

Një ndihmë të konsiderueshme dha Ceni për ngritjen e këshillave Nacionaçlirimtarë. Në Sopot, në nëntor të vitit 1942 u zgjodh kryetar këshilli. Bashkë me kryetarët e tjerë të fshatrave siguruan lidhjet midis tyre por edhe me Grykën e Vogël, Bulqizën, Okshtunin, Gollobordën e Martaneshin.

I pa zëvëndësueshëm kontributi i grave të familjes Puca; Bibes, Xhemiles, Selvijes, Rabijes etj qysh në vitin 1941. Ato ishin prapavija, pritën, ushqyen, veshmbathën, u kujdesën për partizanë të sëmurë, të plagosur, shpesh herë bënë punën e korierëve, grumbulluan ndihma për luftën. Njëkohësisht luftuan për përmbysjen e botës së vjetër, kundër zakoneve prapanike e lindjen e një bote të re e përparimtare.

Pas çlirimit u zgjodh kryetar i Këshillit Krahinor të Zerqanit, shef i ekonomisë dhe pyjeve, kryetar i kooperativës bujqësore Sopot. Për një kohë të gjatë u zgjodh antar i Këshillit Popullor të rrethit dhe në kryesinë e veteranëve të luftës Nacionalçlirimtare të Dibrës.

Më 1974 erdhi me familje në Laç, vazhdoi të jetë aktiv me veteranët, pensionistët, të rinjtë. Nuk i humbi lidhjet me Dibrën e vendlindjen, përkundrazi u shtuan miqësitë dhe rrethi shoqëror. Cen Puca u martua me dy gra, lindi dhe rriti 18 fëmijë. Mbaruan shkollën e lartë gjashtë, të mesmen shtatë. Me punë dhe ndershmëri kanë shërbyer në bujqësi, mjekësi, në ushtri, në Dibër, Shkodër, Laç, Tiranë etj.

Më 18 janar 1988 Ceni ndërroi jetë, në moshën 85 vjeçare. Një njeri me personalitet, model në punë e në jetë, i drejtë, pa komplekse, gjithë jetën në shërbim të shoqërisë. Ashtu në heshtje, pa u ankuar asnjëherë, pa përfituar asgjë, tolerant dhe gjithnjë optimist. Jeta dhe vepra e patriotit Cen Puca është një model frymëzimi për të krijuar e ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe të ndershme, që çmon dijen, punën dhe moralin, lufton injorancën, vesin e pa drejtësinë.



homazh

Ishte një kohë me Ty!

Për babain e dajën tonë Lutfi Manjani!

Në muajt e fundit të klasës së katërt fillore, kur po e mbyllte me sukses, në klasë erdhi Selim Alliu, kryeinspektor i arsimit. Shkonte çdo fundviti nëpër shkolla dhe me shumë interes shënonte emrat e nxënësve më të mirë, pasi i'a tregonte mësuesi dhe ai vetë i testonte. Me një punë bindëse me prindërit, i tërhiqte në shkollën unike në Peshkopi. Pastaj i drejtonte për në pedagogjike dhe kur mbaronin, i orientonte për në universitet. Me prindërit e Lutit iu desh të fliste, sepse ai ishte fëmija i parë dhe ata ishin të vetëm. E vërejti për tre ditë dhe i ra në sy shkathtësia, zgjuarësia dhe dëshira për të vazhduar shkollën. Më vonë do t'a ndihmonte për në shkollën pedagogjike dhe në universitet. Selim Alliu do të ishte tifozi personal i tij më vonë,do t'a ndiqte në të gjitha ndeshjet brenda dhe jashtë rrethit kur mundej. Qe shumë krenar për të e arritjet që pati në jetë.



Filloi shkollën më 1947 në Peshkopi. Që në fillimet e tij, tërhoqi vëmendjen e mësuesve të fizkulturës për shkathtësinë dhe pasionin për sportin. Ishte ai pasion që do t'a shtynte drejt realizimit të një ëndërr ku e nisin me mijëra të rinj, futbollin. Në shkollë të mesme, ishte i padiskutueshëm afrimi me ekipin e Korabit, ku gjeti një klimë të mrekullueshme sportive, mes emrave të njohur si Musa e Rexhep Bardulla, Taxhedin Shehu, Islam Kosova, Atli Shehu, Bexhet Shehu, Esat Skuka, Musa Lala e shumë lojtarë të tjerë që vinin nga rrethet.

Ishte koha kur Korabi preku majat e suksesit e për 10 vite Luti do të ishte kapiten i skuadrës, ishte koha kur Korabi më 1960 do të jetë në kategorinë e parë, ishte koha kur tifozët Dibranë vinin në këmbë pothuaj nga të gjitha fshatrat për të parë ndeshjen, ishte koha kur të gjithë shkëlqyen e në mes tyre emri i nr.3, qendërmbrojtësit Lutfi Manjani mbeti në memorjen e tifozërisë dibrane.

I gjithanshëm, i përpiktë, në të gjitha sferat e jetës. Mbaroi shkollën dhe filloi mësues në Muhurr. Në këmbë nga Muhurri ndiqte stërvitjen në Peshkopi një vit. Punoi nëndrejtor konvikti në Peshkopi, një vit mësues në Shupenzë dhe pastaj për shumë vite ishte mësues në gjimnazin e Peshkopisë. Mësimdhënia dhe sporti qenë pjesë e jetës së tij, po ai dinte mrekullisht ku t'i ndante dhe ku t'i bashkonte me nxënësit. Ai mësues Luti i lojës së bukur në fushë dhe që u jepte aq kënaqësi, po aq serioz e kërkues ishte në orë të mësimit. Për shumë breza ishte mësuesi dhe edukatori që la pas vetëm të mirën. Urtësia me të cilën shpjegonte, korrigjonte fakte të vërteta, ishte ndër aftësitë e mëdha të tij. Kishte për zemër nxënësin punëtor. Qe koha kur diktatura kafshonte atë çka toka e jeta kishte më të shtrenjtë, të rinjtë. Për ata nxënës që mbanin padrejtësisht mbi shpatulla biografinë e familjes, fliste për t'a si për një mrekulli të vërtetë, kur tregonte sa të zgjuar ishin, për sakrificën që bënin, për padrejtësinë që u kishin thurur, edhe pse e dinin se nuk do i lejonin të vazhdonin studimet më lart. Vlerësonte të gjithë nxënësit që vinin nga larg, në këmbë, në borë e shi, për të vazhduar shkollën.

Për ne si fëmijë dhe nipër të tij, nuk ishte thjesht babai, daja e xhaxhai jonë. Ai ishte shpresa që kishte emër. Nuk e teproj po të them se e kemi parë si legjendë që kur e mbajmë mend. Ndoshta sepse jetoi i lirë, sepse ishte vetvetja, sepse kishte vendosur raporte vetëm me të drejtën, vetëm me të vërtetën. Ishte sportisti që e adhuronin të gjithë, ishte mësuesi që e respektonin, ishte qytetari që u ngrit në nivelet e dinjitetit. Kudo i doli për Zot vetes, sepse udha e lartësive që arriti, kaloi nëpër shenja e zakone fisnikërie.

Dashurinë, miqësinë, respektin për të gjithë sa njohu, për gjakun e tij, për miq e shokë as nuk e mati dhe as nuk e kurseu asnjëherë.

Shfrytëzonte çdo moment të kohës së lirë. Përgatitej me seriozitet për çdo orë mësimi, lexonte letërsinë e tij të preferuar, pëlqente këngët epike, e gjeje pranë fushës së ping -pongut, pranë tabelës së shahut, pasi la futbollin, ngriti për herë të parë ekipin e volejbollit për meshkuj me të cilin i përfaqësua denjësisht. Adhuronte natyrën e ishte shumë kohë jashtë di në dimër dhe në verë. Përgatiste me kohë skitë e rrjetën e peshkut për në Dri, Murrë e Setë. Dhe ftonte t'a shoqëronin vetëm për t'ju treguar bukuritë e natyrës.

Ishte i hijshëm, po më e madhja hijeshi e tij ishte urtësia me të cilën të ofrohej. Kurrë nuk të thoshte dy herë të njëjtën fjalë a sugjerim. Nuk të imponohej, vetëm shfaqej me shembullin e vet. Ndjenjën e sakrificës, të lidhjes së gjakut, të fisnikërisë, i shprehu në mënyrën më të bukur.

Duam të shkruajmë më shumë për sa ishe e jetove, sepse e meriton, po nuk të ka pëlqyer kurrë të të lëvdojnë.

Është e rëndë ndarja nga atdheu. Aq më shumë për ty që ishe kaq shumë i lidhur me vendlindjen, Homeshin. Pesha e mallit është sa pesha e malit. Për hatër të fëmijëve, këtë brengë e jetove brenda vetes dhe more rrugën e mërgimit, pa u ankuar, sepse jetës gjithmonë i shihje anën e mirë. I tillë ishe gjithë jetën.

U ndave nga kjo jetë i rrethuar me dashurinë e fëmijëve, nipërve e mbesave dhe plot mërgimtarë që të njihnin.

Nuk e di nëse ka kohë përtej kohës e jetë përtej jetës, por di se jemi të bekuar me emrin e hijeshinë tënde. Jemi të bekuar që të patëm mes nesh. Që të deshëm e na deshe. Me gjithçka që ishe, në kujtimet tona, gjithmonë. Qofsh banor i zotit!

Afrim Manjani, Emrie Skuka - Mera

NEKROLOGJI

Homazh për qytetarin me vlera humane, **Fitim Islamin**

Më datën 4 shkurt 2023, pas një sëmundje të rëndë e të pashërueshme u nda nga jeta në moshën 64 vjeçare Fitim Islami. I madh dhe i vogël në qytetin e Bulqizës e njohin Fitimin si qytetar i dashur e i sjellshëm me të gjitha kategoritë e moshave për më shumë se dy dekada në vitet 1982-2005.


Ai erdhi nga Grazhdani i Maqellarës si një pjesë e madhe e punëtorëve të minierës së Bulqizës. U lind më 1 prill 1959. Pasi mbaroi shkollën e mesme në Maqellarë, punojë për dy vjet në kooperativën bujqësore të Dovolanit. Në repartin e xhenjos, në Tiranë kreu shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Për të qenë më i lirë, për të vendosur për fatin e jetës së tij, në vitin 1983vendosi të vijë të punojë në minierën e kromit "Todo Manço" Bulqizë si vagonist. Ndër më të dalluarit, ashtu si të afërmit, por edhe bashkëpatriotët e tij nga Maqellara i kishin vënë shpatullat ndërmarrjes më të madhe të minierave.

Në vitin 1985 për disa aftësi e cilësi individuale u zgjodh të punojë si magazinier i ndërmarrjes së kromit. Miniera e kromit ishte ndër më të mëdhatë në sektorin e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve në vendin tonë. Magazina e pjesëve të ndërrimit quhej punë e lodhshme dhe me shumë përgjegjësi. Fitimi jo vetëm që e përballoi me sukses por ndihmoi me orar e pa orar minatorët, zjarrmëtarët, vagonistët të mos kishin pengesa në furnizimin me materialet që u duheshin për të realizuar detyrat e planin e nxjerrjes së kromit. Këtu u shfaqën virtyte e cilësi të Fitimit si njeri i palodhur, me iniciativë, i drejtë, kurajoz e human. Për një kohë të shkurtër siguroi një simpati e respekt të merituar. Si një njeri human u shqua në përpjekjet për t'u siguruar sektorëve të nëntokës, njerëzve të punës gjithçka që u duhej pa u humbur kohë dhe sorollatje për eliminimin e pengesave dhe avarive në punë. Ai ndër kohë njihte nevojat e niveleve, puseve, galerive, brigadave, në thellësi e sipërfaqe. Detyra e lidhi me njerëzit, gjithçka që lidhej me punën në minierë, i papërtuar, i shkathët, me integritet duke e zgjeruar rrethin shoqëror e miqësor.

Fitimi është nip në familjen e Dan Çukut në Mazhicë, familje patriote brez pas brezi, bazë e luftës nacional-çlirimtare.

Në Bulqizë krijoi familje, u martua me Lutfie Samet Lokën, një familje e vjetër punëtore dhe qytetare. Mori shtëpi në qytetin e ri duke u integruar shumë shpejt në gjirin e klasës punëtore. Bulqiza shquhet për dashurinë dhe respektin reciprok, çiltërsinë në marrëdhëniet shoqërore dhe qytetare, ambientin e ngrohtë që u krijojnë familjeve të reja etj. Rritën e trashëguan dy djem dhe një vajzë; Eugenin, Ledionin dhe Manjolën. Ata kanë mbaruar arsimin e lartë dhe punojnë në profesionet e fituara në Universitet.

Në vitin 2005 erdhi me familje në Tiranë, në lagjen "Don Bosko" bashkë me vëllezërit. Punoi rreth dy vite pranë ndërmarrjes pastrimit e gjelbërimit Nr 1, pranë bashkisë Tiranë.



Në foto: Fitim Islami

Erdhi si një nëpunës me përvojë e eksperiencë, krijoi marrëdhënie shumë njerëzore me punonjësit në ndërmarrjen e re që vinin nga shumë rrethe të Shqipërisë.

Në vitin 2007 shkoi me punë në Drejtorinë e përgjithshme të Transportit rrugor shqiptar si përgjegjës i arkivës dokumentare të mjeteve të transportit. Si kudo, edhe këtu, u bë një shembull i mirë në punë, u dallua për marrëdhënie korrekte e miqësore me kolegët, për shpirtin e madh dhe human në kontaktet dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Atij iu dha mundësia të njihej me qytetarë nga e gjithë Shqipëria duke marrë prej tyre konsiderata e mirënjohje. I gatshëm të tregojë humanizëm në çdo kohë, pa kursyer asgjë. Humanizmi nuk tregohet vetëm kur ndihmon njerëzit me vlera monetare por kur bën gjithçka për tu qëndruar afër, kur u jep rrugëzgjidhje, ndan hallet bashkë, këmben mendime e merr këshilla.

Këtë nuk e kurseu asnjëherë, për këtë do të mbahet mend e do të kujtohet Fitim Islami.

Në vitin 2022 fatkeqësisht u prek nga një sëmundje e rëndë. Pak ditë pa mbushur 64 vjeç, më 4 shkurt 2023 u nda nga jeta para kohe, kur ende familja dhe fëmijët e tij kishin nevojë për këshillat e dashurinë prindërore. Sëmundja nuk e përkuli, ai ishte optimist dhe ruajti lidhjet me shokët dhe miqtë e tij. Humbja e Fitimit ka pikëlluar shumë njerëz, shokë, miq e dashamirës, qytetarë të Bulqizës e Tiranës, kolektivi ku punonte etj. Përcjellja prej tyre për në banesën e fundit ishte një tregues për emrin e mirë e veprën humane, për ato vlera shoqërore e njerëzore që la pas Fitim Islami.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

U preftë në paqe!

Shpëtim S. Lleshi, Fadil Cani, Ramiz Halili, Qerim Tomja, Drilon Lleshi.

KËRKOHET GAZETAR/E

Kërkohen një gazetar/e me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603.**

E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT

https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

www.rrugaearberit.com

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

HOTEL CAMI

HOTEL CAMI

Shijoni magjinë e Dibrës







Për rezervime
+389 (0) 70 241 205
+389 (0) 46 841 555
hotelcami@hotmail.com
Dibër, Maqedonia e Veriut

HOTEL CAMI

hotel_cami

cyan magenta yelloë black